

PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN
FINANCIAR TË KOSOVËS

PËRMBLEDHJE E
PUBLIKIMEVE MUJORE
PËR VITIN 2015



PERIODIKU BANKAR



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 Banka Ekonomike



 iSBANK

NLB  Prishtina



PËRGATITUR NGA:

DR. SC. PETRIT BALIJA,
Kryeredaktor

KRESHNIK KOSUMI,
Redaktor

MIRANDA RUGOVAJ
Koordinatore

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,
Janar 2016

PERIODIKU BANKAR MBËSHTETET
NGA FONDI EVROPIAN PËR EVROPËN
JUGLINDORE



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE
DEVELOPMENT FACILITY

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdosmërisht pikëpamjet e Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE), partnerëve të tij, apo ofruesve të shërbimeve të EFSE-së.



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Deklarimi i përgjegjësisë: Mendimet dhe opinionet e paraqitura në këtë publikim janë përmbledhje e diskutimeve nga panellet e Panairit Financiar 2015. Këto mendime dhe opinione nuk paraqesin domosdosmërisht qëndrimet e Shoqatës së Bankave të Kosovës. Kjo përmbledhje do të shërbejë për reflektim mbi atë se çfarë është konkluduar nga diskutimet dy ditore në Konferencë dhe në hapje të Panairit Financiar 2015 në mënyrë që institucionet relevante të mund të ndërmarrin masat respektive për të përmirësuar mjedisin afarist në Kosovë.

PËRMBLEDHJE E PUBLIKIMEVE MUJORE PËR VITIN 2015

PËRMBAJTJA

PJESA I - PUBLIKIMET MUJORE PËR VITIN 2015

- Janar 2015 - Struktura e aseteve të sistemit financiar **1 - 6**
- Shkurt 2015 - Struktura e aseteve të industrisë bankare **7 - 13**
- Mars 2015 - Struktura e detyrimeve të industrisë bankare **14 - 21**
- Prill 2015 - Industria bankare - Statistika mbi transaksionet ndërbankare **22 - 32**
- Maj 2015 - Indikatorët kryesor të ekonomisë në vendet e ballkanit perëndimor **33 - 42**
- Qershor 2015 - Pasqyra e të ardhurave të industrisë bankare në Kosovë **43- 48**
- Korrik 2015 - Kreditë në kuadër të aseteve të industrisë bankare në Kosovë **49 - 56**
- Gusht 2015 - Depozitat në kuadër të detyrimeve të industrisë bankare në Kosovë **57 - 63**
- Shtator 2015 - Panairi financiar i Kosovës 2015 **64 - 75**
- Tetor 2015 - Norma efektive e interesit në industrinë bankare **76 - 85**
- Nëntor 2015 - Raporti ndërmjet depozitave dhe kredive **86 - 93**
- Dhjetor 2015 - Shërbimet elektronike bankare **94 - 106**

PJESA II - LAJME NGA INDUSTRIJA BANKARE

- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Janar 2015 **107 - 110**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Shkurt 2015 **111 - 114**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Mars 2015 **115 - 120**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Prill 2015 **121 - 124**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Maj 2015 **125 - 128**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Qershor 2015 **129 - 132**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Korrik 2015 **133 - 138**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Gusht 2015 **139 - 142**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Shtator 2015 **143 - 147**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Tetor 2015 **148 - 150**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Nëntor 2015 **151 - 154**
- Lajme nga industria bankare që shënuan muajin Dhjetor 2015 **155 - 159**

PERIODIKU BANKAR - JANAR 2015

STRUKTURA E ASETVE TË SISTEMIT FINANCIAR



SISTEMI FINANCIAR NË KOSOVË

Sistemi financiar, përkatësisht bankar, mundëson sistemin e pagesave të ndryshme si transferet vendore dhe ndërkombëtare, pagesat e faturave, dërgesat e remitencave etj. Njëkohësisht, bankat e nivelit të dytë mundësojnë depozitimin e kursimeve të qytetarëve dhe bizneseve dhe të në të njëjtën kohë kreditimin e atyre që kanë nevojë për kapital. Një sistem financiar mund të veproj në baza globale, regjionale apo në nivele lokale dhe më specifike. Sistemi financiar përfshinë tregjet e kapitalit, institucionet ndërmjetësuese, rregullatorët financiar dhe institucionet tjera financiare të cilat përdoren për të realizuar veprime financiare të ekonomive familjare, ndërmarrjeve dhe institucioneve tjera qeverisëse.

Sistemi financiar në Kosovë që nga paslufta dhe deri në këtë periudhë, vazhdimisht ka shënuar rritje në shumicën e vlerave të saj, gjë që tregon se institucionet financiare në Kosovë kanë themeluar baza të shëndosha të funksionimit duke ofruar siguri dhe besim tek klientët. Kjo ka bërë që sistemi financiar në Kosovë të kontribuoj vazhdimisht në zhvillimin ekonomik të vendit përmes procesit të huadhënies nga institucionet kredidhënëse (përmes bankave komerciale dhe institucioneve mikrofinanciare), por edhe përmes shërbimeve që i ofrojnë kompanitë e sigurimit.

Numri i institucioneve financiare në vazhdimësi është rritur, gjë që tregon se ky sektor është atraktiv për investitorët dhe ofron një nivel të lartë të sigurisë dhe besueshmërisë për qytetarët.

Kjo mund të vërehet edhe nga tabela nr.1 e paraqitur për vitet 2010-2014, me ç'rast shihet se në fund të vitit 2010 sistemin financiar në Kosovë e përbënin gjithsej 67 institucione, përdërisa në qershor 2014, numri i tyre ka arritur në gjithsej 84 institucione.

NUMRI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	Qer-2014
Bankat Komerciale	8	8	8	9	10
Kompanitë e sigurimit	12	13	13	13	13
Fondet Pensionale	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	28	34	34	38	41
Institucionet Mikrofinanciare	17	20	20	17	18
Gjithsej	67	77	77	79	84

Tab. 1 | Burimi: BQK - Raporti vjetor (2013) dhe Raporti i Stabilitetit Financiar nr. 06

Në një interval kohor prej tri viteve e gjysmë, janë shtuar gjithsej 17 institucione më shumë, përfshirë këtu dy banka komerciale më shumë, një kompani sigurimi, trembëdhjetë ndihmës financiar dhe një institucion mikrofinanciar në raport me vitin 2010. Këtu vërehet se rritjen më të madhe në numër të institucioneve, kanë shënuar ndihmësit financiar me gjithsej trembëdhjetë institucione.

ASETET E SISTEMIT FINANCIAR

Asetet e sistemit financiar në Kosovë në fund të muajit qershor 2014 kanë arritur vlerën në 4,314.40 miliardë euro. Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar ka shënuar rritje të vazhdueshme nëpër vite. Kjo mund të vërehet edhe nga tabela nr. 2 e paraqitur më poshtë.

STRUKTURA E ASETEVË TË SISTEMIT FINANCIAR					
	Milion euro				
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	Qer-2014
Bankat Komerciale	2,455.10	2,649.70	2,829.30	3,059.30	3,059.50
Kompanitë e sigurimit	97.2	106	130.8	132.5	135.60
Fondet Pensionale	493.7	593.3	744.6	918.7	997.30
Institucionet Mikrofinanciare	134	121.9	115.8	112.9	113.10
Ndihmësit financiar			8.2	7.60	8.90
Gjithsej	3,180.00	3,470.90	3,828.70	4,231.00	4,314.40

Tab. 2 | Burimi: BQK – Raporti vjetor (2010-2013) dhe Raporti i Stabilitetit Financiar nr.06

Në qershor të vitit 2014 nga gjithsej asetet e sistemit financiar, pjesën më të madhe të saj e përbën industria bankare në vlerë prej 3,059.50 miliardë euro. Pas kësaj renditen fondet pensionale në vlerë prej 997.30 milionë euro, kompanitë e sigurimit në vlerë prej 135.60 milionë euro, institucionet mikrofinanciare në vlerë prej 113.10 milionë euro dhe krejt në fund ndihmësit financiar në vlerë prej 8.9 milionë euro. Asetet e sistemit financiar në Kosovë në një interval kohor prej tri vjet e gjysmë kanë shënuar rritje mbi një miliardë euro, pra nga 3,180 miliardë euro që ishte në fund të vitit 2010, në 4,314.40 miliardë euro në fund të muajit qershor 2014.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Raporti vjetor (2010-2013) dhe Raporti i Stabilitetit Financiar nr.06

Nga figura numër 1 e paraqitur, mund të vërehet se rritje të konsiderueshme në gjithsej asetet e tyre në vlera reale kanë shënuar bankat komerciale dhe fondet pensionale, ndërkaq në vlera më të vogla kanë shënuar rritje poashtu asetet e kompanive të sigurimit dhe të institucioneve mikrofinanciare.

Në tabelën numër 3 janë të paraqitura përqindjet e pjesëmarrjes së sektorëve në gjithsej sistemin financiar në Kosovë. Pjesëmarrjen më të madhe në kuadër të sistemit financiar vazhdon ta dominoj industria bankare e cila në fund të muajit qershor 2014 e përbënte 70.8% të gjithsej asetëve të sistemit financiar, megjithëse kjo përqindje ka shënuar vazhdimisht ulje viteve të fundit.

STRUKTURA E ASETEVE TË SISTEMIT FINANCIAR E SHPREHUR NË PËRQINDJE					
Përshkrimi	Milion euro				
	2010	2011	2012	2013	Qer-2014
Bankat Komerciale	76.9%	76.1%	73.9%	72.3%	70.8%
Kompanitë e sigurimit	3.0%	3.2%	3.4%	3.1%	3.1%
Fondet Pensionale	15.5%	17.0%	19.5%	21.7%	23.2%
Ndihmësit financiar	0.2%	0.1%	0.2%	0.2%	0.3%
Institucionet Mikrofinanciare	4.4%	3.6%	3.0%	2.7%	2.6%

Tab. 3 | Burimi: BQK – Raporti vjetor (2010-2013) dhe Raporti i Stabilitetit Financiar nr.06

Nëse e shikojmë në perspektivë më afatgjate (2010-qershor 2014) sikurse mund ta shohim në figurën numër 2 dhe 3, pjesëmarrja e industrisë bankare në gjithsej asetet e sistemit financiar është zvogëluar nga 76.9% që ishte në fund të vitit 2010 (fig.2), në 70.8% në fund të muajit qershor (fig.3). Kjo ka ndodhë falë rritjes së fondeve pensionale të cilat në fund të muajit qershor 2014 kanë arritur vlerën afër një miliard euro.




Fig. 2 | Burimi: BQK – Raporti vjetor (2010-2013) dhe Raporti i Stabilitetit Financiar nr.06




Fig. 3 | Burimi: BQK – Raporti vjetor (2010-2013) dhe Raporti i Stabilitetit Financiar nr.06

Pjesëmarrja e asetëve të fondeve pensionale ka vazhduar të shënoj rritje në gjithsej asetet e sistemit financiar, me ç'rast siç shihet në figurën 3 në fund të muajit qershor ka arritë në 23.2%, përderisa në vitin 2010 të paraqitur në figurën 2 ishte 15.5%. Gjatë kësaj periudhe krahasuese (2010-qershor 2014), kompanitë e sigurimeve kanë arritur që të tejkalojnë institucionet mikrofinanciare në përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në raport me gjithsej asetet. Kompanitë e sigurimeve në qershor 2014 përbënin 3.1% të gjithsej asetëve të sistemit financiar, përderisa institucionet mikrofinanciare përbënin 2.6%.


Është e rëndësishme të theksohet se të gjithë akterët e sistemit financiar kanë shënuar rritje të asetëve të tyre, nëse krahasojmë periudhën qershor 2014 dhe fundin e vitit 2013. Pra sistemi financiar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 ka vazhduar zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të tij në mënyrë të qëndrueshme, pavarësisht sfidave me të cilat po ballafaqohen në ambientin e punës në të cilën ndërveprojnë.

PËRBËRJA E ASETEVE TË SISTEMIT FINANCIAR

Në këtë pjesë do të zbërthehen dy nga industritë kryesore të cilat e përbëjnë sistemin financiar, që në rastin tonë janë industria bankare dhe fondet pensionale. Industria bankare si sektori më i madh që përfshinë 70.8% e gjithsej aseteve të sistemit financiar, përbërjen e aseteve të saj e ka të dominuar nga kreditë bruto dhe lizingjet dhe lizingjet të cilat në muajin qershor përbëjnë rreth 61.7% të gjithsej aseteve të industrisë bankare.

Siç shihet në tabelën dhe figurën numër 4, pjesa tjetër përbëhet nga letrat me vlerë me 13.2% të gjithsej aseteve, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në që përbën 11.7%, bilanci me bankat komerciale me 10.4% dhe kështu me radhë.

PËRBËRJA E ASETEVE TË INDUSTRISË BANKARE	
Përshkrimi	Qer-2014
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	11.7%
Bilanci me bankat komerciale	10.4%
Letrat me vlerë	13.2%
Kreditë bruto dhe lizingjet	61.8%
Asetet fikse	1.8%
Asetet tjera	1.1%




Tab. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave tjera depozituese

Fig. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave tjera depozituese (Qershor 2014)

Fondet pensionale radhiten të dytat për nga niveli i aseteve të sistemit financiar, të cilat në qershor të 2014 përbënin 23.2% të gjithsej aseteve. Në kuadër të Fondeve Pensionale, siç shihet në tabelën dhe figurën numër 5, pjesën kryesore të aseteve të tyre e përbëjnë plasmanet private duke përbërë 75.4% të gjithsej aseteve.

PËRBËRJA E ASETEVE TË FONDEVE PENSIONALE	
Përshkrimi	Qer-2014
Totali i parave në dorë dhe në banka	18.2%
Totali i obligacioneve qeveritare	6.4%
Plasmanet private	75.4%
Asetet tjera	0.0%



Tab. 5 | Burimi: Bilanci i Gjendjes i Trustit (TM2 - 2014) dhe Raporti Vjetor 2013 i FSK

Fig. 5 | Burimi: Bilanci i Gjendjes i Trustit (TM2 - 2014) dhe Raporti Vjetor 2013 i FSK

Pas plasmaneve private në kuadër të aseteve radhiten paratë e gatshme dhe në banka me gjithsej 18.2% të gjithsej aseteve të fondeve pensionale. Pjesën tjetër e përbëjnë obligacionet qeveritare dhe asetet e tjera.

REFERENCAT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i Gjendjes (Qershor 2014) dhe Korporatave tjera Depozituese, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 6, <http://bqk-kos.org/?id=100>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti Vjetor 2010-2013, <http://bqk-kos.org/?id=102>;


Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Statistikat, 22 janar 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Bilanci i Gjendjes së FKPK-së, TM2 - 2014, <http://www.trusti.org/index.php/sq/raportet-tremujore>;

Fondi Slloveno-Kosovar të Pensioneve, Raporti vjetor 2013, http://www.fondipensional.com/raportet_main.html;

PERIODIKU BANKAR - SHKURT 2015

STRUKTURA E ASETIVE TË INDUSTRIISË BANKARE



STRUKTURA E ASETVE TË INDUSTRIJË BANKARE NË KOSOVË

Në Kosovë sot operojnë gjithsej dhjetë banka komerciale, ku gjatë vitit të kaluar mori licencën edhe banka e dhjetë komerciale. Industria bankare në Kosovë përbën 70.8%¹ të gjithsej asetëve të sistemit financiar. Andaj ky numër do të trajtojë njërin prej përbërësve kryesor të sistemit financiar. Ekonomia e Kosovës konsiderohet të jetë relativisht e re por e karakterizuar me një zhvillim të shpejtë të sistemit financiar. Në këtë rrafsh edhe industria bankare vazhdimisht është rritur, me ç'rast në fund të vitit 2014 kishte arritur vlerën e asetëve në 3,186.8 milion euro.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Asetet e industrisë bankare kanë shënuar rritje të vazhdueshme prej vitit në vit, duke u bërë kështu bartëse e zhvillimit ekonomik në vend. Nëse shikohet në periudha më afatgjate, pra brenda një periudhe katër vjeçare (2010-2014), atëherë asetet e kësaj industrie janë rritur për 29.8%.

STRUKTURA E ASETEVE TË INDUSTRIËSË BANKARE					
	Milion euro				
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	454.2
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	383.8
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.5
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	28.7
Gjithsej Asete	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,186.8

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Struktura e asetëve të industrisë bankare siç shihet edhe në tabelën 1 është dominuar nga kreditë dhe lizingu, pastaj nga paraja e gatshme dhe bilanci me BQK, bilanci me bankat komerciale dhe letrat me vlerë.




Fig. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Në figurën 2 mund të shohim se vlera e kredive dhe lizingut në fund të vitit 2010 ishte 1,458.7 milion euro, çka nënkupton se brenda një periudhe katër vjeçare vlera e kredive dhe lizingut është rritur për 29%, nëse krahasohet periudha 2010-2014. Kjo tregon se vlera e tyre ishte rritur në proporcion të njëjtë me rritjen e gjithsej asetëve të industrisë bankare, çka nënkupton se kreditë dhe lizingu ishin përbërësit kryesor të kësaj rritjeje.

Rritje të ndjeshme në kuadër të kësaj strukture të asetëve kishin shënuar edhe letrat me vlerë, me ç’rast brenda një periudhe katërvjeçare renditet e treta në përbërësit e asetëve së bashku me bilancin me bankat komerciale në kuadër të gjithsej asetëve të industrisë.

Përbërësi i dytë për nga vlera e strukturës së asetëve të industrisë bankare ishte paraja e gatshme dhe

bilanci me Bankën Qendrore të Kosovës e cila gjithashtu ka shënuar rritje në strukturën e aseteve, me përjashtim në vitin 2014 kur kjo vlerë u zvogëluar në 14.3%. Pas kësaj rradhiten letrat me vlerë, bilanci me bankat komerciale, asetet fikse dhe asetet tjera.

PJESËMARRJA NË STRUKTURËN E ASETEVE TË INDUSTRIJË BANKARE					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.5%	12.5%	15.0%	15.1%	14.3%
Bilanci me bankat komerciale	17.9%	12.4%	10.2%	11.1%	12.0%
Letrat me vlerë	7.1%	7.6%	9.1%	11.6%	12.0%
Kreditë dhe lizingu	59.4%	64.1%	62.3%	59.0%	59.1%
Asetet fikse	1.8%	1.8%	2.0%	1.8%	1.7%
Asetet tjera	1.3%	1.6%	1.3%	1.3%	0.9%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Në tabelën 2, mund të vërehet se struktura e gjithsej aseteve të industrisë bankare ishte dominuar nga kreditë dhe lizingu, megjithëse kjo në tri vitet e fundit ka një tendencë të lehtë të uljes në kuadër të gjithsej aseteve. Rritje kishin shënuar paraja e gatshme, me përjashtim të vitit të fundit, bilanci me bankat komerciale në dy vitet e fundit dhe sidomos letrat me vlerë gjatë gjithë kësaj periudhe krahasuese.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese




Fig. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Nëse bëjmë krahasimin e të dhënave ndërmjet vitit 2010 dhe vitit 2014, sikurse janë paraqitur në figurën 3 dhe 4, mund të shohim se kreditë dhe lizingu shprehur në përqindje në kuadër të aseteve të industrisë bankare kishte mbetur afërsisht e njëjtë në gjithsej strukturën e aseteve, përderisa bilanci me bankat komerciale kishte shënuar ulje. Rritje të ndjeshme në këtë përbërje kishin shënuar letrat me vlerë. Pra marrë në përgjithësi në kuadër të kësaj periudhe krahasuese, përbërja e aseteve të industrisë bankare nuk ka ndryshuar shumë dhe ishte e dominuar nga kreditë dhe lizingu që bankat kanë lëshuar për klientët e tyre dhe lëvizjeve të vogla të përbërësve tjerë të aseteve, kryesisht të letrave me vlerë.

RRITJA/ZVOGËLIMI VJETOR I STRUKTURËS SË ASETEVE TË INDUSTRIJË BANKARE				
Përshkrimi	2011	2012	2013	2014
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	8.0%	28.4%	8.8%	-2.0%
Bilanci me bankat komerciale	-25.0%	-12.6%	18.1%	12.9%
Letrat me vlerë	16.4%	27.0%	38.2%	8.3%
Kreditë dhe lizingu	16.4%	3.8%	2.4%	4.2%
Asetet fikse	7.6%	21.7%	-3.7%	-3.2%
Asetet tjera	25.8%	-7.8%	5.6%	-28.6%
Gjithsej	7.9%	6.8%	8.1%	4.2%

Tab. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Tabela 3 tregon lëvizjet në përqindje të rritjes apo zvogëlimit prej vitit në vit të gjithsej asetëve dhe përbërësve tjerë në kuadër të asetëve të industrisë bankare. Gjithsej asetet e industrisë bankare kishin shënuar rritje të vazhdueshme, përderisa në fund të vitit 2014 kjo rritje ishte më e vogël në krahasim me vitet paraprake. Kreditë dhe lizingu si përbërësi më i madh i strukturës së asetëve, gjithashtu kishte shënuar rritje, në të gjitha vitet krahasuese, megjithëse kjo rritje në vitin e fundit ashtu sikurse gjithsej asetet ishte më e vogël në krahasim me periudhat tjera. Asetet fikse, asetet tjera dhe paraja e gatshme ishin zvogëluar në fund të vitit 2014 në raport me vitin 2013. Një prej arsyeve se pse ka ndodhur kjo është se industria bankare viteve të fundit është e orientuar më shumë tek avancimi dhe rritja në shfrytëzimin të shërbimeve dhe produkteve elektronike, çka ka bërë që nevoja për prezencë fizike apo edhe për para të gatshme të jetë më e vogël në raport me periudhat e mëhershme, ndërkohe që vlerat tjera kryesore të strukturës së asetëve (siç janë kreditë) kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Kjo strategji e ndjekur nga industria bankare drejt zhvillimit dhe avancimit të teknologjisë elektronike është edhe në përputhje me strategjinë kombëtare të pagesave të hartuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Në kuadër të asetëve të industrisë bankare, kreditë e përbëjnë pjesën kryesore të tyre. Kreditë e lëshuara për operatorët ekonomik e përbëjnë pjesën më të madhe të gjithsej kredive.




Fig. 5 | Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas Aktivitetit Ekonomik

Figura 5 tregon se vlera e kredive të lëshuara për aktivitete ekonomike në fund të vitit 2014 ishte rritur për 25.4 milion euro në krahasim me vitin 2013, përderisa në krahasim me vitin 2010, kjo paraqet një rritje për 220 milion euro apo për 21.5%.

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Milion euro

Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restorantet	Tregti tjetër	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	135.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	154.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	163.3	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	171.3	1,217.4
2014	49.4	19.7	148.9	17.1	104.2	664.0	49.7	17.1	172.6	1,242.8

Tab. 4 | Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas Aktivitetit Ekonomik

Në kuadër të gjithsej kredive sipas aktivitetit ekonomik, pjesën më të madhe të tyre e përbënin kreditë e lëshuara për tregti. Siç shihet në tabelën 4 kreditë e lëshuara për sektorin e tregtisë ishin rritur vazhdimisht gjatë kësaj periudhe krahasuese, duke shtuar kështu pjesëmarrjen e saj në kuadër të gjithsej kredive. Pas kësaj rradhiten kreditë e lëshuara për shërbime tjera, qëllime prodhimi, ndërtimtari dhe të tjerat.

PJESËMARRJA E KREDIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restorantet	Tregti tjetër	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	3.7%	1.4%	12.5%	1.8%	10.7%	51.0%	3.9%	1.9%	13.3%	100.0%
2011	3.5%	1.5%	11.9%	1.3%	10.1%	52.7%	3.5%	2.0%	13.5%	100.0%
2012	3.7%	1.4%	11.1%	1.3%	10.5%	53.2%	3.2%	1.9%	13.7%	100.0%
2013	3.8%	1.7%	10.8%	1.7%	9.8%	52.6%	4.0%	1.6%	14.1%	100.0%
2014	4.0%	1.6%	12.0%	1.4%	8.4%	53.4%	4.0%	1.4%	13.9%	100.0%

Tab. 5 | Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas Aktivitetit Ekonomik

Në tabelën 5 shihet se tregtia në të gjitha vitet krahasuese përbën më shumë se gjysmën e kredive sipas aktivitetit ekonomik, pas kësaj rradhiten kreditë për shërbime tjera, kreditë për prodhim, ndërtimari, bujqësi etj.




Fig. 6 | Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas Aktivitetit Ekonomik




Fig. 7 | Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas Aktivitetit Ekonomik

Kreditë e lëshuara sipas aktivitetit ekonomik nëse krahasohen ndër vite, nuk kanë ndryshuar shumë në përbërjen e tyre. Kjo mund të vërehet edhe përmes figurave 6 dhe 7 të paraqitura, me ç'rast shihet se kjo përbërje dominohej nga kreditë e lëshuara për tregti me 51% (2010), përkatësisht 53.4% (2014), duke vazhduar me prodhimtarinë me 12.5% (2010), përkatësisht 12% (2014), pastaj me ndërtimtarinë dhe sektorët e tjerë ekonomik.

KREDITË E REJA

Kreditë e reja në industrinë bankare dominoheshin nga kreditë e lëshuara për korporatat jo financiare në raport me kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare. Në të gjitha periudhat krahasuese ndër vite mund të vërehet rritja e kredive të reja për të dy kategoritë.

KREDITË E REJA NË INDUSTRIJË BANKARE			
Milion euro			
Përshkrimi	Korporatat jo financiare	Ekonomitë familjare	Gjithsej
2010	491.3	240.5	731.8
2011	508.4	293.7	802.1
2012	468.4	275.9	744.3
2013	467.9	294.1	761.9
2014	615.4	378.5	993.9

Tab. 6 | Burimi: BQK – Kreditë e reja të Korporatave Tjera Depozituese

Siç shihet në tabelën 6, në raport me vitin 2010, gjithsej kreditë e reja në vitin 2014 ishin rritur për 35.8%. Viti 2014 ka qenë njëkohësisht edhe viti rekord i shënuar për vlerën e kredive të reja të lëshuara nga industria bankare brenda një viti.




Fig. 8 | Burimi: BQK – Kreditë e reja të Korporatave Tjera Depozituese




Fig. 9 | Burimi: BQK – Kreditë e reja të Korporatave Tjera Depozituese

Figura 8 dhe 9 e paraqitur tregojnë se shpërndarja e kredive në korporatat jo financiare dhe ato të ekonomive familjare nëpër vite ka qenë afërsisht e njëjtë, duke mos shënuar ndryshime të mëdha edhe pse mund të vërehet një rritje e lehtë në pjesëmarrje të kredive për ekonomitë familjare me përjashtim të vitit të fundit (2014) kur pjesëmarrja e tyre u zvogëluar sërish në kuadër të gjithsej kredive të reja.

REFERENCAT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i Gjendjes dhe Korporatave tjera Depozituese (dhjetor 2014), <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas Aktivitetit Ekonomik (dhjetor 2014), <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Kreditë e reja të Korporatave Tjera Depozituese (dhjetor 2014), <http://bqk-kos.org/?id=55> ;

PERIODIKU BANKAR - MARS 2015

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIISË BANKARE



DETYRIMET E INDUSTRIË BANKARE NË KOSOVË

Në numrin paraprak të periodikut bankar është trajtuar struktura e asetëve të industrisë bankare në periudhat 2010-2014, me ç’rast është bërë një krahasim i këtyre të dhënave gjatë pesë viteve. Ndërsa në këtë numër kemi trajtuar strukturën e detyrimeve të industrisë bankare. Ashtu sikurse asetet e industrisë bankare edhe struktura e detyrimeve ka shënuar rritje të vazhdueshme në kuadër të gjithsej detyrimeve.

Ashtu sikurse asetet edhe detyrimet bankare janë pjesë e bilancit të gjendjes. Detyrimet bankare janë borxhe të shkaktuara nga një bankë, pra çfarë detyrohet një bankë. Përderisa një bankë është e detyruar tradicionalisht të ketë detyrime dhe borxhe komerciale, pjesa më e madhe e detyrimeve të një banke janë financiare. Kategoria kryesore e detyrimeve bankare janë depozitat, pra pasurinë financiare që të tjerët e kanë deponuar në bankë për ruajtje apo kursime. Në këtë kuptim banka i obligohet apo i detyrohet qytetarëve për këtë pasuri të deponuar për ruajtje në formë të depozitave. Në kuadër të detyrimeve, një kategori tjetër e rëndësishme është edhe kapitali i pronarit i investuar, investime këto që regjistrohen si detyrime që banka i ka ndaj pronarëve.

Siç mund të shihet edhe nga të dhënat që janë paraqitur në këtë publikim, struktura e detyrimeve të industrisë bankare vazhdon të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare të cilat njëkohësisht paraqesin burimin kryesor të financimit të bizneseve në Kosovë.

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIË BANKARE

	Milion euro*				
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.8
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.9
Borxhi i ndërvarur	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.1
Gjithsej Detyrime	2,455.1	2,649.7	2,059.3	3,059.3	3,186.6

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Tabela 1 mbi strukturën e detyrimeve të industrisë bankare tregon se rritja është e vazhdueshme prej vitit në vit. Në fund të vitit 2014 rritja e gjithsej detyrimeve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2013 ishte për 4.1% më e lartë. Nëse shikohet në periudha afatmesme, pra brenda një periudhe pesë vjeçare (2010-2014), atëherë detyrimet e kësaj industrie janë rritur për 29.8%.

Në kuadër të kësaj strukture pjesën kryesore e përbëjnë depozitat, pas kësaj radhiten mjetet vetanake, detyrimet tjera, borxhi i ndërvarur dhe kështu me radhë. Nga struktura e detyrimeve vërehet se krahas depozitave, rritje të konsiderueshme kanë shënuar mjetet vetanake, përderisa luhatje të ndryshueshme kanë shënuar detyrimet tjera.

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIËSË BANKARE (%)					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Bilanci nga bankat tjera	2.9%	1.5%	0.2%	0.5%	1.0%
Depozitat	78.9%	79.4%	80.6%	80.1%	79.6%
Huatë tjera	1.0%	1.1%	0.7%	0.4%	0.4%
Provizionet e shlyera	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%
Detyrimet tjera	6.5%	7.2%	7.8%	8.0%	7.2%
Borxhi i ndërvarur	1.4%	1.2%	1.1%	1.8%	1.5%
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.0%	0.0%	-
Mjetet vetanake	9.4%	9.5%	9.6%	9.1%	10.1%
Gjithsej Detyrime	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Siç shihet nga tabela 2, depozitat kanë pas përfshirje relativisht të njëjtë në kuadër të gjithsej detyrimeve për periudhat që janë marrë për krahasim, përderisa rritje të lehtë në këtë strukturë kanë shënuar mjetet vetanake. Një pjesë të rëndësishme në strukturën e detyrimeve e përbëjnë edhe detyrimet tjera, përderisa kategoritë tjera kanë pjesëmarrje shumë të ulët në gjithsej detyrimet.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese




Fig. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Me gjithë rritjen e strukturës së detyrimeve brenda pesë viteve prej 29.8%, përbërja e strukturës së detyrimeve ka mbetë e njëjtë, sikurse mund të shihet edhe nga figura 1 dhe 2 e paraqitur. Ajo dominohet vazhdimisht nga depozitat, struktura e të cilave do të trajtohet në vijim.

Gjatë periudhës krahasuese të të dhënave në kuadër të këtij publikimi, depozitat e industrisë bankare kanë shënuar rritje afërsisht proporcionale në raport me rritjen e gjithsej detyrimeve.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i Gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Kjo rritje afërsisht proporcionale mund të vërehet edhe nga figura 3 e paraqitur, me ç’rast trendi rritës i depozitave është në raport linear me rritjen e detyrimeve.

STRUKTURA E DEPOZITAVE

Depozitat paraqesin burimin kryesor të të hyrave të industrisë bankare, andaj rritja e qëndrueshme e tyre në industrinë bankare në Kosovë ka rëndësi të madhe në stabilitetin financiar në vend. Fatmirësisht në Kosovë që nga hapja e bankës së parë komerciale, depozitat e industrisë bankare si pjesë kryesore e strukturës së detyrimeve kanë shënuar rritje të vazhdueshme duke u bërë faktor kyç i zhvillimit të sistemit financiar në Kosovë. Në vijim është trajtuar struktura e depozitave të bankave komerciale në vend.



STRUKTURA E DEPOZITAVE TË INDUSTRIË BANKARE					
	Milion euro*				
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Qeveria	11.7	2.7	0.7	1.8	8.8
Korporatat tjera depozituese	7.3	9.9	3.8	2.5	2.8
Ndërmjetës tjerë financiarë	7.9	6.8	6.2	7.4	5.1
Kompanitë e sigurimit	47.6	57.2	64.3	72.3	79.3
Fondet pensionale	41.6	43.1	45.3	5.7	17.1
Ndihmësit financiar	0.6	0.5	0.4	0.3	0.3
Korporatat publike jofinanciare	122.3	128.5	75.6	72.1	61.8
Korporatat tjera jofinanciare	292.5	278.1	326.1	383.5	387.9
Ekonomitë familjare	1,206.1	1,373.4	1,535.4	1,658.7	1,750.6
Organizatat joprofitabile	14.0	22.2	23.2	26.4	30.6
Jorzidentët	79.1	60.0	81.7	83.4	82.1
Depozitat në jo-euro	113.8	131.5	120.9	136.9	113.1
Gjithsej Detyrime	1,944.5	2,113.9	2,283.7	2,451.0	2,539.4

Tab. 3 | Burimi: BQK – Depozitat e Korporatave Tjera Depozituese sipas maturitetit original dhe depozitat jo-euro

Siç shihet nga tabela 3, pjesën kryesore të depozitave të industrisë bankare e përbëjnë depozitat e ekonomive familjare, pastaj korporatat tjera jofinanciare, korporatat publike jofinanciare, depozitat e jorzidentëve, kompanitë e sigurimit dhe kështu me radhë. Është e rëndësishme të theksohet se depozitat e ekonomive familjare përbëjnë pjesën kryesore të gjithsej depozitave, pra më shumë se sa depozitat e bizneseve dhe të kompanive tjera publike apo jo qeveritare.

STRUKTURA E DEPOZITAVE TË INDUSTRIË BANKARE (%)					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Qeveria	0.6%	0.1%	0.0%	0.1%	0.3%
Korporatat tjera depozituese	0.4%	0.5%	0.2%	0.1%	0.1%
Ndërmjetës tjerë financiarë	0.4%	0.3%	0.3%	0.3%	0.2%
Kompanitë e sigurimit	2.4%	2.7%	2.8%	3.0%	3.1%
Fondet pensionale	2.1%	2.0%	2.0%	0.2%	0.7%
Ndihmësit financiar	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Korporatat publike jofinanciare	6.3%	6.1%	3.3%	2.9%	2.4%
Korporatat tjera jofinanciare	15.0%	13.2%	14.3%	15.6%	15.3%
Ekonomitë familjare	62.0%	65.0%	67.2%	67.7%	68.9%
Organizatat joprofitabile	0.7%	1.0%	1.0%	1.1%	1.2%
Jorzidentët	4.1%	2.8%	3.6%	3.4%	3.2%
Depozitat në jo-euro	5.9%	6.2%	5.3%	5.6%	4.5%
Gjithsej Detyrime	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Depozitat e Korporatave Tjera Depozituese sipas maturitetit original dhe depozitat jo-euro

Depozitat e ekonomive familjare gjatë periudhave krahasuese, jo vetëm që kanë dominuar në kuadër të gjithsej depozitave, mirëpo ato kanë arritur që të shtojnë përbërjen e tyre duke arritur në 68.9% të gjithsej depozitave. Korporatat tjera jofinanciare kanë arritur të mbajnë përbërjen e njëjtë gjatë pesë viteve krahasuese. Rritje të lehtë dhe të vazhdueshme kanë shënuar edhe depozitat e kompanive të sigurimit, përderisa korporatat publike jofinanciare kanë shënuar rënie në përbërjen e gjithsej strukturës së depozitave. Të gjitha këto lëvizje mund të vërehen në tabelën 4.

Një rol të rëndësishëm në gjithsej strukturën e depozitave e përbëjnë edhe depozitat të cilat janë në valuta të huaja si dhe depozitat e jorzidentëve të cilat bashkërisht përbëjnë rreth 7.7% të gjithsej depozitave.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Depozitat e Korporatave Tjera Depozituese sipas maturitetit origjinal dhe depozitat jo-euro

Në figurën 4 mund të vërehet se rritja e depozitave të ekonomive familjare ka qenë në trend të njëjtë me rritjen e gjithsej depozitave, duke u bërë kështu bartëse kryesore e rritjes së gjithsej depozitave.

STRUKTURA E DEPOZITAVE SIPAS MATURIMIT

Përbërja e strukturës së depozitave në industrinë bankare paraqet një rëndësi të madhe, meqenëse përmes depozitave mundësohet kreditimi i aktiviteteve ekonomike në vend. Sa më afatgjate që të jenë këto depozita të deponuara në industrinë bankare, aq më afatgjate mund të jenë edhe kreditë e lëshuara nga industria bankare, kjo me qëllim që të ruaj nivelin e likuiditetit që duhet të ketë industria bankare që në çdo moment të jetë në gjendje të kryej obligimet e saj.

Në Kosovë përbërja e depozitave sa i përket maturimit të tyre është e shpërndarë dhe nuk është e koncentruar vetëm tek depozitat e qarkullueshme të cilat janë të deponuara në llogaritë qarkulluese të bankave. Tabela 5 tregon vlerat për tri kategori të përbërjes së depozitave në industrinë bankare. Në kuadër të kësaj strukture nuk bëjnë pjesë depozitat e industrisë bankare që janë në valutat e tjera.



STRUKTURA E DEPOZITAVE SIPAS MATURIMIT TË INDUSTRIË BANKARE

Përshkrimi	Milion euro*				
	2010	2011	2012	2013	2014
Depozitat e transferueshme	625.9	643.5	696.4	825.0	1,122.7
Depozitat e kursimit	315.0	315.1	326.6	373.8	513.0
Depozitat e afatizimit	889.9	1,023.8	1,139.8	1,115.3	790.5
Gjithsej Detyrime	1,830.8	1,982.4	2,162.8	2,314.1	2,426.3

Tab. 5 | Burimi: BQK – Depozitat e Korporatave Tjera Depozituese sipas maturitetit origjinal

Pjesën më të madhe të depozitave e përbëjnë depozitat e transferueshme në fund të vitit 2014. E dyta në renditje janë depozitat e afatizimit, përderisa depozitat e kursimit janë të fundit në kuadër të tri kategorive. Gjatë pesë periudhave krahasuese, vërehet se vlera e depozitave të transferueshme është ngritur në përbërjen e gjithsej depozitave, përderisa rënje kanë shënuar depozitat e afatizuar.

STRUKTURA E DEPOZITAVE SIPAS MATURIMIT TË INDUSTRIË BANKARE (%)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Depozitat e transferueshme	34.2%	32.5%	32.2%	35.7%	46.3%
Depozitat e kursimit	17.2%	15.9%	15.1%	16.2%	21.1%
Depozitat e afatizimit	48.6%	51.6%	52.7%	48.2%	32.6%
Gjithsej Detyrime	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab. 6 | Burimi: BQK – Depozitat e Korporatave Tjera Depozituese sipas maturitetit origjinal

Nga tabela 6 mund të shihet se rritje të vazhdueshme në përbërjen e gjithsej depozitave kanë shënuar depozitat e transferueshme dhe ato të kursimit, kurse depozitat e afatizimit gjatë viteve 2011 dhe 2012 përbënin mbi gjysmën e gjithsej depozitave, përderisa në dy vitet e fundit kanë shënuar ulje të dukshme.

Pavarësisht këtij ndryshimit në vitin e fundit në përbërjen e maturimit të gjithsej depozitave, mund të vërehet se industria bankare ka përbërje të ndryshme të depozitave dhe përmes tyre mundëson kreditimin e ekonomisë së Kosovës në plane më afatgjata.




Fig.5 | Burimi: BQK – Depozitat e Korporatave Tjera Depozituese sipas maturitetit origjinal




Fig.6 | Burimi: BQK – Depozitat e Korporatave Tjera Depozituese sipas maturitetit origjinal

Kjo lëvizje e përbërjes së depozitave sipas afatit të maturimit mund të vërehet edhe nga figurat e paraqitura 5 dhe 6, me ç'rast në fund të vitit 2014 depozitat e transferueshme janë depozita dominuese në kuadër të tri kategorive të ndara sipas maturimit të tyre.

REFERENCAT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i Gjendjes dhe Korporatave tjera Depozituese 23 mars 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Depozitat në euro të Korporatave tjera Depozitare sipas maturitetit origjinal, 23 mars 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Depozitat jo-euro të korporatave tjera depozituese sipas maturitetit origjinal 23 mars 2015, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

PERIODIKU BANKAR - PRILL 2015

INDUSTRIA BANKARE - STATISTIKA MBI TRANSAKSIONET NDËRBANKARE

NUMRI DHE VLERA E TRANSAKSIONEVE TË INDUSTRI SË BANKARE NË KOSOVË

Përveç rritjes së vazhdueshme të vlerave kryesore të industrisë bankare në bilancin e gjendjes dhe në pasqyrën e të ardhurave, industria bankare rritje të ndjeshme ka shënuar edhe në numrin dhe vlerat e transaksioneve. Në dy tabelat e dhëna në vijim mund të shihen këto të dhëna.



NUMRI I TRANSAKSIONEVE						
Nr.	Lloji i transaksioneve	2010	2011	2012	2013	2014
1	Të rregullta	615,700	727,668	833,409	970,717	1,032,043
2	Prioritare	15,145	18,657	22,300	24,812	26,079
3	Të rregullta-masive	2,872,234	2,937,845	2,916,145	3,294,677	3,731,436
4	Prioritare-masive	2,021	2,091	3,873	1,797,330	3,233,049
5	Pagesat xhiro	419,329	496,197	543,338	692,281	1,013,620
6	Letra me vlerë	0	0	309	498	618
7	Debitimi Direkt	3,303	7,321	10,304	13,115	14,582
8	Total	3,927,732	4,189,799	4,329,678	6,793,430	9,051,427

Tab. 1 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Tabela 1 tregon numrin dhe llojin e transaksioneve të realizuara përmes industrisë bankare. Nëse krahasohet dallimi ndërmjet vitit 2010 dhe 2014, mund të vërejmë se gjithsej numri i transaksioneve është dyfishuar. Në kuadër të gjithsej numrit të transaksioneve, në fund të vitit 2014 pjesën kryesore të tyre e përbëjnë transaksionet e rregullta-masive me 41.2%, pas kësaj rradhiten transaksionet prioritare-masive me 35.7%, të rregulltat me 11.4% dhe kështu me rradhë.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Rritje të ndjeshme nga figura 2 mund të vërehet se është shënuar kryesisht në dy vitet e fundit, pra gjatë vitit 2013 dhe 2014, në kuadër të gjithsej numrat e transaksioneve. Ky trend i rritjes në dy vitet e fundit mund të vërehet pothuajse tek të gjitha llojet e transaksioneve.

VLERA E TRANSAKSIONEVE (milion Euro)						
Nr.	Lloji i transaksioneve	2010	2011	2012	2013	2014
1	Të rregullta	2,949,927,889	3,089,861,522	3,161,880,010	3,319,527,253	3,329,886,961
2	Prioritare	568,863,646	652,651,299	893,490,615	768,577,986	666,722,026
3	Të rregullta-masive	402,854,278	465,187,793	470,361,458	531,795,573	536,499,429
4	Prioritare-masive	1,386,264	1,434,815	2,397,909	374,517,269	645,334,638
5	Pagesat xhiro	734,367,963	871,170,119	892,130,913	899,986,956	949,316,256
6	Letra me vlerë			252,653,198	534,011,408	695,370,096
7	Debitimi Direkt	2,807,939	6,252,067	8,043,429	6,763,903	7,182,931
8	Total	4,660,207,982	5,086,557,617	5,680,957,532	6,435,180,348	6,830,312,337

Tab. 2 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Ashtu sikurse është rritur numri i transaksioneve edhe vlera e tyre në industrinë bankare ka shënuar rritje për të gjitha llojet e tyre. Rritja e këtyre vlerave mund të vërehet nga tabela 2 e paraqitur. Në krahasim prej vitit 2010, vlera e gjithsej transaksioneve është rritur për 46.5% në fund të vitit 2014. Në kuadër të gjithsej vlerave të transaksioneve në fund të vitit 2014, vlerat më të mëdha i kanë shënuar transaksionet e rregullta të cilat përbëjnë 48.7% të gjithsej vlerës së transaksioneve, pas kësaj rradhiten vlera e transaksioneve xhiro, letrat me vlerë e kështu me rradhë.

Rritja e numrit dhe vlerave të transaksioneve në industrinë bankare, tregon se qytetarët e Republikës së Kosovës kanë besim të madh tek kjo industri, me ç'rast gjithnjë e më shumë pagesat e tyre kanalizohen përmes industrisë bankare. Për më shumë, kjo industri përdoret edhe si instrument për të dokumentuar çdo pagesë që klientët e bëjnë në emër të obligimeve që ata i kanë.

NUMRI I TERMINALEVE, KARTELAVE DHE LLOGARIVE TË E-BANKING

Për klientët e industrisë bankare, instrumentet elektronike të pagesave janë gjithnjë e më shumë të nevojshme, meqenëse mundësojnë realizimin e pagesave kurdo që ata kanë nevojë, pavarësisht kohës dhe orarit të punës, duke i mundësuar që këtë shërbim ta realizojnë gjatë njëzet e katër orëve. Për këtë arsye edhe përdorimi i tyre është gjithnjë e më shumë në rritje, sikurse mund të vërehet edhe në tabelën 3 të paraqitur.

NUMRI I KARTELAVE BANKARE									
		2013				2014			
Nr.	Kartela sipas funksionit	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
I.	Kartela me funksion cash-i	670,871	702,238	730,812	754,380	731,442	750,878	813,199	813,026
II.	Kartela me funksion pagese prej të cilave:	679,017	702,238	730,812	754,380	731,442	750,878	798,996	799,742
	1 - Kartela me funksion debiti	581,674	602,899	628,173	645,048	618,926	633,635	679,465	678,090
	2 - Kartela me funksion krediti	97,343	99,339	102,639	109,332	112,516	117,243	119,531	121,652
III.	Kartela me funksion para elektronike	13,318	13,589	13,589	15,017	15,125	14,203	14,203	13,284
IV.	Numri total i kartelave	692,335	715,827	744,401	769,397	746,567	765,081	813,119	813,026

Tab. 3 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Në fund të vitit 2014 numri i kartelave bankare ka arritur në 813,026, prej të cilave 83.4% e përbëjnë kartelat me funksion debiti, 14.9% kartela me funksion krediti dhe 1.6% kartela me funksion para elektronike.




Fig. 2 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash


Industria bankare ka një infrastrukturë relativisht të mirë të terminaleve të krijuar dhe të shpërndarë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, përmes të cilave kryhen transaksionet duke shfrytëzuar kartelat bankare. Tabela 4 e tregon këtë infrastrukturë nëpër vite mbi numrin e pikave shitëse dhe bankomateve.

NUMRI I TERMINALEVE PËR KARTELAT DHE PARANË ELEKTRONIKE							
Nr.	Terminalet sipas funksionit	2009	2010	2011	2012	2013	2014
I.	Bankomate - Automated Teller Machines (ATM) prej të cilave:	339	415	460	483	496	498
	1 - ATM me funksion tërheqje cash	339	415	460	483	496	498
	2 - ATM me funksion transferim krediti prej të cilave:	122	141	147	145	148	50
	a - ATM me funksion të pagesave Kos-Giro	N/A	39	69	73	70	50
	3 - ATM me funksion depozitim cash	0	0	1	1	8	13
II.	Terminale POS (Point of Sale) prej të cilave:	5,251	6,194	7,534	8,592	9,071	9,349
	1 - terminale POS me funksion tërheqje cash	221	212	1,376	220	215	220
	2 - terminale EFTPOS	5,223	5,930	6,320	8,499	8,856	9,179
III.	Terminale virtuale POS për përdorimin e kartelave	0	0	0	0	0	7
IV.	Terminale për përdorimin e parasë elektronike	0	0	0	0	0	0

Tab. 4 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Në krahasim me vitin 2009, industria bankare në fund të vitit 2014 ka shënuar rritje për 46.9% në numrin e bankomatëve. Është e rëndësishme të theksohet se industria bankare përveç mundësisë për tërheqje të parave të gatshme ka krijuar mundësinë që përmes bankomatëve të kryhen edhe pagesa të ndryshme sikurse që janë pagesat xhiro, pagesat për mbushje të telefonave, deponim të mjeteve etj.

Në industrinë bankare krahas rritjes së numrit të bankomatëve është rritur edhe numri i pikave shitëse. Kjo mund të vërehet nga tabela 4 dhe figura 3.



Tab. 4 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Në krahasim me vitin 2009, industria bankare në fund të vitit 2014 ka shënuar rritje për 78.0% për numrin e pikave shitëse apo 4,098 terminale POS më shumë.

NUMRI I LLOGARIVE E-BANKING							
		2009	2010	2011	2012	2013	2014
Nr.	Kartela sipas funksionit	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali
1.	Kartela me funksion cash-i	40,924	55,292	68,990	97,089	131,365	157,761

Tab. 5 | Burimi: BQK – Raporti tremujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Rritje shumë të ndjeshme në numrin e tyre kanë shënuar edhe llogaritë e-banking. Në krahasim me vitin 2009, numri i llogarive e-banking është rritur për 285% në fund të vitit 2014.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Raporti tremujor mbi instrumenteve cash dhe jocash



Rritja e numrit të llogarive e-banking është në proporcion edhe me rritjen e numrit dhe vlerave të transaksioneve të realizuara me këtë instrument të pagesave të cilat vlera do të trajtohen në vijim.

VLERA DHE NUMRI I TRANSAKSIONEVE ME KARTELA DHE E-BANKING TË INDUSTRIJË BANKARE

Tabela 6 dhe 7 tregojnë se viti 2014 në krahasim me vitin 2013 ka shënuar rritje si në numër dhe vlera të transaksioneve. Viti 2014 kishte për 12.2% numër të transaksioneve me kartela më shumë se sa viti 2013, 7.3% numër të transaksioneve me tërheqje në para të gatshme në bankomate dhe 25.5% më shumë numër të pagesave me kartela në terminale në pika të shitjeve.

NUMRI I TRANSAKSIONEVE ME KARTELA PËRMES TERMINALEVE

Nr.	Përshkrimi	2013				Total	2014				Total
		TM1	TM2	TM3	TM4		TM1	TM2	TM3	TM4	
I.	Total i transaksioneve me kartela prej të cilave:	3,029,903	3,264,376	3,44,217	3,390,578	13,129,074	3,324,599	3,617,691	3,874,485	3,917,414	14,734,189
	1 - ATM tërheqje cash	2,120,630	2,294,325	2,436,798	2,399,759	9,251,512	2,245,689	2,478,440	2,640,917	2,561,090	9,926,136
	2 - ATM depozitime	912	1,252	1,580	1,570	5,314	3,527	4,591	5,553	14,053	27,724
	3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM	29,656	29,276	26,031	23,345	108,308	18,770	18,890	17,690	14,810	70,160
	4 - Tërheqje cash në terminale POS	3,964	3,995	10,195	3,810	21,964	4,011	4,191	3,865	1,266	13,333
	5 - Pagesa me kartela në terminale POS	874,741	935,528	969,613	962,094	3,741,976	1,052,602	1,111,579	1,206,460	1,326,195	4,696,836

Tab. 6 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Në tabelën 7 vërehet se në krahasim me vitin 2013, vlerat e transaksioneve me kartela në fund të vitit 2014 janë rritur për 9.2%, tërheqjet me para të gatshme për 6.4%, përdërisa pagesat me kartela në terminale në pika të shitjeve për 24.0%.

VLERA E TRANSAKSIONEVE ME KARTELA PËRMES TERMINALEVE

Nr.	Përshkrimi	2013				Total	2014				Total
		TM1	TM2	TM3	TM4		TM1	TM2	TM3	TM4	
I.	Total i transaksioneve me kartela prej të cilave:	233,886,942	273,476,662	356,068,883	292,017,218	1,155,449,704	261,206,247	303,438,700	358,981,323	338,606,328	1,262,232,598
	1 - ATM tërheqje cash	189,777,903	221,610,163	288,636,998	236,159,208	936,184,272	207,321,268	242,803,650	288,265,856	257,845,346	996,236,120
	2 - ATM depozitime	56,595	427,530	901,910	567,240	1,953,275	1,331,075	1,808,930	2,583,985	7,764,643	13,488,633
	3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM	219,930	211,187	184,331	165,810	781,258	140,399	145,977	124,375	104,706	515,457
	4 - Tërheqje cash në terminale POS	3,680,094	4,828,627	11,668,447	4,399,116	24,576,284	3,600,391	3,932,916	4,478,684	1,866,595	13,878,586
	5 - Pagesa me kartela në terminale POS	40,152,420	46,399,154	54,677,197	50,725,844	191,954,615	48,813,114	54,747,227	63,528,423	71,025,037	238,113,801

Tab. 7 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Numri dhe vlerat e transaksioneve të realizuar përmes e-banking janë gjithashtu në rritje. Kjo rritje e tyre mund të vërehet nga tabela 8 e paraqitur, me ç'rast vlerat janë shumëfishuar. Vetëm brenda një viti, numri i transaksioneve në raport me vitin 2013 është rritur për 49.5%, përdërisa vlerat e transaksioneve janë rritur për 58%.

NUMRI DHE VLERA E TRANSAKSIONEVE PËRMES E-BANKING

Nr.	Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014
		Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali
1.	Numri i transaksioneve	228,886	318,375	424,273	625,762	1,056,655	1,579,838
2.	Vlera e transaksioneve	607,305,817	782,383,357	1,218,089,663	1,499,093,438	2,671,011,546	4,220,405,696

Tab. 8 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Nëse këto vlera i krahasojmë me periudhat e mëhershme, pra nga viti 2009 me 2014, numri dhe vlera e transaksioneve me e-banking gati se është shtatëfishuar.

Të gjitha të dhënat dhe statistikat e treguara më lartë, tregojnë se industria bankare është duke u orientuar shumë drejt përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, pra drejt automatizimit të shërbimeve dhe produkteve pa pas nevojë për prezencë fizike të punonjësve të bankës. Këto shërbime janë përputhje me zhvillimet bashkëkohore të cilat ofrojnë shërbime njëzet e katër orë, pra pa ndërprerje, pavarësisht orarit dhe kohës, duke ofruar në të njëjtën kohë siguri dhe saktësi gjatë përdorimit të tyre. Këto kanë bërë që të jenë edhe arsyet kryesore se pse instrumentet elektronike të pagesave janë përkrahur dhe kanë shënuar rritje të rëndësishme në përdorimin e tyre.

TË HYRAT NGA TARIFAT NË RAPORT MË NUMRIN E TRANSAKSIONEVE

Pavarësisht rritjes së ndjeshme në numra dhe vlera të gjithsej transaksioneve në kuadër të industrisë bankare në dy vitet e fundit, siç shihet në tabelën 9 dhe 10 në dy vitet e fundit, ku numri i transaksioneve është rritur për 56.9% në vitin 2013 dhe për 33.2% në vitin 2014, të hyrat nga jo interesi, ku bëjnë pjesë të hyrat nga tarifrat dhe komisionet, kanë ngelur afërsisht të njëjta.

NUMRI DHE VLERA E TRANSAKSIONEVE SI DHE TË HYRAT NGA JOINTERESI						
		2010	2011	2012	2013	2014
Nr.	Përshkrimi	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali
1.	Numri i transaksioneve	3,927,732	4,189,799	4,329,678	6,793,430	9,051,427
2.	Vlera e transaksioneve	4,660,207,982	5,086,557,617	5,680,957,532	1,499,093,438	6,830,312,337
3.	Të hyrat nga jointeresi (mil. euro)	41	45	47	50	48

Tab. 9 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese dhe raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Të hyrat nga jointeresi në vitin 2014 kanë shënuar ulje prej 3.6%, pavarësisht rritjes së numrit dhe vlerës së transaksioneve në këtë vit. Kjo tregon se industria bankare ka zvogëluar në mënyrë të ndjeshme tarifrat nga transaksionet, meqenëse këto të hyra kanë qenë relativisht të njëjta nëpër vite, megjithë rritjen e vazhdueshme të numrit dhe vlerave të transaksioneve.

TRENDI RITËS I NUMRIT DHE VLERAVE TË TRANSAKSIONEVE DHE TRENDI I TË HYRAVE NGA JOINTERESI					
		2011	2012	2013	2014
Nr.	Përshkrimi	Totali	Totali	Totali	Totali
1.	Numri i transaksioneve	6.7%	3.3%	56.9%	33.2%
2.	Vlera e transaksioneve	9.1%	11.7%	13.3%	6.1%
3.	Të hyrat nga jointeresi	8.6%	3.5%	6.4%	-3.6%

Tab. 10 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese dhe raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

Industria bankare është duke investuar shumë në teknologji, përmes të cilës mundëson që transaksionet të realizohen përmes instrumenteve elektronike të pagesave, duke stimuluar klientët përmes uljes së tarifave për ata që përdorin këto instrumente.

Strategjia e ndjekur nga industria bankare e Kosovës është në përputhje me strategjinë kombëtare të pagesave të hartuar nga Banka Qendrore e Kosovës, e cila synon avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve dhe produkteve elektronike, me qëllim të minimizimit në përdorim të parasë së gatshme, duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në uljen e ekonomisë joformale dhe zvogëlimin e shumë rreziqeve tjera që mund të rezultojnë nga përdorimi i parasë së gatshme.

INSTRUMENTET E PAGESAVE KRAHASUAR ME VENDET E EVROPËS JUGLINDORE

Industria bankare e Kosovës ka arritur që të zhvillohet viteve të fundit dhe të jetë e krahasueshme me vendet e tjera të rajonit apo edhe më larg, marrë parasysh këtu rrethanat në të cilat është zhvilluar industria bankare si dhe gjendja e bizneseve në Kosovë, kur këtu kemi parasysh listën e të bërit biznes sipas Bankës Botërore. Tabela 11 na jep një pasqyrë të përgjithshme mbi terminalet e pagesave dhe të instrumenteve të pagesave dhe krahasimi i tyre me vendet e tjera.

TABELA KRAHASUESE E INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE ME VENDET E EVROPES JUGLINDORE NË VITIN 2013

Nr.	Përshkrimi	Kosova	Shqipëria	Mali i Zi	Maqedonia	Bosnia	Serbia	Kroacia	Sllovenia	Çekia	Turqia	Bullgaria	Hungaria
1	Banorë	1.8	2.89	0.62	2.06	3.84	7.18	4.26	2.06	10.52	75.63	7.28	9.91
2	ATM	496	822	334	930	1,368	2,673	4,123	1,775	4,399	42,011	5,848	4,830
-	ATM (për 1 milion banorë)	273	284	539	451	356	372	968	862	418	555	803	487
-	ATM (për 100 km ²)	5	3	2	4	3	3	7	9	6	5	5	5
3	POS	9,071	5,668	11,111	37,167	20,402	59,822	92,221	35,594	95,723	2,293,695	70,752	90,795
-	POS (për 1 milion banorë)	4,984	1,961	17,921	18,042	5,313	8,332	21,648	17,279	9,099	30,328	9,719	9,162
-	POS (për 100 km ²)	83	20	80	145	40	77	163	176	121	293	64	98
4	Kredit katrela	109,332	64,432	49,289	313,365	209,059	955,221	360,131	112,579	1,609,673	56,835,221	802,306	1,351,026
-	Kredit kartela (për 1 milion banorë)	60,073	22,295	79,498	152,119	54,442	133,039	84,650	54,650	153,011	751,490	110,207	136,330
5	Debit kartela	645,048	741,128	347,572	1,188,947	1,562,277	5,133,080	6,798,984	2,530,183	8,777,337	100,164,954	6,934,154	7,595,444
-	Debit kartela (për 1 milion banorë)	354,422	256,446	560,600	577,159	406,843	714,914	1,596,006	1,228,244	834,348	1,324,408	952,494	766,442
6	Numri i llogarive E-banking	131,365	113,930	48,215	468,097	122,522	-	-	-	-	-	-	-
-	E-banking (për 1 milion banorë)	72,179	39,422	77,766	227,232	31,907	-	-	-	-	-	-	-

Tab. 11 | Burimi: BQK – Raporti vjetor mbi instrumentet e pagesave

Nëse merret parasysh numri i popullsisë dhe hapësira territoriale në të cilën jetojmë, mund të shohim se industria bankare në Kosovë në shumë prej këtyre instrumenteve është para Shqipërisë dhe e krahasueshme me shumë prej vendeve të rajonit. Sidoqoftë nëse merret parasysh edhe trendi në përqindje të rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike në Kosovë sidomos në dy vitet e fundit, të cilat u trajtuan në këtë publikim më lartë, atëherë mund të themi se Kosova është në nivel të kënaqshëm sa i përket ofrimit të infrastrukturës mbi shërbimet dhe produktet elektronike.




Fig. 5 | Burimi: BQK – Raporti vjetor mbi instrumentet e pagesave

Figura 5 tregon se sa bankomate ndodhen në një hapësirë prej 100 km², përmes të cilës mund të kuptojmë se Kosova është e krahasueshme me të gjitha shtetet e marra në krahasim, madje duke tejkaluar gjysmën e këtyre vendeve.




Fig. 6 | Burimi: BQK – Raporti vjetor mbi instrumentet e pagesave

Industria bankare në Kosovë nuk është inferiore edhe në raport me shpërndarjen e terminaleve të pikave të shitjes (POS), me ç’rast figura 6 tregon se Kosova është mbi pesë shtete dhe është e krahasueshme me vendet e tjera që e tejkalojnë këtë mesatare. Dihet se shpërndarja dhe përdorimi i pikave të shitjes varet shumë edhe nga zhvillimi i bizneseve në Kosovë të cilat pranojnë vendosjen e terminaleve në pikat e tyre, gjë që nënkupton se kjo meritë i takon të gjithë industrisë së ndërmarrjeve në vend.




Fig. 7 | Burimi: BQK – Raporti vjetor mbi instrumentet e pagesave

Sa i përket përdorimit të kartelave bankare, Kosova është mbi Shqipërinës për 1 milion banorë, përderisa është nën vendet e tjera që janë marrë për bazë krahasimi.




Fig. 8 | Burimi: BQK – Raporti vjetor mbi instrumentet e pagesave

E-banking në Kosovë është instrumenti elektronik i pagesave i cili ka shënuar rritjen më të madhe dhe nëse ky trend i rritjes vazhdon, atëherë shumë shpejt mund të presim që në mesatare të jetë në një nivel shumë të mirë në raport me vendet e rajonit. Në figurën 8 mund të shohim se numri i llogarive e-banking për një milion banorë është më i madh se sa ai në Shqipëri dhe Bosnie, përderisa nuk është larg nga mesatarja e Malit të Zi.

Në bazë të dhënave të paraqitura mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike për vendet e ndryshme, mund të përfundojmë se Kosova është në drejtim të mirë dhe është e krahasueshme me shumë prej vendeve të rajonit mbi infrastrukturën që e disponon industria bankare.

REFERENCAT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera deponituese, mars 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash, shkurt 2015, <http://bqk-kos.org/?id=125> ;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti tremujor mbi instrumentet cash dhe jocash, janar 2015, http://bqk-kos.org/repository/docs/SistemilPagesave/Tre_mujor.pdf;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor mbi instrumentet e pagesave, shtator 2014, <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemilPagesave/Raport%20vjetor%20krahasues%20mbi%20instrumentet%20elektronike%201.pdf>

PERIODIKU BANKAR - MAJ 2015

INDIKATORËT KRYESOR TË EKONOMISË NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

BRUTO PRODHIMI VENDOR



Bruto prodhimi vendor është një tregues ekonomik i cili e paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një vendi për një periudhë të caktuar kohore. Zakonisht kjo periudhë është vjetore. Bruto prodhimi vendor është ndër treguesit kryesor makroekonomik për të matur rritjen ekonomike.

Ajo mund të llogaritet në tri mënyra: llogaritja sipas prodhimit, sipas të ardhurave dhe sipas shpenzimeve të cilat japin të njëjtin rezultat. Llogaritja sipas prodhimit e cila është mënyra më e drejtpërdrejtë përfshinë vlerën e tregut të të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të llogaritura gjatë një viti.

BRUTO PRODHIMI VENDOR							BPV (US\$)
Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	
Shqipëria	12,881,353,508	12,044,208,086	11,926,957,255	12,890,866,743	12,344,529,628	12,923,240,278	
Bosnia dhe Hercegovina	18,711,890,354	17,264,893,103	16,847,493,059	18,318,439,121	16,906,005,781	17,851,326,454	
Kroacia	70,461,454,280	62,636,688,809	59,643,818,182	62,241,414,803	56,479,515,972	57,868,674,298	
Kosova	5,687,488,209	5,653,860,934	5,830,320,265	6,692,502,502	6,499,938,584	7,071,959,241	
Maqedonia	9,834,034,351	9,313,573,965	9,338,674,078	10,395,222,334	9,576,482,628	10,195,404,131	
Mali i Zi	4,538,345,345	4,158,135,026	4,114,881,347	4,501,753,898	4,045,813,953	4,416,083,090	
Serbia	49,259,526,053	42,616,653,300	39,368,633,038	46,462,547,041	40,791,444,603	45,519,650,911	

Tab. 1 | Burimi: Banka Botërore – GDP

Siç shihet në tabelën 1, Kosova ka vlerën më të ulët pas Malit të Zi mbi bruto prodhimin e brendshëm dhe bën pjesë në grupin e shteteve me të ardhura mesatare të vogla. Ajo çka është e rëndësishme të vlerësohet është se Kosova në të gjitha vitet krahasuese ka shënuar rritje të vazhdueshme në gjithësej vlerën e bruto prodhimit.

Kroacia si anëtare e re e Bashkimit Evropian ka vlerën më të lartë të bruto prodhimit, përderisa Serbia renditet në vendin e dytë në kuadër të vendeve të ballkanit perëndimor.

RRITJA VJETORE E BRUTO PRODHIMIT VENDOR						
Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	7.54%	3.35%	3.71%	2.55%	1.62%	1.42%
Bosnia dhe Hercegovina	5.42%	-2.91%	0.70%	0.96%	-1.21%	2.48%
Kroacia	2.05%	-7.38%	-1.70%	-0.28%	-2.19%	-0.94%
Kosova	3.60%	3.30%	4.40%	2.80%	3.40%	3.00%
Maqedonia	4.95%	-0.92%	2.90%	2.80%	-0.40%	3.10%
Mali i Zi	6.92%	-5.66%	2.46%	3.23%	-2.55%	3.34%
Serbia	5.37%	-3.12%	0.58%	1.40%	-1.02%	2.60%

Tab. 2 | Burimi: Banka Botërore – GDP Growth




Fig. 1 | Burimi: Banka Botërore – GDP Growth

Në vitet e marra për bazë krahasimi nga figura 1 dhe tabela 2 shihet se vetëm Shqipëria dhe Kosova kanë shënuar rritje të vazhdueshme pozitive të bruto prodhimit vendor, përderisa vendet e tjera në vite të caktuara kanë shënuar vlera negative. Edhe pse Kroacia është shteti me bruto prodhimin më të madh në ballkanin perëndimor, ajo në pesë vitet e fundit ka shënuar vlera negative të saj.

BRUTO PRODHIMI VENDOR PËR KOKË BANORI						BPV (US\$)
Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	4,370.54	4,114.13	4,094.36	4,437.81	4,256.02	4,460.34
Bosnia dhe Hercegovina	4,846.13	4,480.38	4,380.60	4,771.27	4,409.59	4,661.76
Kroacia	15,889.35	14,142.15	13,500.85	14,540.27	13,234.62	13,597.92
Kosova	3,254.86	3,209.73	3,283.43	3,736.83	3,596.88	3,877.17
Maqedonia	4,685.62	4,433.86	4,442.30	4,940.95	4,548.16	4,838.46
Mali i Zi	7,335.90	6,713.08	6,636.07	7,253.36	6,514.15	7,106.86
Serbia	6,701.77	5,821.31	5,399.30	6,422.71	5,666.20	6,353.83

Tab. 3 | Burimi: Banka Botërore – GDP per capita

Kosova edhe në bazë të mesatares për kokë banori ka vlerën më të vogël të bruto prodhimit vendor, megjithëse jo shumë larg nga Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina apo edhe Maqedonia. Në këtë krahasim, Kroacia është e para, përderisa Mali i Zi renditet i dyti në rajon me mesataren më të lartë për kokë banori, pas saj renditen Serbia, Maqedonia e kështu me rradhë.

INFLACIONI, PAPUNËSIA DHE TË BËRIT BIZNES

Inflacioni paraqet rritjen e sasisë së ofertës së parasë në qarkullim në një ekonomi të caktuar brenda një periudhe të caktuar kohore. Një nga efektet që mund të shoqërohet me inflacionin është edhe rritja e çmimeve të të mirave materiale dhe shërbimeve. Me pak fjale kjo nënkupton zhvlerësimin i mjeteve kur me një sasi të caktuar të të hollave blihen më pak prodhime apo shërbime se sa përpara zhvlerësimit. Fenomeni i kundërt i saj është deflacioni.

Për shkak të efekteve ekonomike gjithnjë e më të mëdha globale si dhe për shkak se Kosova nuk ka njësi monetare të saj përmes secilës do të mund të zbatonte politikat e saj monetare, Kosova nuk mund të bëjë edhe aq shumë në uljen apo rritjen e këtij inflacioni, meqenëse paraja zyrtare e saj është euro dhe pak a shumë diktohen trendet e njëjta nga evropa me ndryshime të vogla.



INFLACIONI SIPAS ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	3.36%	2.28%	3.55%	3.45%	2.03%	1.94%	1.63%
Bosnia dhe Hercegovina	7.42%	-0.39%	2.19%	3.68%	2.05%	-0.09%	-0.93%
Kroacia	6.09%	2.40%	1.04%	2.25%	3.42%	2.21%	-0.21%
Kosova	9.35%	-2.41%	3.48%	7.34%	2.48%	1.76%	0.43%
Maqedonia	8.33%	-0.74%	1.51%	3.90%	3.32%	2.78%	-0.28%
Mali i Zi	8.76%	3.47%	0.65%	3.45%	4.15%	2.21%	-0.71%
Serbia	12.41%	8.12%	6.14%	11.14%	7.33%	7.69%	2.08%

Tab. 4 | Burimi: Banka Botërore – Inflation, consumer prices




Fig. 2 | Burimi: Banka Botërore – Inflation, consumer prices



Në tabelën 4 dhe figurën 2 mund të shohim se në vendet e ballkanit perëndimor trendet e normës së inflacionit kanë qenë afërsisht të njëjta me disa ndryshime të vogla varësisht prej shtetit. Në këtë krahasim mund të shohim se Serbia ka pas lëvizje më të mëdha të normës së inflacionit gjatë viteve të kaluara. Kosova në vitet krahasuese, normën më të lartë e ka pas në vitin 2008, përderisa në tri vitet e fundit kjo gjë është stabilizuar.


Në përgjithësi për shkak të efektit global nga ekonomitë më të mëdha në Evropë dhe botë, mund të shohim se shtetet e ballkanit perëndimor janë të ndikuara nga këto trende, sidomos viti 2008 në kohën e krizës ekonomike globale.

Papunësia paraqet një nga problemet makroekonomike në një vend. Pasojat nga numri i madh i papunësisë mund të jenë si rënia e bruto prodhimit të brendshëm, rënia e të ardhurave në familje, apo përkeqësimi i varfërisë. Papunësia paraqet numrin e popullsisë në moshë pune ndërmjet 16 - 65 vjeç, duke zbritur nga ky numër ata që nuk janë aktiv dhe që nuk konsiderohen si forcë pune, përderisa llogaritet diferenca ndërmjet atyre që konsiderohen si forcë pune në kuadër të kësaj moshe në raport me numrin e të papunëve.

PAPUNËSIA SIPAS FUQISË PUNËTORE						
Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	13.0%	13.8%	14.2%	14.0%	13.9%	16.0%
Bosnia dhe Hercegovina	23.9%	24.1%	27.2%	27.6%	28.1%	28.4%
Kroacia	8.4%	9.1%	11.8%	13.4%	15.8%	17.7%
Kosova*	47.5%	45.4%			30.9%	30.0%
Maqedonia	33.8%	32.2%	32.0%	31.4%	31.0%	29.0%
Mali i Zi	16.8%	19.1%	19.7%	19.7%	19.6%	19.8%
Serbia	13.6%	16.6%	19.2%	23.0%	23.9%	22.2%

*Të dhënat për Kosovën janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tab. 5 | Burimi: Banka Botërore – Unemployment (% of total labor force)



*Të dhënat për Kosovën janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

Fig. 3 | Burimi: Banka Botërore – Unemployment (% of total labor force)

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 5 dhe figurën 3 mund të shohim se Kosova ka normën më të lartë të papunësisë e cila në fund të vitit 2013 shënon shkallën prej 30%. Në fund të vitit 2013 Shqipëria ka shënuar shkallën më të ulët të papunësisë në krahasim me të gjitha vendet e ballkanit perëndimor, pra më të ulët se sa Kroacia e cila ishte lidere në të dhënat e marra për bazë krahasimi deri më tani. E dyta për nga norma më e lartë e papunësisë renditet Maqedonia e cila nuk është larg Kosovës me 29%.

Një nga indikatorët i cili e vlerëson punën në ekonominë e një vendi është edhe raporti vjetor i cili publikohet nga Banka Botërore i cili analizon dhe bën matjen e shpenzimeve që ndërmarrjeve i shkaktohen nga zbatimi apo mos zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve të atij vendi. Aktualisht banka botërore ka për bazë krahasimi 189 ekonomi të vendeve të ndryshme nëpër botë. Tabela në vijim tregon renditjen e vendeve të ballkanit perëndimor në këtë listë krahasuese me këto ekonomi.

RENDITJA E TË BËRIT BIZNES		
Shteti	2013	2014
Shqipëria	108	68
Bosnia dhe Hercegovina	104	107
Kroacia	67	65
Kosova	81	75
Maqedonia	31	30
Mali i Zi	42	36
Serbia	77	91

Tab. 6 | Burimi: Banka Botërore – Ease of doing business index

Në kuadër të kësaj liste krahasuese, Kosova në krahasim me vendet e ballkanit perëndimor renditet para Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë, përderisa në këtë listë më së miri është e pozicionuar Maqedonia. Pas saj radhitet Mali i Zi, Kroacia dhe Shqipëria. Është e rëndësishme të theksohet se Kosova ka bërë përmirësime të ndjeshme në vitet e fundit përmes reformave që i ka ndjekur dhe nëse vazhdon ky trend, atëherë pritet që në një të ardhme të afërt Kosova të jetë e renditur edhe më mirë në raport me vendet e tjera.

NORMAT E INTERESIT TË INDUSTRIJË BANKARE

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i cili merrët për bazë nga raporti i Bankës Botërore mbi të bërit biznes është edhe qasja në financa e ndërmarrjeve të atij vendi. Qasja në financa nuk nënkupton vetëm se sa është përqindja e normës së interesit të institucioneve financiare që e ofrojnë për të marrë hua, mirëpo nënkupton edhe se sa janë të gatshme ato biznese të plotësojnë kriteret e kërkuara për t'u kualifikuar për huadhënie.

Në këtë numër do të trajtohet norma efektive e interesit e cila poashtu paraqet një faktorë të rëndësishëm për të marrë ndërmarrjet kredi. Norma efektive tregon koston e asaj kredie deri në afatin e maturimit të saj, pra deri në kthimin e asaj kredie, duke përfshirë këtu normën nominale të interesit dhe të gjitha shpenzimet e tjera administrative. Poashtu do të trajtohet edhe norma efektive e interesit në depozita, e cila paraqet koston që institucioneve financiare i kushton mbajtja e atyre depozitave në llogaritë bankare.

Të dhënat e paraqitura në vijim mbi normat e interesit, janë të dhëna të marra nga banka botërore e cila i publikon në baza vjetore dhe këto të dhëna janë të shprehura në forma të ndryshme, varësisht se a posedon ai shtet përkatës valutë vendore apo euro. Megjithatë të dhënat e paraqitura janë indikatorë të mirë për të interpretuar dhe krahasuar Kosovën me vendet e tjera të ballkanit perëndimor.

NORMA E INTERESIT NË KREDI							
Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	13.0%	12.7%	12.8%	12.4%	10.9%	9.8%	8.7%
Bosnia dhe Hercegovina	7.0%	7.9%	7.9%	7.4%	10.9%	9.8%	8.7%
Kroacia	10.1%	11.6%	10.4%	9.7%	9.5%	9.2%	
Kosova	13.8%	14.1%	14.3%	13.9%	12.9%	11.1%	9.2%
Maqedonia	9.7%	10.1%	9.5%	8.9%	8.5%	8.0%	7.5%
Mali i Zi	9.2%	9.4%	9.5%	9.7%	9.6%	9.4%	9.4%
Serbia	16.1%	11.8%	17.3%	17.2%	18.2%	17.1%	14.8%

Tab. 7 | Burimi: Banka Botërore – Lending interest rate




Fig.4 | Burimi: Banka Botërore – Lending interest rate

Tabela 7 tregon se Kosova në krahasim me vendet e ballkanit perëndimor ka shënuar përmirësime të dukshme sa i përket mesatares së normës efektive të interesit në kredi, sidomos në vitin e fundit. Nëse vazhdohet ky trend i uljes së normës së interesit, atëherë shumë shpejt pritet të kemi norma ndër më të ultat në rajon. Në fund të vitit 2014, Kosova ka normë më të ulët të interesit se Serbia dhe Mali i Zi, përderisa ka normë më të lartë të krahasueshme me Shqipërinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Në këtë krahasim, Maqedonia ka normën më të ulët të interesit në kredi.

NORMA E INTERESIT NË DEPOZITA							
Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	6.8%	6.8%	6.4%	5.9%	5.4%	4.2%	1.9%
Bosnia dhe Hercegovina	3.5%	3.6%	3.2%	2.8%	3.2%	3.0%	2.7%
Kroacia	2.8%	3.2%	1.8%	1.7%	1.9%	1.5%	
Kosova	4.4%	4.0%	3.4%	3.6%	3.7%	2.4%	1.1%
Maqedonia	5.9%	7.0%	7.1%	5.9%	5.1%	4.4%	3.7%
Mali i Zi	3.8%	3.8%	3.7%	3.1%	3.3%	2.9%	2.1%
Serbia	7.3%	5.1%	11.3%	9.8%	10.6%	7.9%	6.8%

Tab. 8 | Burimi: Banka Botërore – Deposit interest rate

Tabela 8 paraqet normën efektive të interesit në depozita, me ç'rast mund të shohim se Kosova në krahasim me vendet e ballkanit perëndimor ka normën më të ulët në depozita, përderisa pas saj rradhitet Shqipëria dhe Mali i Zi. Serbia ka normën më të lartë të saj me 6.8%, për faktin se ka edhe normat më të larta të interesit për kredi.

DIFERENCA NDËRMJET NORMËS SË INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA							
Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	6.2%	5.9%	6.4%	6.6%	5.5%	5.7%	6.7%
Bosnia dhe Hercegovina	3.5%	4.3%	4.7%	4.6%	3.7%	4.0%	4.0%
Kroacia	7.2%	8.4%	8.6%	8.0%	7.6%	7.7%	
Kosova	9.4%	10.1%	10.9%	10.2%	9.1%	8.7%	8.1%
Maqedonia	3.8%	3.0%	2.4%	3.0%	3.4%	3.6%	3.8%
Mali i Zi	5.4%	5.5%	5.8%	6.6%	6.3%	6.5%	7.3%
Serbia	8.8%	6.7%	6.0%	7.4%	7.6%	9.2%	8.0%

Tab. 9 | Burimi: Banka Botërore – Interest rate spread (lending rate minus deposit rate, %)




Fig. 5 | Burimi: Banka Botërore – Interest rate spread (lending rate minus deposit rate, %)

Tabela 9 dhe figura 5 tregojnë diferencën ndërmjet normës së interesit në kredi dhe depozita. Sic shihet edhe nga trendi i paraqitur, Kosova ka shënuar përmirësim të ndjeshëm sa i përket ofrimit të kushteve më të mira për qytetarët e saj, sidomos në vitin e fundit, duke qenë e krahasueshme me shumë prej vendeve të ballkanit perëndimor. Në këtë krahasim, Maqedonia vazhdon ta ketë diferencën më të vogël të shënuar ndërmjet dy normave të interesit.

Duke marrë parasysh ambientin e të bërit biznes në Kosovë sidomos tek çështja e zbatimit të kontratës dhe vështirësive me të cilat ballafaqohet industria bankare në vend, mund të vlerësojmë se në këtë mes industria bankare ka performuar mirë duke shënuar vlera pozitive të rritjes për të gjithë indikatorët e saj, duke ofruar kështu siguri të qëndrueshme dhe besim tek qytetarët e vendit, gjë që paraqet aspekt shumë të rëndësishëm për zhvillim më të qëndrueshëm për të ardhmën.

Tek procesi i lëshimit të kredisë është e rëndësishme që bankat të sigurojnë më të mirën e tyre se huadhënia e dhënë të kthehet në bazë të planit të përcaktuar në bashkëpunim me klientët, në mënyrë që të menaxhohet kujdesshëm edhe çështja e kredive jo-performuese. Tabela në vijim tregon përqindjen e kredive jo-performuese në rajon.

KREDITË JO-PERFORMUESE NË RAPORT ME GJITHSEJ KREDITË							
Shteti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	6.6%	10.5%	14.0%	18.8%	22.5%	23.5%	
Bosnia dhe Hercegovina	3.1%	5.9%	11.4%	11.8%	13.5%	15.1%	15.5%
Kroacia	4.9%	7.7%	11.1%	12.3%	13.8%	15.4%	16.4%
Kosova	3.3%	4.3%	5.8%	5.7%	7.4%	8.5%	8.2%
Maqedonia	6.7%	8.9%	9.0%	9.5%	10.1%	10.9%	11.3%
Mali i Zi	7.2%	13.5%	21.0%	15.5%	17.6%	18.4%	17.2%
Serbia	11.3%	15.7%	16.9%	20.0%	18.6%	21.4%	23.0%

Tab. 10 | Burimi: Banka Botërore – Bank nonperforming loans to total gross loans




Fig. 6 | Burimi: Banka Botërore – Bank nonperforming loans to total gross loans

Në tabelën 10 dhe figurën 6 mund të shohim se Kosova ka normën më të ulët të kredive jo-performuese në raport me vendet e ballkanit perëndimor. Pas saj është Maqedonia, Bosnja dhe kështu me rradhë, përderisa nga të dhënat e fundit të vitit 2013, shifrat e vendosin Shqipërinë me normën më të lartë në rajon sa i përket kredive jo-performuese.

Kjo tregon se në Kosovë industria bankare ka qene më konzervative dhe shumë më e kujdesshme gjatë procesit të lëshimit të kredive, duke i dhënë kështu rëndësi primare kualitetit të portfolios të kredive.

REFERENCAT

Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2012 dhe 2013, qershor 2015*, <https://ask.rks-gov.net/tregu-i-punes/publikimet>;

Banka Botërore, *Bank nonperforming loans to total gross loans (%)*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/FB.AST.NPER.ZS/countries>;

Banka Botërore, *Deposit interest rate*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/FR.INR.DPST/countries>;

Banka Botërore, *Ease of doing business index*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/IC.BUS.EASE.XQ>;

Banka Botërore, *Inflation, consumer prices (annual %)*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/FP.CPI.TOTL.ZG/countries>;

Banka Botërore, *Interest rate spread (lending rate minus deposit rate, %)*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/FR.INR.LNDP/countries>;

Banka Botërore, *GDP (current US)*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.CD/countries>;

Banka Botërore, *GDP growth (annual %)*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.KD.ZG/countries>;

Banka Botërore, *GDP per capita (current US)*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD/countries>;

Banka Botërore, *Unemployment, total (% of total labor force)*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/SL.UEM.TOTL.ZS>;

Banka Botërore, *Lending interest rate*, qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/FR.INR.LEND/countries>;

PERIODIKU BANKAR - QERSHOR 2015

PASQYRA E TË ARDHURAVE TË INDUSTRIISË BANKARE NË KOSOVË

TË HYRAT E INDUSTRIISË BANKARE NË KOSOVË



Industria bankare në Kosovë ka vazhduar të shënoj rritje të vazhdueshme në indikatorët kryesor të saj, gjë që ka bërë që ky sektor të jetë më i besueshëm dhe më i sigurtë në performancën e saj. Në këtë kontekst edhe të hyrat e industrisë bankare kanë vazhduar të kenë vlera pozitive si në rritje, ashtu edhe në raport me shpenzimet e kësaj industrie. Kjo nënkupton se industria bankare në baza të vazhdueshme ka qenë profitabile, gjë kjo shumë e nevojshme për të performuar në baza stabile për çdo biznes, duke bërë kështu që edhe depozitat e qytetarëve të Kosovës të jenë të sigurta.

TË HYRAT E INDUSTRIISË BANKARE								Milion Euro
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimi	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	169.6	2.7	3.1	0.4	37.5	3.9	-	217.2
2011	186.3	4.1	4.2	0.5	41.7	3.3	-	240.1
2012	194.9	2.0	3.0	0.6	44.2	2.4	-	247.0
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	189.5	1.1	2.9	2.5	44.5	3.3	0.5	244.2

Tab. 1 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

Nga tabela 1 e paraqitur mund të shihet se industria bankare ka pas afërsisht të hyra të njëjta nëpër vite, me rritje të lehtë prej vitit në vit, me përjashtim të vitit të fundit kur të hyrat ishin për 4.8 milion euro më pak apo për 1.9% më pak të hyra në raport me vitin 2013.

Siç mund të shihet, ky zvogëlim prej 4.8 milion euro ka ardhur si rezultat i zvogëlimit të të hyrave nga interesi për kreditë e lëshuara, me ç'rast industria bankare ka inkasuar 3 milion euro apo 1.55% më pak të hyra nga interesi për kredi, si dhe 1.1 milion euro apo 2.4% më pak nga të hyrat që vijnë nga tarifrat dhe komisionet. Kjo dëshmon se industria bankare vetëm gjatë vitit të fundit (2014) ka arritur që të ulë ndjeshëm normat e interesit për kreditë e lëshuara, megjithëse vlerat totale të kredive të lëshuara janë rritur gjatë vitit të fundit, si dhe ka bërë zvogëlimin e tarifave dhe komisioneve që i aplikojnë ndaj klientëve për shërbimet dhe produktet që i ofron. Zvogëlimi i tarifave dhe komisioneve është bërë kryesisht tek përdorimi i shërbimeve dhe produkteve elektronike për të cilat industria bankare ka bërë investime të mëdha, me ç'rast përmes çmimeve më të lira për këto instrumente ka synuar stimulimin e përdorimit sa më të madh të shërbimeve elektronike me qëllim të zvogëlimit të përdorimit të parasë së gatshme. Të dhënat statistikore tregojnë që kjo strategji e ndjekur nga bankat ka pas sukses.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese




Fig. 2 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

Siç shihet edhe nga figurat 1 dhe 2, pjesën kryesore të të hyrave të industrisë bankare e përbëjnë të hyrat nga interesi në të cilin bëjnë pjesë të hyrat nga interesi në kredi, plasmanet me banka, letrat me vlerë dhe të tjerat. Në grupin e të hyrave kryesore të industrisë bankare bëjnë pjesë edhe të hyrat nga jo interesi, përkatësisht të hyrat nga tarifat dhe komisionet.

Pra, aktiviteti kryesor i industrisë bankare mbetet huadhënia, gjë që pasqyrohet në pasqyrën e të hyrave të kësaj industrie.

Edhe viti 2015 i performimit të industrisë bankare ka vazhduar të jetë afërsisht i njëjtë, me ç’rast të hyrat nga interesi në kredi dhe të hyrat nga tarifat dhe komisionet kanë shënuar një rënie të vogël. Kjo mund të shihet në tabelën 2 të paraqitur në vijim.

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE								Milion Euro
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimi	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative	-	
Maj 2014	77.7	0.6	1.0	1.3	18.6	1.2	0.2	100.6
Maj 2015	76.2	0.3	1.7	0.1	18.5	4.6	0.8	102.2

Tab. 2 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

Për qëllime krahasimi të të hyrave të industrisë bankare për këtë vit (2015), janë marrë të dhënat deri në muajin maj të vitit 2014. Nga gjithsej të hyrat deri në muajin maj 2015, shihet se në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, janë 1.6 milion euro apo 1.59% më shumë të hyra.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

Siç shihet nga figura 3 është një ndryshim në strukturën e të hyrave të industrisë bankare gjatë vitit 2015 në raport me strukturën e të hyrave në fund të vitit 2014, meqenëse në kuadër të strukturës së të hyrave, përqindja e të hyrave nga interesi në gjithsej të hyrat e industrisë ka rënë nga 80.2% në 76.6%, të hyrat nga tarifat dhe komisionet nga 18.2% në 18.1%, përderisa kanë shënuar rritje të ardhurat tjera operative nga 1.4% në 4.5%.

SHPENZIMET E INDUSTRIËS BANKARE

Shpenzimet e industrisë bankare në dy vitet e fundit të saj kishin shënuar ulje të ndjeshme, gjë që ka bërë që edhe diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve të rritet, duke bërë kështu që edhe fitimi i industrisë të jetë më i madh, megjithëse në vitin 2014 mund të shihet se të hyrat kishin shënuar një ulje të lehtë në raport me vitin 2013.

SHPENZIMET E INDUSTRIËS BANKARE											Milion Euro
Periodha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp. të përgjithshme dhe admin.			Humbjet nga rivler.	Provizioni për taksa	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp. personelit	Shp. të përgjithshme	Shp. tjera nga jo-interesi			
2010	49.4	4.8	1.1	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	1.2	4.3	184.8
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	1.2	4.2	204.1
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	0.7	3.3	228.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	-	3.2	223.0
2014	36.4	3.1	4.5	11.1	20.5	42.4	34.8	24.5	-	6.8	184.2

Tab. 3 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese



Shpenzimet e industrisë bankare në fund të vitit 2014 kanë shënuar ulje për 38.8 milion euro apo për 17.4% në raport me fundin e vitit 2013. Pjesa më e madhe e kësaj uljeje ka ardhur nga zvogëlimi i provizioneve për humbjet e kredive për 25.6 milion euro apo për 55.5%. Zvogëlimi i vlerës nga provizionimi për humbjet e kredive tregon se kualiteti i portfolios kreditore është përmirësuar dukshëm, duke i lejuar bankave që të kenë më pak shpenzime për këtë kategori. Industria bankare gjithashtu ka bërë zvogëlimin e shpenzimeve të interesit, përkatësisht zvogëlimin e interesave të paguara për depozita për 21.6 milion euro apo për 37.2%.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

Në kuadër të gjithsej shpenzimeve të industrisë bankare, në bazë të figurës 4, pjesën më të madhe e përbëjnë shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, duke vazhduar me shpenzimet e interesit, shpenzimet e jo-interesit dhe të tjerat me rradhë.

Ndryshimi në strukturën e shpenzimeve të industrisë bankare nga viti 2013 në vitin 2014 mund të shihet gjithashtu në figurën 4, me ç’rast shpenzimet e jo-interesit janë zvogëluar për 7.7% (ku bëjnë pjesë provizionet për humbjet e kredive) dhe shpenzimet e interesit për 4.7%.

Trendi i zvogëlimit të shpenzimeve të industrisë bankare ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015, pëkatësisht deri në muajin maj, nëse krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit 2014.

SHPENZIMET E INDUSTRIËS BANKARE										Milion Euro	
Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp. të përgjithshme dhe admin.			Humbjet nga rivler.	Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp. personelit	Shp. të përgjithshme	Shp. tjera nga jo-interesi			
Maj 2014	19.0	1.1	1.9	4.8	11.7	17.2	14.2	8.7	-	2.5	81.2
Maj 2015	7.7	1.8	0.6	4.6	2.9	17.1	13.4	10.1	-	3.6	61.9

Tab. 4 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

Në bazë të tabelës 4 mund të shihet se gjithsej shpenzimet e industrisë bankare për pesë muajtë e parë të vitit 2015 në krahasim me vitin 2014 janë zvogëluar për 19.3 milion euro apo për 23.7%. Edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar zvogëlimi i ndjeshëm i shpenzimeve që industria bankare ka paguar për provizionet për humbjet nga kreditë, me ç’rast për 8.8 milion euro apo për 75.2% është zvogëluar vlera e provizionimit. Gjithashtu janë zvogëluar edhe shpenzimet e interesit për depozita për 11.3 milion euro apo për 59.4%. Kjo tregon se industria bankare vazhdon të tregoj pjekuri edhe më të madhe duke ruajtur dhe përmirësuar edhe më shumë kualitetin e portfolios së saj kreditore duke bërë që shpenzimet e provizionimit të zvogëlohen.




Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

Struktura e gjithsej shpenzimeve të industrisë bankare gjatë vitit 2015 ka vazhduar të ndryshoj në krahasim me vitet paraprake, me ç’rast në figurën 5 mund të shihet se shpenzimet e përgjithshme kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në 65.7%, përderisa shpenzimet e interesit janë zvogëluar në 16.4% dhe shpenzimet e jo-interesit në 12.1%.

TË ARDHURAT NETO OPERATIVE TË INDUSTRIËSË BANKARE



Megjithëse të hyrat ishin pa ndryshime të mëdha në katër vitet e fundit, zvogëlimi i shpenzimeve të industrisë bankare veçanërisht në dy vitet e fundit, ka bërë që industria bankare të ketë një profit më të madh të realizuar në fund të vitit 2014.

TË ARDHURAT NETO OPERATIVE TË INDUSTRIËSË BANKARE			
Milion Euro			
Periudha	Të hyrat	Shpenzimet	Fitimi neto
	A	B	A-B=C
2010	217.2	184.8	32.4
2011	240.1	204.1	36.0
2012	247.0	228.6	18.5
2013	249.0	223.0	26.0
2014	244.2	184.2	60.1

Tab. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese




Fig. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

Siç shihet nga tabela 5 dhe figura 6, industria bankare në fund të vitit 2014 ka shënuar rritje të fitimit neto në raport me vitin 2013 për 34.1 milion euro apo rritje të fitimit për 131.1%, përderisa mund të shihet se shpenzimet kishin trend rënës në dy vitet e fundit.

Ky trend i ngjashëm i zvogëlimit të shpenzimeve dhe rritjes së fitimit neto ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015, përderisa të hyrat janë afërsisht të njëjta. Tabela 6 e tregon këtë trend në vijim.

TË ARDHURAT NETO OPERATIVE TË INDUSTRIËSË BANKARE			
Milion Euro			
Periudha	Të hyrat	Shpenzimet	Fitimi neto
	A	B	A-B=C
Maj 2014	100.6	81.2	19.4
Maj 2015	102.2	63.0	39.2

Tab. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese

interesi për kredi duke i mundësuar qytatarëve të Kosovës kredi me norma të interesit më të ulëta, përderisa në të njëjtën kohë të arrij të menaxhoj që për nevoja të biznesit dhe për qëllime të fitimit të saj të mbaj nivelin e të hyrave afërsisht të njëjtë. Gjithashtu ka arritur që ta menaxhoj portfolion e saj kreditore edhe me më shumë sukses, duke ulur shpenzimet e provizionimit dhe duke bërë që kjo industri të realizoj fitim neto më të madh në vitin e fundit, duke garantuar kështu besueshmëri tek qytatarët për qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar si dhe duke ofruar siguri të madhe për depozitat e tyre. Kjo qëndrueshmëri dhe stabilitet financiar është shumë i rëndësishëm edhe për zhvillimin ekonomik në vend, meqenëse përmes këtij sektori bëhet kreditimi i kësaj ekonomie.

REFERENCAT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave të korporatave tjera depozituese, korrik 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

PERIODIKU BANKAR - KORRIK 2015
KREDITË NË KUADËR TË ASETIVE TË INDUSTRIË
BANKARE NË KOSOVË

KREDITË NË KUADËR TË ASETEVE TË INDUSTRIISË BANKARE



Asetet e industrisë bankare në Kosovë kanë vazhduar të shënojnë rritje të vazhdueshme, gjë që ka bërë që ky sektor të jetë më i besueshëm dhe më i sigurtë në performancën e saj. Në këtë kontekst edhe gjithsej vlera e kredive e industrisë bankare ka vazhduar të shënoj rritje, në raport afërsisht të njëjtë me gjithsej asetet e kësaj industrie. Kjo nënkupton se industria bankare në baza të vazhdueshme ka zhvilluar afarizëm të qëndrueshëm dhe profitabil, gjë kjo shumë e nevojshme për të performuar në baza stabile për çdo biznes, duke bërë kështu që edhe depozitat e qytetarëve të Kosovës të jenë të sigurta.

STRUKTURA E ASETEVE TË INDUSTRIISË BANKARE (2010 – QERSHOR 2015)						Million Euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Qer - 2015
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	397.4
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.8	341.9
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	443.8
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.3	2,005.2
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	52.7
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	28.8	28.6
Gjithsej Asete	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,186.6	3,269.6

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese

Asetet e industrisë bankare kanë shënuar rritje, me ç'rast vetëm në gjysmën e parë të vitit 2015 kanë shënuar rritje për 2.6%, përderisa rritja e aseteve për komplet vitin 2014 ishte 4.1%. Siç shihet në tabelën 1, në kuadër të gjithsej aseteve pjesën kryesore të saj e përbëjnë kreditë dhe lizingu, letrat me vlerë, paraja e gatshme dhe kështu me radhë. Është e rëndësishme të theksohet se paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në kanë shënuar ulje, me ç'rast mund të thuhet se industria bankare është e orientuar më shumë drejt përdorimit të shërbimeve elektronike, duke zvogëluar kështu nevojën për para të gatshme.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese

Nëse krahasojmë pjesëmarrjen e kredive dhe lizingut në kuadër të gjithsej asetëve të industrisë bankare në figurën 1, atëherë mund të shohim se kjo pjesëmarrje është rritur për dallim nga viti 2010, nga 59.4% në 61.3% në qershor të 2015. Rritje të ndjeshme në pjesëmarrje kanë shënuar gjithashtu letrat me vlerë nga viti 2010, nga 7.1% në 13.6% në qershor të 2015. Bilanci me bankat komerciale ka shënuar ulje në pjesëmarrje nga 17.9% në 10.5% ndërmjet këtyre dy periudhave krahasuese.

Si një nga pjesëmarrësit më të mëdhenjë në gjithsej strukturën e asetëve, kreditë dhe lizingu, kanë shënuar rritje të vazhdueshme në periudhat e marra për krahasim të cilat mund të shihen në tabelën 2 dhe figurën 2.

RRITJA E KREDIVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2011 – QERSHOR 2015)					
Përshkrimi	2011	2012	2013	2014	Qer - 2015
Kreditë dhe lizingu	16.4%	3.8%	2.4%	4.2%	6.5%

Tab. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese




Fig. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese

Në fund të qershorit 2015, vlera e kredive dhe lizingut ka arritur në mbi 2 miliardë euro dhe nëse vazhdohet me këtë trend të rritjes, atëherë pritet që përqindja e rritjes vjetore të portfolios kreditore të jetë shumë më e madhe në këtë vit, në krahasim me vitin që shkoj.

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK



Industria bankare gjatë procesit të huadhënies, krediton sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke iu përshtatur kushteve, specifikave dhe kriterëve të veçanta që ndërlidhen me atë sektor. Në këtë kontekst edhe portfolio aktuale kreditore e industrisë bankare është e ndryshme, megjithëse ajo dominohet nga kreditë e lëshuara për sektorin e tregtisë.

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010 - QERSHOR 2015)										Milion Euro
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restorantet	Tregti tjetër	Shërbimet tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	135.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	154.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	163.3	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	171.3	1,217.4
2014	49.4	19.7	148.9	17.1	104.2	664.0	49.7	17.1	172.6	1,242.8
Qer - 15	51.0	18.7	168.5	20.5	103.6	723.3	54.0	18.2	182.3	1,340.1

Tab. 3 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktiviteti ekonomik

Siç shihet nga tabela 3, kreditë e lëshuara për tregti dominojnë në raport me sektorët e tjerë të ekonomisë, duke përbërë 54.0% në fund të muajit qershor 2015. Një shumë të konsiderueshme të portofolios kreditore e përbëjnë edhe kreditë e lëshuara për shërbime tjera me 13.6% dhe kreditë e lëshuara për prodhimtari me 12.6%.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktiviteti ekonomik

Nëse krahasojmë pjesëmarrjen e kredive sipas aktivitetit ekonomik në dy periudha të ndryshme, siç janë të paraqitura në figurën 3, mund të shohim se përbërja e strukturës së kredive është afërsisht e ngjashme ndërmjet dy periudhave, me disa ndryshime të vogla të pjesëmarrjes së kredive për sektorin e tregtisë dhe të ndërtimtarisë.

Figura 4 tregon për trendin e vazhdueshëm rritës të kredive të lëshuara për sektorë të ndryshëm ekonomik gjatë gjithë periudhës krahasuese.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktiviteti ekonomik

Vetëm gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, pra deri në fund të muajit qershor 2015, kreditë e lëshuara për sektorët ekonomik janë rritur për 7.8% në raport me fundin e vitit 2014, përderisa rritja e kredive për sektorët ekonomik në fund të vitit 2014, në raport me vitin 2013 ishte për 2.1%. Kjo tregon se viti 2015 do të jetë edhe më i suksesshëm në volumnin e kreditimit, duke mundësuar kreditim më të madh për ekonominë e Kosovës, e cila ndikon drejtpërdrejt edhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

KREDITË E REJA TË INDUSTRIËS BANKARE

Vlerat e paraqitura në vijim tregojnë vetëm për kreditë e reja të lëshuara gjatë periudhës së caktuar dhe nuk përfshijnë gjithsej vlerën e kredive që industria bankare e ka aktive ndaj klientëve të saj. Këto të dhëna janë indikatorë të rëndësishëm, meqenëse tregojnë edhe për trendin e kredive aktuale.



KREDITË E REJA NË INDUSTRIJË BANKARE (2010 - 2014)			Milion Euro
Përshkrimi	Korporatat jo financiare	Ekonomitë familjare	Gjithsej
2010	491.3	240.5	731.8
2011	508.4	293.7	802.1
2012	468.4	275.9	744.3
2013	467.9	294.1	761.9
2014	615.4	378.5	993.9

Tab. 4 | Burimi: BQK – Kreditë e reja të korporatave tjera depozituese




Fig. 5 | Burimi: BQK – Kreditë e reja të korporatave tjera depozituese

Tabela 4 tregon gjithashtu për trendin rritës të kredive të reja në të gjitha periudhat krahasuese, me ç'rast në fund të vitit 2014 janë rritur për 30.4%, që paraqet një rritje të ndjeshme për industrinë bankare dhe vet ekonominë e Kosovës, për dallim prej vitit 2013, kur kjo rritje ishte vetëm 2.3%. Në kuadër të gjithsej kredive të reja, pjesën më të madhe të kredive e përbëjnë kreditë e lëshuara për sektorët ekonomik me 61.9% në fund të 2014 dhe me 38.1% për ekonomitë familjare.

Edhe gjysma e parë e vitit 2015 ka pasur rritje të kredive të reja, duke vazhduar kështu trendin rritës në periudhat krahasuese.

KREDITË E REJA NË INDUSTRIJË BANKARE (2010 - 2014)			Milion Euro
Përshkrimi	Korporatat jo financiare	Ekonomitë familjare	Gjithsej
Qer - 14	332.9	179.3	512.2
Qer - 15	348.6	207.4	555.9

Tab. 5 | Burimi: BQK – Kreditë e reja të korporatave tjera depozituese




Fig. 6 | Burimi: BQK – Kreditë e reja të korporatave tjera depozituese

Në qershor 2015 kreditë e reja në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2014, e cila mund të shihet në tabelën 5 dhe figurën 6, janë rritur për 43.7 milionë euro apo për 8.5%. Në këtë krahasim përbërja e kredive të reja ka mbetur afërsisht e njëjtë, pra e dominuar nga kreditë e lëshuara për korporatat jo financiare me 62.7%, përderisa për ekonomitë familjare ishin 37.3%.

KREDITË SIPAS MATURITETIT

Industria bankare ka bërë kreditimin e sektorëve ekonomik, por edhe të ekonomisë familjare në maturitete të ndryshme, duke filluar prej atyre me afat të shkurtër dhe deri tek kreditë me maturitet mbi 10 vjet. Në këtë mënyrë industria bankare i është përshtatur kërkesave dhe nevojave të klientëve të saj, varësisht nga kriteret e përcaktuara paraprakisht.

KREDITË SIPAS MATURITETIT (QERSHOR 2015)								
Nr.	Sektori	Kredi në jo-euro	Kreditë sipas maturitetit					Total
			Deri 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	Mbi 10 vite	
1	Ndërmjetësit tjerë financiar	-	4.1	0.1	3.2	0.1	-	7.4
2	Kompanitë e sigurimit	-	0.9	0.3	0.3	-	-	1.5
3	Korporatat publike jo-financiare	-	0.0	-	0.5	0.1	-	0.6
4	Korporatat familjare	-	366.5	130.5	513.3	292.0	25.7	1,328.1
5	Ekonomitë familjare	-	56.2	41.2	246.3	274.2	42.9	660.9
6	OJSHEF	-	-	-	-	0.1	-	0.1
7	Korporatat tjera jo-depozitare	-	-	-	0.1	0.2	0.1	0.3
8	Korporatat tjera jofinanciare	6.3	-	-	-	-	-	6.3
	Gjithsej	6.3	427.8	172.1	763.7	566.7	68.6	2,005.2

Tab. 6 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit

Siç shihet në tabelën 6, pjesa më e madhe e kredive me 38.0% përbëhet nga kreditë me maturitet prej 2-5 vite dhe 28.2% me maturitet prej 5 – 10 vite. Një pjesë e konsiderueshme e kredive prej 21.3% kanë maturitet deri në një vit, përderisa 8.5% e kredive kanë maturitet 1-2 vite. Kreditë që kanë maturitet mbi 10 vite përfshijnë 3.4% të gjithsej kredive të lëshuara nga industria bankare.

REFERENCAT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, gusht 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Kreditë e reja të korporatave tjera depozituese, gusht 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese, gusht 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktiviteti ekonomik, gusht 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

PERIODIKU BANKAR - GUSHT 2015

DEPOZITAT NË KUADËR TË DETYRIMEVE TË INDUSTRIË BANKARE NË KOSOVË

DEPOZITAT E INDUSTRIËSË BANKARE



Depozitat e industrisë bankare në Kosovë kanë vazhduar të shënojnë rritje të vazhdueshme, gjë që ka bërë që ky sektor të jetë më i besueshëm dhe më i sigurtë në performancën e saj. Në këtë kontekst edhe gjithsej vlera e depozitave e industrisë bankare ka vazhduar të shënoj rritje, në raport afërsisht të njëjtë me gjithsej detyrimet e kësaj industrie. Kjo nënkupton se industria bankare në baza të vazhdueshme ka zhvilluar afarizëm të qëndrueshëm dhe profitabil, gjë kjo shumë e nevojshme për të performuar në baza stabile për çdo biznes, duke bërë kështu që edhe depozitat e qytetarëve të Kosovës të jenë të sigurta.

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIËSË BANKARE (2010-2015)

Million Euro

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Gu - 2015
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.8	42.5
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,656.9
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	13.1
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	4.3
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.9	220.3
Borxhi i ndërvarur	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3	47.4
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.1	364.5
Gjithsej Detyrime	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,186.6	3,349.2

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese

Detyrimet e industrisë bankare kanë shënuar rritje, me ç'rast deri në muajin gusht të vitit 2015 kanë shënuar rritje për 5.1%, përderisa rritja e detyrimeve për komplet vitin 2014 ishte 4.1%. Siç shihet në tabelën 1, në kuadër të gjithsej detyrimeve pjesën kryesore të saj e përbëjnë depozitat, mjetet vetanake, detyrimet e tjera dhe kështu me radhë. Është e rëndësishme të theksohet se detyrimet dhe huat tjera kanë shënuar ulje, përderisa kategoritë tjera kanë shënuar rritje të ndjeshme gjatë vitit 2015.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese

Figura 1 paraqet trendin rritës paralel të depozitave në raport me gjithsej detyrimet. Kjo tregon se depozitat e industrisë bankare përbëjnë edhe burimin kryesor të të hyrave të kësaj industrie. Depozitat në vitin 2015 përbëjnë 79.3% të gjithsej detyrimeve të industrisë bankare, përderisa përbërje afërsisht e njëjtë ka qenë edhe gjatë viteve të kaluara.




Fig. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese

Figura 2 e tregon strukturën aktuale të detyrimeve të industrisë, me ç’rast shihet dominimi i depozitave në kuadër të gjithsej detyrimeve, mjetet apo kapitali vetanak e përbën 10.9% të gjithsej detyrimeve, përderisa kategoritë e tjera përbëjnë nën dhjetë përqind të gjithsej detyrimeve.

STRUKTURA E DEPOZITAVE TË INDUSTRIËS BANKARE

Përveç përbërjes së ndryshme të strukturës së detyrimeve të industrisë bankare edhe depozitat e kësaj industrie kanë strukturë të ndryshme, varësisht nga statuti juridik që kanë klientët e bankave. Në këtë kuptim edhe përbërja e depozitave është e ndryshme, e cila në të njëjtën kohë paraqet një rëndësi të veçantë, meqenëse këto paraqesin edhe burimin kryesor të të hyrave të industrisë.



STRUKTURA E DEPOZITAVE TË INDUSTRIJË BANKARE (2010-2015)						Milion Euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Gu - 2015
Qeveria	11.7	2.7	0.7	1.8	8.8	10.9
Korporatat tjera depozituese	7.3	9.9	3.8	2.5	2.8	5.6
Ndërmjetës tjerë financiarë	7.9	6.8	6.2	7.4	5.1	3.6
Kompanitë e sigurimit	47.6	57.2	64.3	72.3	79.3	62.1
Fondet pensionale	41.6	43.1	45.3	5.7	17.1	12.3
Ndihmësit financiar	0.6	0.5	0.4	0.3	0.3	2.1
Korporata publike jofinanciare	122.3	128.5	75.6	72.1	61.8	43.4
Korporatat tjera jofinanciare	292.5	278.1	326.1	383.5	387.9	443.1
Ekonomitë familjare	1,206.1	1,373.4	1,535.4	1,658.7	1,750.6	1,830.1
Organizatat joprofitabile	14.0	22.2	23.2	26.4	30.6	32.2
Jorezidentët	79.1	60.0	81.7	83.4	82.1	95.7
Depozitat në jo-euro	106.0	121.6	116.3	134.9	111.2	116.0
Gjithsej Detyrime	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,656.9

Tab. 2 | Burimi: BQK – Depozitat e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit origjinal dhe Depozitat në jo-euro

Tabela 2 e tregon strukturën e depozitave, me ç'rast mund të shihet se përveç se depozitat kanë shënuar rritje në kuadër të totalit të tyre, shumica e nën-kategorive të tyre kanë shënuar rritje në vitin 2015. Përjashtim në këtë rritje të depozitave bëjnë depozitat e korporatave publike jofinanciare, fondeve pensionale, kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësve tjerë financiar.

Depozitat e industrisë bankare në gusht të vitit 2015 janë rritur për 4.7% në raport me fundin e vitit 2014, që paraqet rritje më të madhe se sa rritja prej 3.6% që ishte për komplet vitin 2014, krahasuar me vitin 2013. Në kuadër të gjithsej depozitave, depozitat e ekonomive familjare vazhdojnë të dominojnë, duke përbërë 68.9% të gjithsej depozitave në gusht të vitit 2015.

Edhe depozitat e ekonomive familjare, ashtu sikurse gjithsej depozitat, kanë shënuar rritje të vazhdueshme nëpër vite, me ç'rast në muajin gusht 2015 këto depozita janë rritur për 4.5% në raport me fundin e vitit 2014.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Depozitat e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit origjinal

Rritja e depozitave për ekonomitë familjare në raport afërsisht të njëjtë me gjithsej depozitat, mund të shihet edhe në figurën 3, me ç'rast janë paraqitur trendet rritëse për të dy kategoritë.

Një pjesë të rëndësishme në gjithsej strukturën e depozitave e përbëjnë edhe depozitat e korporatave tjera jo-financiare të cilat përfshijnë 16.7% të gjithsej depozitave, duke vazhduar me depozitat që janë të denominuara në valuta të tjera, depozitat e jo-rezidentëve dhe kështu me radhë.

STRUKTURA E DEPOZITAVE SIPAS MATURITETIT TË INDUSTRIË BANKARE



Struktura e depozitave sipas maturitetit për industrinë bankare ka rëndësi të madhe, meqenëse përmes depozitave të cilat e përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave të bankave në Kosovë, mundësohet edhe kreditimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës. Sa më afatgjate janë këto depozita të deponuara në industrinë bankare, aq më afatgjate është e mundshme të jetë edhe kreditimi për klientët.

STRUKTURA E DEPOZITAVE SIPAS MATURIMIT TË INDUSTRIË BANKARE (2010-2015)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Gu - 2015
Depozitat e transferueshme	625.9	643.5	696.4	825.0	1,123.0	1,330.2
Depozitat e kursimit	315.0	315.1	326.6	373.8	513.0	529.5
Depozitat e afatizimit	889.9	1,023.8	1,139.8	1,115.3	790.5	681.2
Gjithsej Detyrime	1,830.8	1,982.4	2,162.8	2,314.1	2,426.6	2,540.9

Tab. 3 | Burimi: BQK – Depozitat e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit origjinal

Tabela 3 tregon gjendjen e depozitave në industrinë bankare nëpër vite, me çka mund të shihet se në muajin gusht të vitit 2015 pjesa kryesore e depozitave është depozitë e transferueshme që në fakt përbëjnë 52.4%. Këto lloj depozitash janë të gatshme për përdorim nga klientët e bankave dhe të cilat mund të përdoren për qarkullim të vazhdueshëm. Grupin e dytë të depozitave e përbëjnë depozitat e afatizuara me 26.8% të pjesëmarrjes, përderisa të tretin e përbëjnë depozitat e kursimit me 20.8% të pjesëmarrjes.

Përbërja e strukturës së depozitave sipas maturitetit nuk ka qenë e njëjtë nëpër vite sikurse mund të vërehet në tabelën 3. Për më hollësisht ndryshimin e kësaj strukture mund ta shohim edhe në bazë të lëvizjes së trendeve të paraqitura në figurën 4.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Depozitat e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit origjinal

Në vitin 2010 depozitat e afatizuara përbënin grupin kryesor të depozitave sipas maturitetit me 48.6% pjesëmarrje, e cila përqindje në muajin gusht të vitit 2015 ka rënë në 26.8%. Ky ndryshim në depozitat e afatizuara është reflektuar kryesisht tek depozitat e transferueshme duke lëvizur nga 34.2% në vitin 2010, në 52.4% në muajin gusht të vitit 2015. Kjo lëvizje mund të reflektohet edhe si rezultat i rënies së normave të interesit në depozitat e afatizuara, meqenëse industria bankare në Kosovë ka përcjellur lëvizjet ndërkombëtare, me ç'rast normat e interesit në depozita në shumë vende të Evropës perëndimore kanë shënuar ulje.

RAPORTI NDËRMJET KREDIVE DHE DEPOZITAVE TË INDUSTRIISË BANKARE

Me qëllim të ruajtjes së likuiditetit të industrisë bankare, bankat duhet të jenë të gatshme të mbulojnë të gjitha obligimet që mund t'i dalin në çdo kohë. Me këtë rast është e rëndësishme që industria bankare të menaxhojë me kujdes raportin ndërmjet depozitave të cilat i posedon në kuadër të portfolios së saj dhe kredive që i lëshon për klientët në anën tjetër.

RAPORTI NDËRMJET KREDIVE DHE DEPOZITAVE (2010-2015)						Milion Euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Gu - 2015
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,656.9
Kreditë	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	1,985.1
Përqindja	75.3%	80.7%	77.4%	73.7%	74.2%	74.7%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Depozitat e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit origjinal

Këtë raport ndërmjet kredive dhe depozitave e tregon tabela 4, me ç'rast mund të shihet se industria bankare nëpër vite nuk e ka tejkaluar përqindjen mbi tetëdhjetë, duke ofruar kështu siguri dhe stabilitet financiar. Në muajin gusht të vitit 2015, ky raport është në nivelin prej 74.7%.

REFERENCAT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, tetor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Depozitat e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit origjinal, tetor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Depozitat në jo-euro e korporatave tjera depozituese sipas maturitetit origjinal, tetor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

PERIODIKU BANKAR - SHTATOR 2015

PANAIRI FINANCIAR I KOSOVËS 2015

HISTORIKU I PANAIRIT FINANCIAR

Shoqata e Bankave të Kosovës për herë të parë ka organizuar Panairin Financiar në vitin 2005 në bashkëpunim me anëtarët dhe partnerët e ndryshëm të saj. Fillimisht është organizuar çdo dy vite, përderisa që nga viti 2011, Panairi Financiar organizohet çdo vit nga Shoqata e Bankave të Kosovës. Panairi Financiar këtë vit është organizuar për herë të tetë me radhë.

Përmes Panairit Financiar synohet që të krijohen dhe zgjerohen kontaktet ndërmjet institucioneve financiare, bizneseve, agjencive kontribuese në këtë fushë dhe investitorëve potencial përmes identifikimit të praktikave më të mira të bashkëpunimit që mund të shtyjë përpara zhvillimin e sektorit financiar si dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Çdo organizim i Panairit Financiar, ka për qëllim që të trajtoj çështje specifike të sektorit, duke sjellë në një vend të gjitha institucionet relevante përmes secilës synohet të adresohen sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet sektori.

Panairi Financiar ka për qëllim gjithashtu që të lehtësoj në promovimin e shërbimeve të ndryshme financiare, kryesisht shërbimeve që janë të reja dhe jo shumë të njohura për vizitorët dhe të cilat mund të jenë shumë të mirëseardhura për bizneset në veçanti.



Panairi Financiar përmban disa aktivitete paralele njëkohësisht:

Ekspozimi – paraqet vetëm një prej pjesëve kryesore të Panairit Financiar gjatë dy ditëve të plota të punës, me ç'rast industria financiare ka mundësi të paraqet shërbimet dhe produktet e saj, por në të njëjtën kohë të komunikoj me akterët e ndryshëm, duke përfshirë: klientët individual dhe bizneset, rregullatorin dhe ligjvënësit, mediat dhe organizatat ndërkombëtare si dhe punëtorë potencial për të ardhmën.

Konferenca/Forume – organizohen gjatë Panairit Financiar paralel me pjesën e ekspozimit gjatë dy ditëve të panairit. Çdo vit trajtohen dhe diskutohen tema të caktuara të cilat janë pjesë e agjendës së sektorit financiar. Përmes këtyre organizimeve synohet që të vijnë sëbashku në një vend të gjithë akterët relevant të industrisë financiare për të diskutuar sfidat e këtij sektori, me ç'rast panelistët ndajnë me njëri tjetrin përvojën, kontributin dhe zotimet e tyre për temat të cilat përzgjedhen varësisht sipas interesit të industrisë.





Ngjarje – punëtori apo takime të ndryshme organizohen gjatë panairit financiar të cilat gjithashtu kanë për qëllim kryesisht edukimin financiar të segmenteve të ndryshme të shoqërisë. Deri tash janë organizuar punëtori nga më të ndryshme, ndër të cilat: punëtori me studentë, me sektor të caktuar të industrisë (psh. kontabilistë, biznese që merren me shitje të derivateve të naftës etj), punëtori me gazetarë etj.



PANAIRI FINANCIAR 2015

Hapja solemne e panairit financiar 2015 është bërë me datën 29 Shtator, 2015 në Pallatin e Rinisë, dhe ka vazhduar edhe me 30 Shtator. Në hapje të panairit fjalën hyrëse e morën z. Bedri Hamza, Guvernator në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, z. Ilir Aliu, Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës, njëkohësisht Drejtor Ekzekutiv në ProCredit Bank dhe z. Petrit Balija, Drejtor Ekzekutiv në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

Në fjalitë hyrëse të tyre u vlerësua si shumë e suksesshme organizimi për vite me radhë i Panairit Financiar nga Shoqata e Bankave të Kosovës. Roli i sistemit financiar në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit ka shënuar përmirësim të mëtejshëm në periudhën e fundit dhe atë kryesisht në saje të zhvillimeve në kuadër të aktivitetit të sektorit bankar. Kreditimi i sektorit bankar ka vijuar të ndjekë një trend dukshëm më të shpejtë të rritjes. Gjithashtu në fjalimin hyrës nga Banka Qendrore e Kosovës u theksua se ky institucion vazhdon të përkrahë zhvillimin e mëtejshëm dhe rritjen e efikasitetit të sistemit financiar të vendit, duke punuar në zhvillimin dhe avancimin e infrastrukturës dhe rregullativës financiare që lejon zhvillimin e shëndoshë të sistemit financiar, si dhe duke nxitur rritjen e konkurrencës në sistemin financiar përmes licencimit të akterëve të rinjë.



Në kuadër të Panairit Financiar të këtij viti kanë ekspozuar kompani të ndryshme gjatë dy ditëve në Pallatin e Rinisë, duke përfshirë institucione bankare, institucione mikrofinanciare, kompani të fushës së sigurimeve, agjenci vendore publike, institucione edukativo-arsimore, organizata ndërkombëtare dhe kompani konsulente.



Gjatë Panairit Financiar 2015 është organizuar edhe një lojë shpërblyese e cila ka pas për qëllim që të nxisë dhe rrisë numrin e vizitorëve në panair dhe ti shpërblejë ata në shenjë falenderimi si klient të institucioneve financiare. Loja shpërblyese është vendosur në hollin e Pallatit të Rinisë gjatë dy ditëve të Panairit Financiar 2015. Në lojën shpërblyese janë kualifikuar të gjithë vizitorët e panairit dhe të cilët kanë arritur të mbledhin të paktën 15 broshura të kompanive ekspozuese në panair. Tërheqja e fituesve të tri shpërblimeve të ndara nga SHBK do të bëhet përmes emisionit “Koha për Financa” në kuadër të televizionit “Kohavision”.



Shoqata e Bankave të Kosovës është mbështetur në këtë organizim nga Sponsorët Gjeneral: Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, İş Bank, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank dhe Türk Economic Bankası - TEB. Panairi Financiar 2015 është përkrahur edhe nga sponsori medial Telegrafi.

PANELI DISKUTUES GJATË PANAIRIT FINANCIAR 2015

Në kuadër të Panairit Financiar 2015 është organizuar konferenca gjatë ditës së dytë, me ç'rast në panel është përfaqësuar sektori financiar në Kosovë, institucione ndërkombëtare si dhe institucione të rëndësishme publike të Kosovës. Tema dhe nën-temat e panelit diskutues ishin:

Financimi i Progresit në Kosovë

- **Financimi i Agrobiznesit në Kosovë**
- **Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive**
- **Barrierat e përgjithshme në qasje në financa për bizneset e vogla dhe të mesme**

Konferenca është kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija i cili ka udhëhequr seancën e diskutimit të panelit gjithpërfshirës.



Paneli i konferencës së Panairit Financiar 2015 ishte gjithpërfshirës dhe përbëhej nga tetë të përzgjedhur përfshirë: Fehmi Mehmeti – Zëvendës Guvernator në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Jan Peter Olters – përfaqësues i Bankës Botërore për Kosovë, Ilir Aliu – Kryetar i Bordit të SHBK-së dhe Drejtor Ekzekutiv në ProCredit Bank, Memli Krasniqi – Ministër në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Robert Wright – Nënkyetar i Bordit të SHBK-së dhe Drejtor Ekzekutiv në Raiffeisen Bank, Michael Gold – Drejtor Ekzekutiv në Crimson Finance Fund dhe përfaqësues i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Safet Gërzhaliu – Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës dhe Adem Selmani – Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve.



Hapja e konferencës u bë nga zv. Guvernatori Mehmeti si dhe Kryetari i Bordit të SHBK z. Ilir Aliu.

Në diskutimin e dhënë nga përfaqësuesi i Bankës Qendrore të Kosovës u vlerësua kontributi i sektorit financiar e posaçërisht bankar në financimin e progresit në Kosovë që nga viti 2000 e deri më tani. Përveç rritjes së vazhdueshme të nivelit të kreditimit madje edhe gjatë kohës së krizës së fundit financiare, një tregues me peshë në këtë drejtim është edhe ai i ndërmjetësimit financiar në raport me produktin e brendshëm bruto. Si përfundim, nga pikëpamja e rregullatorit dhe mbikëqyrësit u vlerësua që:

(i) ekziston kapacitet dhe hapësirë e konsiderueshme lidhur me përshpejtimin e përkrahjes përmes financimit të tregut hipotekar, sidomos për banim por edhe atë komercial;

(ii) ka një sërë parakushtesh që tregojnë se financimi i tregut hipotekar ka një zvogëlim të kostos së financimit, me sa vijon:

- ulja e kostos së burimeve të mjeteve për banka;
- zvogëlimi i rrezikut kreditor përmes funksionalizimit të përmbaruesve privat;
- zvogëlimi i vazhdueshëm i kredive joperformuese;
- cilësia më e mirë e kredive të reja;
- gjendja stabile e sektorit bankar;
- pozita e qëndrueshme me likuiditet;

(iii) bankat, duhet të trajtojnë më shumë financimin e balancuar sektorial, përmes financimit afatgjatë respektivisht përshpejtimin të rritjes së financimit të bujqësisë si një sektor i rëndësishëm – duke përfshirë edhe grejs periudha më të gjata;

(iv) sektori i bujqësisë duhet të promovohet më shumë nga institucionet relevante, në këtë rast odat e ndryshme ekonomike përmes advokimit në funksion të institucionalizimit të tyre, përkrahjen në zhvillimin e planeve të arsyeshme të biznesit, si dhe në hartimin e pasqyrave adekuate financiare;



(v) përderisa si rregullator dhe mbikëqyrës duhet të krijohet infrastruktura legislative në funksion të përshpejtimin të përkrahjes së financimit të këtyre dy sektorëve.

Në hapje të konferencës e mori fjalën edhe Kryetari i Bordit të SHBK-së i cili bëri një prezantim të përgjithshëm mbi indikatorët kryesor të sektorit financiar dhe industrisë bankare në veçanti. Në prezantimin e z. Aliu u pasqyrua se industria bankare ka shënuar vlera pozitive në të gjithë treguesit e saj kryesor, duke u bërë kështu bartës i shumë zhvillimeve dhe me këtë edhe i zhvillimit ekonomik në Kosovë. Industria bankare në fund të qershorit 2015 përbënte 69.1% të gjithëj sistemit financiar, përderisa gjithëj vlera e kredive të lëshuara nga industria bankare përbënte mbi 2 miliardë euro. Depozitat kanë arritur në 2.5 miliardë euro, çka nënkupton se edhe raporti ndërmjet kredive dhe depozitave ka mbetur stabil në përqindjen prej 77.9%.

Në prezantim u vlerësua shumë se industria bankare ka arritur të menaxhoj shumë mirë kreditë jo-performuese, meqenëse në qershor 2015 kjo përqindje ishte 7.2%, përqindje kjo e cila është më e vogël në krahasim me dy vitet e kaluara kur kjo përqindje ishte 8.7% (2013) dhe 8.2% (2014). Përqindja e kredive jo-performuese është më e ulëta në krahasim me të gjitha vendet e tjera të rajonit.

Ndër arritjet më të mëdha të industrisë bankare gjatë vitit 2015 u vlerësua zvogëlimi i normës efektive të interesit e cila në qershor të 2015 u raportua se ka arritur në 7.6%, përqindje kjo e cila është shumë më e vogël se sa periudhat paraprake. Hendeku apo raporti ndërmjet normës së interesit për kredi dhe asaj për depozita vazhdimisht ka shënuar rënie në çdo vit.

Në hapjet të konferencës gjithashtu u theksua fitimi i realizuar nëpër vite i industrisë bankare, që është kusht kryesor për një sektor stabil dhe u vlerësua se rritja e fitimit në vitet e fundit ka ardhur si rezultat i drejtpërdrejt nga zvogëlimi i shpenzimeve, posaçërisht të shpenzimeve të jo-interesit. Në prezantim u paraqitën edhe të dhëna mbi shërbimet elektronike dhe krahasimi i tyre me vendet e rajonit, siç janë përdorimi i debit dhe kredit kartelave, qasja në bankomate dhe pika shitëse dhe në përdorimin e e-bankingut, me ç'rast u vlerësua se Kosova nuk është inferiore në raport me vendet e rajonit, përderisa në disa raste edhe e tejkalon disa vende sa i përket shfrytëzueshmërisë dhe qasjes së tyre.





Përfaqësuesi nga Minsitria e Bujqësisë e vlerësoj sektorin e bujqësisë si një sektor të një rëndësie të veçantë dhe si e tillë duhet të trajtohet edhe nga të gjithë akterët e tjerë, meqenëse ky sektor paraqet një nga mundësitë e pakta që të rritë prodhimin dhe mirëqenien e qytetarëve duke zvogëluar edhe hendekun e madh të krijuar ndërmjet importit dhe eksportit. Ky sektor ka kontribuar me rreth 1% të rritjes së përgjithshme ekonomike si dhe bën pjesë në rreth 12-13% në bruto prodhimin vendor në bazë të të dhënave zyrtare dhe projeksioneve të



Përfaqësuesi i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) e vlerësoj si shumë pozitive zhvillimet në kuadër të industrisë bankare, meqenëse ka bërë hapa konkret

nxjerra. Gjithashtu u theksua se bujqësia përfaqëson afërsisht 12% të eksporteve të përgjithshme që Kosova arrinë t'i eksportoje. Në këtë kuptim edhe Ministria e Bujqësisë ka kontribuar në këtë zhvillim përmes dhënies së granteve dhe subvencioneve në vlerën prej 43 milionë euro (23 milion në formë të subvencioneve dhe 20 milion në formë të granteve) të cilat pritet të gjenerojnë fitim deri në 35 milion euro. Ministri e vlerësoj rënien e normave të interesit në kredi, mirëpo theksoj se normat e interesit ende mbesin në nivelin dyshifror, madje edhe ne rastet kur agronomi është përfitues i granteve nga qeveria. Ministria e Bujqësisë vlerësoj se vetëm 4% të gjithsej kredive të industrisë bankare e përbëjnë kreditë e lëshuara për bujqësi, përderisa nga këto kredi, sektori i bujqësisë përfaqëson normën më të ulët të kredive të këqija në raport me mesataren e përgjithshme. Gjithashtu u vlerësua iniciativa e procesimit në Kuvend për aprovim të projektligjit për Fondin e Garantimit të Kredive i cili fond pritet të mbuloj rrezikun deri në 50% të kolateralit, çka nënkupton se industria bankare përmes këtij fondi do të mund ta rrisë kreditimit për sektorin e bujqësisë si dhe në të njëjtën kohë do të ulë rrezikun që vlerësohet nga mbështetja e këtij fondi.

drejt zbritjes së normave të interesit për kredi. Sipas tyre sfida kryesore mbetën disa barrierat të cilat po ju shkaktohen bizneseve në Kosovë dhe të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillim edhe të mëtutjeshëm. Ndër barrierat kryesore që ndërlihen me sundimin e ligjit, pra vështirësitë që ka sistemi i drejtësisë në zbatimin e kontratave. Më konkretisht në industrinë bankare vështirësi paraqitet edhe çështja e qartësimeve të pronësisë, ku qeveria duhet të punoj më shumë në këtë drejtim.

Sa i përket industrisë bankare përfaqësuesi nga OEK kërkoj që të ketë më shumë fushata vetëdijësuese me karakter edukativ për përmirësimet që janë bërë, në mënyrë që të ndryshohet qasja e bizneseve dhe që këto biznese të merrin më shumë me performancën e tyre se sa me atë se sa fiton banka.



Përfaqësuesit e bankave në këtë panel vlerësuan se gjithsej kreditë e lëshuara për sektorin e bujqësisë lëvizin nga 85-100 milion euro, përderisa përqindja e kredive jo-performuese për këto kredi është afërsisht 4%. Kjo përqindje e ulët e kredive jo-performuese tregon edhe për suksesin e industrisë bankare për shkak të kujdesit të shtuar që kanë treguar për këtë sektor, duke mos lejuar që përqindja e këtyre kredive të jetë e lartë. Gjithashtu edhe normat efektive e

interesit për kredi bujqësore nuk janë të larta, 10.5%, çka nënkupton se ka kredi për sektorin e bujqësisë që jepet me normë më të ulët, pra nën nivelin dyshifror. Lëshimi i kredive për sektorin e bujqësisë nuk varet shumë nga industria bankare, se sa që varet nga kërkesa, andaj sa më shumë kërkesa të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga industria bankare edhe portofolio kreditore për atë sektor është më i madh. Industria bankare është fleksibile sa i përket përcaktimit të kushteve të kolateralit, grejs periudhës apo edhe kritereve të tjera. Sot në Kosovë të gjitha bankat komerciale të cilat operojnë e kanë si shërbim apo produkt financimin e agrikulturës. Disa nga barrierat që industria bankare i has me bizneset e sektorit bujqësor kanë të bëjnë me mbajtjen e librave (nuk kanë pasqyra/të dhëna financiare) përmes secilës do të vlerësohej kompania apo qarkullimi dhe fitimi i saj, pronarët e tokave nuk janë të identifikuar saktësisht dhe nuk kanë certifikatë të pronësisë, parcela të vogla të tokave dhe kryesisht e kanë aktivitetin e tyre të zhvilluar përmes rrugëve jo-formale, mungesa e regjistrimit të saktë të popullsisë, mungesa e adresave dhe shumë barrierat të tjera.



Përfaqësuesi i Bankës Botërore për Kosovë theksoj se krahas industrisë bankare edhe sektori i sigurimeve është një aspekt i cili mund të kontribuoj shumë në financimin e agrobizneseve. Përmes sigurimit të kulturave bujqësore nga fakteqësitë natyrore, do të mundësohej që edhe premiumi i rrezikut të zvogëlohet dhe në këtë mënyrë edhe normat e interesit do të ishin edhe më të vogla. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është se bizneset dhe sidomos ato në bujqësi duhet të jenë më inovative dhe afirmative, në mënyrë që të bëhen atraktive për t'u financuar, çka indirekt do të rriste edhe kërkesat për financim të sektorit të bujqësisë.

Përfaqësuesi nga sektori i sigurimeve njoftoj të pranishmit se për momentin janë vetëm dy kompani të sektorit të sigurimeve të cilat kanë licencë nga Banka Qendrore e Kosovës për të siguruar kulturat bujqësore. Pra në këtë kontekst edhe nga partnerët e tjerë, kompanitë e sigurimeve nuk kanë qenë shumë të mbështetura. Si sektor, bujqësia ka potencial dhe mund të zhvillohet edhe më shumë, gjithnjë në bashkëpunim dhe pjesëmarrje të të gjithëve sikurse që janë bankat, kompanitë e sigurimeve, ministria e bujqësisë dhe akterë të tjerë. Pra kryesore në këtë mes është rritja e bashkëpunimit. Një nga problemet që është identifikuar nga kompanitë e sigurimeve është se bujqësia është më shumë e zhvilluar në nivel tradicional dhe nuk zgjon interes të madh, madje edhe kërkesat për sigurim janë të pakta, për të mos thënë fare.





Përfaqësuesi nga mikrofinancat dhe fondit të garantimit të kredive vlerësoj se për të përmirësuar portfolion kreditorë për sektorin e bujqësisë duhet të bëhen përmirësime në vlerësimin e pronave të patundshme, në mënyrë që të identifikohet edhe çmimi i tregut për atë patundshmëri. Kjo do të mundësonte që industria bankare apo edhe ato mikrofinanciare të kenë një ide më të qartë mbi vlerën e asetit që e financojnë. Çështje e dytë e rëndësishme që do të mund të ndikonte në rritjen e kredive bujqësore, do të ishte edhe përmirësimi në zbatimin e kontrave në fushën e drejtësisë, meqenëse siç të gjithë e dijmë gjykatat nuk kanë ndonjë afat kohor deri në zgjidhjen e kontestit gjyqësor, duke shkaktuar vonesa dhe mos zbatime të kontratave si pasojë e mos zbatimit të ligjit.

Në fund të këtij paneli u vlerësua se Banka Qendrore e Kosovës pas aprovimit të projektligjit për sigurimet, përmes legjislacionit sekondar që parashihen të aprovohen do të kërkoj që ta bëj obligative edhe çështjen e sigurimit të pronës. Ministria e Bujqësisë premtoj se me rastin që dy prej kompanive të sigurimeve janë licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës për të siguruar kulturat bujqësore, do të filloj që të bëj subvencionimin deri në 50% të sigurimeve, në vend se këtë subvencionim ta bëj direkt për kulturat bujqësore. Për më shumë, Ministri Krasniqi u zotua se Ministria e Bujqësisë është e gatshme që të subvencionoi premiumet për fermerë për sigurimin e pronave dhe produkteve të tyre agrare. Ajo çka nevojitet është që shërbimet adekuate të ofrohen nga institucionet e sigurimeve dhe që bujqit të jenë të gatshëm për nënshkrimin e kontratave të tilla për sigurime. Kjo ofertë e Ministrit Krasniqi u vlerësua si shumë pozitive dhe diçka konkrete që mund të realizohet në të ardhmen e afërt.

Si përfundim u vlerësua se Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive do të luaj një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të financimit për sektorin e bujqësisë dhe jo vetëm, duke përfshirë këtu edhe biznese “start up” (fillestare) dhe biznese të vogla. Në fillim ky fond pritet të siguroj deri në 20 milion euro, përderisa në plan afatgjatë planifikohet që të siguroj kredi deri në vlerën prej 300 milion euro, çka nënkupton sa komplet portfolio e një banke të madhe në Kosovë.



DHJETËVJETORI I QENDRËS PËR TRAJNIME NË SHBK



Festojme 10 vjet sukses
Celebrating 10 years of success

Me 30 Shtator 2015, Shoqata e Bankave të Kosovës organizoj ceremoninë festive për nder të 10 viteve pune të suksesshme të Qendrës për Trajnime. Ceremonia gjithashtu shënoi 10 vite bashkëpunim me partnerin e SHBK-së në Luksemburg, Agjencioni për Transfer të Teknologjisë Financiare (ATTF).

Pjesëmarrësit vinin nga bankat anëtare, Banka Botërore, IFC, Ambasada e Luksemburgut në Kosovë, ATTF nga Luksemburgu dhe mysafir të tjerë që kanë qenë qoftë kontribuues apo përfitues nga Qendra për Trajnime gjatë këtyre 10 viteve. Gjatë këtyre 10 viteve në SHBK janë mbajtur mbi 264 trajnime në të cilat mbi 3000 persona kanë ndjekur së paku nga një trajnim.

Gjatë ceremonisë Menaxheri për Trajnime dhe Zhvillim, Arben Salihu, falënderoi të gjithë të pranishmit si dhe ata që nuk kishin mundur të marrin pjesë dhe shtoi se ndihet krenar me punën që është bërë dhe "... se të mendosh se kemi ndikuar pozitivisht në jetët dhe punën e mbi 3 mijë personave është diçka për tu mburrur".

Drejtori Ekzekutiv në SHBK, z. Petrit Balija, foli mbi rëndësinë e trajnimeve dhe impaktin pozitiv duke falënderuar të gjithë bashkëpunëtorët dhe stafin për një punë të mrekullueshme.

Menaxheri i Biznesit në ATTF, z. Ben Lyon, falënderoi SHBK për bashkëpunimin shumë të mirë gjatë këtyre viteve dhe u zotua për bashkëpunim edhe më të madh gjatë viteve në vijim. Ndërsa, i Ngarkuari me Punë në Ambasadën e Luksemburgut tha disa fjalë për kontributin e Qeverisë së tij në Kosovë jo vetëm në fushën e financave por edhe në fusha tjera, duke shtuar se Luksemburgu është mjaft i interesuar për zhvillimet në Kosovë dhe për të parë sa më shumë progres.

Pas fjalimeve u shpërndan certifikata mirënjohjeje për të gjithë bashkëpunëtorët dhe kontribuuesit e Qendrës për Trajnime gjatë këtyre viteve; për të vazhduar pastaj me koktejin.



REFERENCAT

Shoqata e Bankave të Kosovës, Procesverbal 29-30 Shtator 2015 nga Panairi Financiar 2015,

Shoqata e Bankave të Kosovës, 30 shtator 2015 - <http://bankassoc-kos.com/panairi-financiar>

Shoqata e Bankave të Kosovës - Raporti i Panairit Financiar 2007, 2009, 2011, 2012, 2013 dhe 2014

PERIODIKU BANKAR - TETOR 2015

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT NË INDUSTRIJË BANKARE

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT NË INDUSTRIJË BANKARE

Industria bankare në Kosovë ka arritë vlerën më të lartë të kredive të shënuar ndonjëherë deri në shtator 2015 prej 1,993 milionë euro të lëshuara për ekonominë e Kosovës, përderisa depozitat shënuan vlerën prej 2,656 milionë euro në fund të muajit shtator 2015. Sikurse çdo biznes tjetër që vepron në Kosovë edhe industria bankare është ballafaquar me vështirësi dhe sfida të ndryshme gjatë veprimtarisë së saj, gjë që ka bërë që niveli i rrezikshmërisë së tregut në të cilin operojnë të konsiderohet i lartë. Sidoqoftë viteve të fundit janë shënuar përmirësime të ndjeshme në këtë aspekt dhe trendet tregojnë që normat e interesit në kredi me një trend të shpejtë gjatë vitit të fundit janë duke shënuar ulje deri në atë nivel që janë shumë më të përshtatshme për bizneset dhe ekonomitë familjare në Kosovë. Kjo ka bërë që Kosova sa i përket këtij aspekti të jetë i krahasueshëm me vendet e rajonit dhe të jetë në harmoni me normat mesatare të këtyre vendeve. Nëse ky trend i uljes vazhdon, atëherë Kosova do të mund të ketë ndër normat më të ulëta në raport me këto vende.

Norma efektive e interesit paraqet normën e saktë të interesit të fituar në rastet e mjeteve të deponuara në formë të depozitave. Ajo mund të referohet edhe si norma e interesit të tregut apo si interesi i fituar në raport me kohën e afatizuar. Pra, ajo paraqet gjithsej të hyrat e fituara nga interesi për mjetet e deponuara. Përderisa në kuptim të kredive, norma efektive e interesit paraqet koston totale të shpenzimeve që klienti duhet të paguaj për një kredi të marrë nga institucionet financiare. Pra në të përfshihet norma nominale e interesit, shpenzimet administrative si dhe të gjitha kostot e tjera të ndërlidhura me atë kredi.



Burimi: images.google.com

Në industrinë bankare të Kosovës këto norma të interesit, si në kredi, ashtu edhe në depozita, kanë shënuar lëvizjes të vazhdueshme, sidomos në dy vitet e fundit. Trendet e këtyre lëvizjeve mund t'i shohim në nëntitujt në vijim.

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT NË KREDI

Norma efektive e interesit në kredi sidomos në dy vitet e fundit ka shënuar rënie të ndjeshme, duke arritur për herë të parë vlera njëshifrore në fund të vitit 2014. Trendi i njëjtë i uljes ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015, duke shënuar vlerën më të ultë të saj në qershor 2015 në vetëm 7.63%.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI (2010 - SHTATOR 2015)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Sht-2015
Mbitërheqjet	12.65%	11.84%	10.26%	9.36%	9.49%	7.54%
Linjat Kreditore	13.27%	12.12%	11.37%	11.03%	11.76%	9.46%
Kreditë Konsumuese	14.56%	14.02%	12.37%	11.69%	9.11%	8.79%
Kreditë Hipotekare	11.20%	11.76%	10.00%	9.72%	7.88%	7.01%
Kreditë me kushte favorizuese	7.71%	7.74%	6.30%	5.68%	2.76%	5.41%
Kreditë që nuk përfshihen në kategoritë më lartë	14.14%	13.09%	12.35%	10.75%	9.56%	7.58%
Bujqësore	21.90%	21.35%	17.29%	13.88%	11.32%	9.80%
Industriale	14.94%	12.67%	13.22%	10.97%	8.87%	7.45%
Shërbyese	13.83%	13.21%	11.88%	10.53%	9.99%	7.37%
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.90%

Tab. 1 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi (nëntor 2015)

Siç shihet nga tabela 1, normat efektive të interesit në fund të muajit shtator 2015 në raport me fundin e vitit 2010 kanë shënuar ulje të ndjeshme, që paraqet një ulje shumë të madhe në krahasim me pesë vite më parë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i shumë faktorëve, mirëpo në veçanti nga përmirësimi i ambientit të të bërit biznes, sikurse që është fillimi i punës së përmbartuesve privat, por edhe si rezultat i reduktimit të shpenzimeve të industrisë bankare dhe reflektimit të saj në uljen e normave të interesit në kredi. Në kuadër të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në Kosovë, mund të vërehet se për herë të parë vlera njëshifrore kanë shënuar edhe normat e interesit për kreditë bujqësore, sektor ky i konsideruar si shumë i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe në zvogëlimin e hendekut të bilancit tregtar të shtetit.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi (nëntor 2015)

Në figurën 1 mund të shohim trendin e të gjitha llojeve të kredive të lëshuara për sektor të ndryshëm të cilat kanë shënuar trend të vazhdueshëm të uljes së normës së interesit, me ç'rast ulja më e madhe është shënuar në dy vitet e fundit. Është e rëndësishme të vlerësohet se të gjitha kreditë e lëshuara për sektorë të ndryshëm të marrë për bazë krahasimi kanë normë efektive të interesit në vlera njëshifrore në fund të muajit shtator 2015.



Burimi: images.google.com

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI PËR KORPORATAT JO-FINANCIARE (2010 - SHTATOR 2015)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Sht-2015
Mbitërheqjet	12.65%	11.38%	10.20%	9.36%	9.35%	7.26%
Linjat Kreditore	13.27%	12.12%	11.37%	11.03%	11.76%	9.46%
Kreditë me kushte favorizuese	7.62%	8.02%	5.53%	5.97%	2.24%	2.88%
Kreditë që nuk përfshihen në kategoritë më lartë	14.11%	13.04%	12.34%	10.75%	9.56%	7.54%
Bujqësore	22.44%	21.13%	17.59%	13.88%	11.32%	9.28%
Industriale	14.94%	12.67%	13.22%	10.97%	8.87%	7.45%
Shërbyese	13.83%	13.21%	11.88%	10.53%	9.99%	7.37%
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	14.11%	13.04%	12.34%	10.75%	9.56%	7.54%

Tab. 2 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi (nëntor 2015)

Trend relativisht të njëjtë kanë edhe normat efektive të interesit edhe kreditë e lëshuara vetëm për korporatat jo-financiare, që në kuptim më të ngushtë nënkupton kreditë e lëshuara për subjektet juridike. Kjo mund të shihet nga tabela 2, me ç’rast mesatarja e normës efektive të interesit për këto lloj kredie në fund të muajit shtator 2015 ka shënuar vlerën 7.54% dhe që është nën mesataren e përgjithshme të kredive të lëshuara (7.90%).




Fig. 2 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi (nëntor 2015)

Sikurse mesatarja e përgjithshme e normës efektive të interesit për gjithsej kreditë edhe norma efektive e interesit në kredi për korporatat jo-financiare për të gjitha sektorët ka shënuar rënies gjatë pesë viteve të marra për bazë krahasimi, me ç’rast në fund të muajit shtator 2015 të gjitha janë në vlerën njëshifrore. Edhe kreditë bujqësore për korporatat jo-financiare kanë nivel më të ulët se sa mesatarja e përgjithshme për gjithsej kreditë bujqësore (9.8%) e cila shënoj vlerën 9.28%.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI PËR EKONOMITË FAMILJARE (2010 - SHTATOR 2015)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Sht-2015
Mbitërheqjet		16.44%	11.82%	14.88%	12.92%	12.30%
Kreditë Konsumuese	14.56%	14.02%	12.37%	11.69%	9.11%	8.79%
Kreditë Hipotekare	11.20%	11.76%	10.00%	9.72%	7.88%	7.01%
Kreditë me kushte favorizuese	7.76%	7.56%	6.83%	5.37%	3.15%	6.18%
Kreditë që nuk përfshihen në kategori më lartë	19.95%	21.35%	15.04%		14.43%	13.00%
Bujqësore	19.95%	21.35%	15.04%		14.43%	13.00%
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.77%	13.85%	12.00%	11.33%	8.88%	8.48%

Tab. 3 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi (nëntor 2015)

Tabela 3 tregon normën efektive të interesit në kredi për ekonomitë familjare, me ç'rast mund të shohim se edhe për këtë kategori për lloje të ndryshme të kredive, normat kanë shënuar rënie të ndjeshme. Norma efektive e interesit për gjithsej kreditë e ekonomive familjare në fund të muajit shtator shënoj ndër vlerat më të ulëta ndonjëherë nga industria bankare në 8.48%.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi (nëntor 2015)

Trendi rënës në normat efektive të interesit për kredi për ekonomitë familjare mund të shihet edhe nga figura 3. Përfundimisht normat e interesit për kreditë me kushte favorizuese, kreditë hipotekare të lëshuara për ekonomitë familjare paraqesin ndër normat më të ulëta të interesit në 7.01% në fund të muajit shtator 2015.

NORMA EFEKTIVE E INTERESIT NË DEPOZITA

Normat efektive të interesit në depozita gjithashtu kanë pasur lëvizje gjatë periudhave të ndryshme. Me rënien e normave të interesit në kredi, kjo gjë është reflektuar edhe tek normat e interesit në depozita, sidomos në dy vitet e fundit. Ulja e normave të interesit në depozita është reflektuar kryesisht në uljen e normave të interesit për kredi, duke stimuluar kështu edhe më shumë kreditimin. Tabela 4 i tregon të gjitha këto lëvizje.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË DEPOZITA (2010 - SH-TATOR 2015)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Sht-2015
Depozitat e transferueshme			0.67%	0.48%	0.04%	0.03%
Depozitat e kursimit			2.07%	1.66%	0.58%	0.30%
Depozitat e afatizuara			3.72%	2.40%	1.11%	0.91%
Norma efektive për gjithsej depozitat e reja	3.38%	3.62%	3.72%	2.40%	1.11%	0.91%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në depozita (nëntor 2015)




Fig. 4 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në depozita (nëntor 2015)

Siç shihet në figurën 4, normat efektive të interesit në depozita nga viti 2010, deri në vitin 2012 kanë shënuar rritje të lehta, përderisa nga viti 2013 dhe deri në fund të muajit shtator 2015 kanë shënuar rënie të ndjeshme. Nga tabela 4 e paraqitur mund të shihet se përqindja e interesit të fituar nga depozitat në llogari rrjedhëse është shumë e vogël. Kjo rënie e normave të interesit është edhe si rezultat i trendeve ndërkombëtare globale, me ç'rast në disa vende perëndimore disa nga bankat kanë filluar të zbatojnë interes (interes negativ) për klientin në depozitat e deponuara në bankë. Kjo është bërë gjithashtu me qëllim të reduktimit të kostove të financimit.



Burimi: images.google.com

Trend të njëjtë të uljes kanë pasur edhe normat e interesit të depozitave për korporatat jo-financiare, sikurse shihet në tabelën 5. Madje në disa raste kjo përqindje është më ulët se sa mesatarja e normës së interesit për gjithsej depozitat që janë shënuar në tabelën 4.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË DEPOZITA PËR KORPORATAT JO-FINANCIARE (2010 - SHTATOR 2015)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Sht-2015
Depozitat e transferueshme	0.63%	0.86%	0.83%	0.47%	0.10%	0.07%
Depozitat e kursimit	2.07%	2.20%	2.15%	1.74%	0.68%	0.10%
Depozitat e afatizuara			3.88%	1.61%	1.64%	0.60%
Norma efektive për gjithsej de- pozitat e reja			3.88%	1.61%	1.64%	0.60%

Tab. 5 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në depozita (nëntor 2015)




Fig. 5 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në depozita (nëntor 2015)

Figura 5 veçse e dëshmon këtë trend, me ç'rast ulja e ndjeshme e normave të interesit është shënuar kryesisht në dy vitet e fundit. Gjithashtu edhe normat efektive të interesit në depozita për ekonomitë familjare të paraqitura në tabelën 6 kanë shënuar të njëjtin trend lëvizës, pra të uljes gjatë dy viteve të fundit.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË DEPOZITA PËR EKONOMITË FAMILJARE (2010 - SHTATOR 2015)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Sht-2015
Depozitat e transferueshme	0.55%	0.48%	0.54%	0.50%	0.01%	0.01%
Depozitat e kursimit	2.21%	2.06%	2.06%	1.66%	0.58%	0.30%
Depozitat e afatizuara			3.66%	2.81%	0.85%	0.91%
Norma efektive për gjithsej de- pozitat e reja			3.66%	2.81%	0.85%	0.91%

Tab. 6 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në depozita (nëntor 2015)




Fig. 6 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në depozita (nëntor 2015)

Siç shihet në figurën 6, depozitat e afatizuara kanë shënuar rënien më të madhe nga 3.66% në 2010, në 0.91% në fund të muajit shtator 2015.

MARZHA E NORMËS MESATARE EFFEKTIVE TË INTERESIT

Edhe pse normat e interesit për depozita kanë shënuar ulje, megjithatë ulje më të madhe në normat efektive të interesit kanë shënuar ato për kredi, duke bërë që hendeku/diferenca ndërmjet këtyre dy normave të shkoj duke u zvogëluar.

Kjo lëvizje, përkatësisht zvogëlim i diferencës mund të shihet në figurën 7.




Fig. 7 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në depozita dhe kredi (nëntor 2015)

Në fund të muajit shtator 2015, diferenca ndërmjet normave të interesit për kredi dhe depozita shënoj vlerat më të vogla që nga koha e pasluftës duke arritur në 6.63%, nga 10.73% kur ishte në fund të vitit 2010.

Kjo ulje në diferencë, dëshmon për përkushtimin e madh që e ka bërë industria bankare drejt përmirësimit të ofertës financiare për të gjithë qytetarët e saj, me ç'rast përmes procesit të kreditimit ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit. Megjithatë vlerësohet se përmirësimi i kushteve varet nga shumë faktor dhe jo vetëm nga industria bankare, andaj në këtë kuptim ka ende punë me qëllim të përmirësimit edhe më të madh ambientit të të bërit biznes me qëllim të krijimit të kushteve më të mira.

NORMA E KREDIVE JO-PERFORMUESE (NPL)

Performanca e mirë e industrisë bankare sidomos drejt uljes së normave të interesit për kredi me qëllim të krijimit dhe ofrimit të kushteve më të mira për kreditim për qytetarët e Kosovës, mund të vërehet edhe nga menaxhimi me portofolion kreditore nga industria bankare në Kosovë. Tabela 7 e tregon lëvizjen e përqindjes së kredive jo-performuese dhe mbulueshmërisë që bankat kanë ndaj kredive të humbura.

KREDITË JO-PERFORMUES - NPL (2010 - SHTATOR 2015)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Sht-2015
NPL	5.9%	5.8%	7.5%	8.7%	8.3%	6.8%
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	116.5%

Tab. 7 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2014 dhe 2015 dhe Raporti i informatave mujore të sistemit financiar – shtator 2015)

Banka Qendrore e Kosovës, me gjithë kujdesin e shtuar nga industria bankare, përmes legjislacionit të saj, përkujdeset që bankat të jenë të provizionuara për çdo kredi të humbur, duke qenë kështu të gatshme në çdo moment që të mbulojnë të gjitha obligimet e tyre që mund të dalin nga kreditë e këqija.




Fig. 8 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2014 dhe 2015 dhe Raporti i informatave mujore të sistemit financiar – shtator 2015)

Në figurën 8 mund të shihet trendi lëvizës i përqindjes së kredive jo-performues, por edhe trendin mbi provizionimet nga kreditë e humbura. Kreditë jo-performuese në dy vitet e fundit kanë shënuar ulje të ndjeshme, duke paraqitur në të njëjtën kohë ndër normën më të ultë në rajon, gjë që tregon se bankat në Kosovë kanë qenë shumë të kujdesshme dhe më konzervative në kuptim të rrezikut. Kjo dëshmon edhe për sigurinë që e ofron industria bankare dhe për besueshmërinë e krijuar tashmë ndër vite për qytetarët, përkatësisht klientët e saj.

REFERENCAT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, tetor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita për sektorin bankar, nëntor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi për sektorin bankar, nëntor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i Informatave Mujore të Sistemit Financiar, shtator 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2014 dhe 2015, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

PERIODIKU BANKAR - NËNTOR 2015

RAPORTI NDËRMJET DEPOZITAVE DHE KREDIVE

RAPORTI I KREDIVE BRUTO DHE LIZINGJET NDAJ DEPOZITAVE

Industria bankare në Kosovë vazhdimisht ka shënuar vlera të rritjes për të dy indikatorët kryesor të saj që janë depozitat dhe kreditë e industrisë. Këta dy indikatorë paraqesin faktorë shumë të rëndësishëm të cilat paraqesin siguri, stabilitet dhe qëndrueshmëri për industrinë bankare. Stabiliteti dhe qëndrueshmëria e industrisë bankare është me rëndësi të veçantë për qytetarët e Kosovës për të pasur besueshmëri ndaj kësaj industrie, duke i besuar mjetet/depozitat këtij sektori për të zhvilluar aktivitetin afarist të kreditimit, por edhe zhvillimin e produkteve të tjera të ndërlidhura.

Industria bankare në Kosovë jo vetëm që ka shënuar vlera të rritjes për të dy këta indikatorë, por ka arritur që të administroj mirë depozitat dhe kreditë, gjithnjë duke mos tejkaluar mbi 80% raportin e kredive të lëshuara në krahasim me depozitat.

KREDITË BRUTO NË RAPORT ME DEPOZITAT (2010-2015)						Milion euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Nën-2015
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,628.3
Kreditë bruto dhe lizingjet	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,015.3
Raporti	75.3%	80.7%	77.4%	73.7%	74.2%	76.7%

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Siç shihet në tabelën 1, industria bankare në Kosovë ka arritur vlerën më të lartë të kredive të shënuar ndonjëherë deri në nëntor 2015 prej 2,015 milionë euro të lëshuara, përderisa depozitat shënuan vlerën prej 2,628 milionë euro në fund të muajit nëntor 2015. Sikurse çdo biznes tjetër që vepron në Kosovë edhe industria bankare është ballafaquar me vështirësi dhe sfida të ndryshme gjatë veprimtarisë së saj, gjë që ka bërë që niveli i rrezikshmërisë së tregut në të cilin operojnë të konsiderohet më i lartë. Sidoqoftë, viteve të fundit janë shënuar përmirësime të ndjeshme në këtë aspekt dhe pavarësisht këtyre sfidave, siç shihet në figurën 1, trendet tregojnë që depozitat dhe kreditë janë në rritje në vazhdimësi.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Ruajtja e raportit në 76.7% ndërmjet kredive të lëshuara dhe depozitave që industria bankare i ka në posedim, tregon se kjo industri është likuide dhe është në gjendje të mbulojë të gjitha obligimet e saj ndaj qytetarëve në çdo kohë. Sidoqoftë të dhënat e paraqitura në tabelën dhe figurën më lartë, paraqesin të dhënat bruto për të dy indikatorët, përderisa në vijim do të paraqesim të dhënat dhe raportin e tyre edhe për nën-kategoritë e tyre.



RAPORTI I KREDIVE NDAJ DEPOZITAVE PËR KORPORATAT TJERA FINANCIARE, KORPORATAT TJERA PUBLIKE DHE KORPORATAT JO-FINANCIARE

Raporti për nën-kategoritë e treguesve të kredive dhe depozitave ndryshon ndjeshëm në krahasim me bruto kreditë dhe depozitat, meqenëse disa nga sektorët e ekonomisë disponojnë më shumë mjete likuide, përderisa disa të tjera kanë nevojë për më shumë mjete likuide duke bërë kërkesën për kredi tek industria bankare, që në fakt paraqet edhe thelbin e kreditimit, përkatësisht rolin ndërmjetues që e bën në këtë mes industria bankare ndërmjet këtyre sektorëve të ndryshëm.

KREDITË NË RAPORT ME DEPOZITAT PËR KORPORATAT TJERA FINANCIARE (2010-2015)						Million euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Nën-2015
Depozitat KTF	98.0	107.6	116.6	86.4	102.0	80.6
Kreditë KTF	9.9	17.3	19.8	20.4	7.1	8.1
Raporti	10.1%	16.1%	17.0%	23.7%	7.0%	10.0%

Tab. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Siç shihet nga tabela 2, vetëm 10% e depozitave të korporatave tjera financiare i kreditohen këtij sektori ekonomik, përderisa pjesa tjetër e depozitave shfrytëzohen për të bërë kreditimin e sektorëve të tjerë.





Fig. 1 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi (nëntor 2015)



Ashtu sikur depozitat edhe vlerat e kredisë kanë pas trend të ndryshëm nëpër vite, çka tregon për një stabilitet jo shumë të qëndrueshëm të korporatave tjera financiare në ekonominë e Kosovës, megjithëse vlerat e depozitave sillen ndërmjet 80-116 milionë euro ndërmjet viteve krahasuese.

Një raport edhe më të vogël të kreditimit në krahasim me depozitat e po të njëjtit sektor kanë depozitat dhe kreditë për korporatat tjera publike të cilat mund të shihen në tabelën 3 më poshtë.

KREDITË NË RAPORT ME DEPOZITAT PËR KORPORATAT TJERA PUBLIKE (2010-2015)						Milion euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Nën-15
Depozitat KTP	126.6	128.6	75.6	72.1	61.8	36.2
Kreditë KTP	6.3	1.5	1.4	0.2	0.6	0.1
Raporti	4.9%	1.2%	1.9%	0.3%	1.0%	0.3%

Tab. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Raporti ndërmjet këtyrë dy indikatorëve në nëntor të 2015 ka qenë vetëm 0.3%.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Depozitat, por edhe kreditë, kanë shënuar ulje të ndjeshme për korporatat publike, çka nënkupton se edhe mjetet likuide të këtij sektori në industrinë bankare janë zvogëluar. Këtë e tregon edhe trendi i paraqitur në figurën 3.

Pjesën më të madhe të kredive që industria bankare e lëshon për qytetarët e Kosovës e përbëjnë kreditë për korporatat jo-financiare, ku përfshihen pjesa kryesore e bizneseve të Kosovës. Tabela 4 paraqet vlerat e depozitave dhe kredive të këtij sektori.

KREDITË NË RAPORT ME DEPOZITAT PËR KORPORATAT JO-FINANCIARE (2010-2015)						Milion euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Nën-15
Depozitat KJF	301.9	287.8	335.7	397.7	396.5	440.3
Kreditë KJF	1,004.1	1,127.0	1,169.8	1,194.5	1,246.4	1,326.8
Raporti	332.6%	391.6%	348.5%	300.3%	314.4%	301.3%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Kreditë e lëshuara për këtë sektor kanë tejkaluar vlerën e 1 miliard eurove, përderisa depozitat kanë shënuar vlerën prej 440 milionë euro. Është e rëndësishme të theksohet fakti se të dy këta indikatorë të këtij sektori kanë shënuar rritje të vazhdueshme nëpër vite, trend ky i cili shihet në figurën 4.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Siç mund të shihet nga tabela 4, kreditë e lëshuara në raport me depozitat për korporatat tjera depozituese në nëntor 2015 ka shënuar normën prej 301.3%, çka tregon se industria bankare depozitat e sektorëve të tjerë i shfrytëzon për të bërë kreditimin e këtij sektori, kryesisht depozitat e ekonomive familjare të cilat gjithashtu do të trajtohen në vijim. Kreditë e lëshuara për këtë sektor deri në nëntor 2015 janë rritur për 6.4% në raport me fundin e vitit 2014, përderisa 4.3% ishte rritja në 2014 në raport me vitin 2013.

RAPORTI NDËRMJET DEPOZITAVE DHE KREDIVE PËR EKONOMITË FAMILJARE, ORGANIZATAT JO-PROFITABILE DHE JO-REZIDENTËT

Përderisa korporatat jo-financiare përbënin pjesën kryesore të kredive të industrisë bankare, ekonomitë familjare përbëjnë pjesën kryesore të depozitave të industrisë bankare. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e depozitave të ekonomive familjare shfrytëzohen për kreditimin e korporatave jo-financiare, përkatësisht të bizneseve. Të dhënat e tabelës 5 tregojnë vlerën në depozita dhe në kredi të lëshuara për ekonomitë familjare.

KREDITË NË RAPORT ME DEPOZITAT PËR EKONOMITË FAMILJARE (2010-2015)						Milion euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Nën-15
Depozitat EF	1,299.3	1,490.5	1,640.1	1,775.0	1,848.3	1,928.4
Kreditë EF	434.2	510.9	542.6	563.9	621.6	673.5
Raporti	33.4%	34.3%	33.1%	31.8%	33.6%	34.9%

Tab. 5 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave të ekonomive familjare në nëntor 2015 ishte 34.9%, çka nënkupton se jo të gjitha depozitat e ekonomive familjare shfrytëzohen për kreditim të kësaj kategorie, mirëpo një pjesë e konsiderueshme e saj shfrytëzohet për të bërë kreditimin për sektor të tjerë. Ky raport ka qenë afërsisht i njëjtë gjatë viteve të krahasuara.

Të dy indikatorët e kësaj nën-kategorie kanë shënuar rritje nëpër vitet të cilat janë marrë për bazë krahasimi. Trendi rritës i tyre mund të shihet në figurën 5.




Fig. 5 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Është e rëndësishme të theksohet se depozitat e ekonomive familjare në nëntor 2015 u rritën prej 4.3% në raport me fundin e vitit 2014, përdërisa kreditë e lëshuara për këtë nën-kategori u rritën për 8.3% gjatë po të njëjtës periudhë.

Depozitat dhe kreditë për organizatat jo-profitabile e përbëjnë një pjesë relativisht të vogël të këtyre dy indikatorëve në kuadër të industrisë bankare. Tabela 6 i tregon këto vlera.



KREDITË NË RAPORT ME DEPOZITAT PËR ORGANIZATAT JO-PROFITABILE (2010-2015)						Milion euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Nën-15
Depozitat OJP	14.5	22.6	23.3	26.9	31.1	35.4
Kreditë OJP	0.1	1.5	0.4	0.9	0.1	0.1
Raporti	1.0%	6.7%	1.7%	3.2%	0.5%	0.4%

Tab. 6 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Depozitat e organizatave jo-profitabile kanë shënuar rritje nëpër vite, megjithëse vlera e tyre nuk ka peshë të madhe në gjithsej depozitat e industrisë bankare. Megjithatë trendi rritës i tyre i cili mund të shihet në figurën 6, paraqet trendin rritës të aktiviteteve për këto organizata. Kreditimi për këtë sektor është shumë i vogël dhe i cili mund të vërehet jo vetëm nga vlera e kredive të lëshuara, por edhe nga raporti ndërmjet kredive të lëshuara dhe depozitave për këto organizata.




Fig. 6 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Në industrinë bankare një pjesë e rëndësishme të depozitave e përbëjnë edhe ato të personave jo-rezident. Tabela 7 paraqet të dhënat për këtë nën-kategori për të dy indikatorët e marrë për krahasim.

KREDITË NË RAPORT ME DEPOZITAT PËR JO-REZIDENTËT (2010-2015)						Milion euro
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	Nën-15
Depozitat JR	84.8	64.2	86.9	89.1	88.9	97.9
Kreditë JR	1.6	32.4	22.5	19.9	0.5	0.4
Raporti	1.9%	50.5%	25.9%	22.3%	0.5%	0.4%

Tab. 7 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

Depozitat kanë shënuar rritje të vazhdueshme në të gjitha vitet e marra për bazë krahasimi, përderisa kreditë e lëshuara për këtë nën-kategori kanë shënuar ulje të ndjeshme, sidomos në dy vitet e fundit. Ky trend lëvizës për të dy indikatorët mund të shihet në figurën 7.




Fig. 7 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave tjera depozituese (janar 2016)

REFERENCAT

- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, janar 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

PERIODIKU BANKAR - DHJETOR 2015

SHËRBIMET ELEKTRONIKE BANKARE

I.

SHËRBIMET ELEKTRONIKE BANKARE

Industria bankare në Kosovë gjithnjë e më shumë është duke u orientuar dhe zhvilluar drejt avancimit dhe përdorimit sa më të madh të shërbimeve elektronike. Ky zhvillim i hovshëm drejt avancimit të instrumenteve të pagesave elektronike është një përgjigje drejt zhvillimit të teknologjisë informative në përgjithësi në përputhje me trendet ndërkombëtare. Njëkohësisht kjo paraqet përshtatjen e industrisë bankare drejt kërkesave dhe nevoja të reja të klientëve me qëllim që këto shërbime të jenë sa më të sigurt, lehtë të realizueshme, qasje të lehtë si dhe të shpejta në kuptim të kursimit të kohës.



Është e rëndësishme të vlerësohet se këtij zhvillimi të hovshëm të shërbimeve elektronike në industrinë bankare të Kosovës i janë përgjigjur pozitivisht edhe qytetarët e saj, me ç'rast përdorimi i tyre sa i përket shifrave është gjithnjë në rritje duke shënuar vlera të dyfishimit të tyre në disa raste.

Numri i kartelave bankare

Për të parë këtë zhvillim, tabela 1 tregon numrin e kartelave bankare të lëshuara nga industria bankare për qytetarët e Kosovës.

STATISTIKA MBI NUMRIN E KARTELAVE BANKARE				
Nr.	Kartelat sipas funksionit	2013	2014	2015
I.	Kartela me funksion cash-i	754,380	813,026	1,041,592
II.	Kartela me funksion pagese prej të cilave:	754,380	799,742	1,041,592
	1 - Kartelat me funksion debiti	645,048	678,090	837,747
	2 - Kartela me funksion krediti	109,332	121,652	203,845
III.	Kartela me funksion para prej të cilave:	15,017	13,284	199
	1 - Kartela me funksion para	15,017	13,284	196
IV.	Numri total i kartelave prej të cilave:	769,397	813,026	1,041,791
	1- Kartela me funksion të kombinuar debiti, cash-i apo para elektronike	769,397	813,026	1,029,094

Tab. 1 | Burimi: BQK – Raport mujor mbi instrumentet cash dhe jocash (shkurt 2016)

Në fund të vitit 2015 numri i kartelave bankare në shfrytëzim është rritur për 28.1% në krahasim me vitin 2014, për dallim prej 7.7% që ishte rritja e vitit 2014 në raport me vitin 2013. Këtë rritje më të madhe në fund të vitit 2015 mund të shihet edhe në figurën 1 të paraqitur.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Raport mujor mbi instrumentet cash dhe jocash (shkurt 2016)

Kartelat me funksion krediti në fund të vitit 2015 u rritën ndjeshëm apo më saktë u rritën për 67.5% në raport me vitin 2014. Edhe kartelat me funksion debiti shënuan rritje prej 23.5% në raport me vitin 2014.

Kartelat e industrisë bankare përdoren për blerje çoftë ajo online përmes internetit, tërheqje në kesh përmes bankomatëve (ATM) apo pagesa përmes pikave shitëse. Tabela 2 paraqet të dhëna mbi numrin e terminaleve të bankave të cilat janë në shfrytëzim për qytetarët e Kosovës.

Numri i terminaleve për kartelat dhe paranë elektronike

STATISTIKA MBI NUMRIN E KARTELAVE BANKARE								
Nr.	Terminalet sipas funksionit	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
I.	Automated Teller Machines (ATM) prej të cilave:	339	415	460	483	496	498	540
	1-ATM me funksion tërheqje cash	339	415	460	483	496	498	540
	2-ATM me funksion transferim krediti prej të cilave:	112	141	147	145	148	50	97
	a-ATM me funksion të pagesave KOS-GIRO	N/A	39	69	73	70	50	97
	3- ATM me funksion depozitimi cash	0	0	1	1	8	13	78
II.	Terminale POS (Point of Sale) prej të cilave:	5,251	6,194	7,534	8,592	9,071	9,349	9,705
	1-terminale POS me funksion tërheqje cash	212	212	1,376	220	215	220	180
	2-terminale EFTPOS	5,223	5,930	6,320	8,499	8,856	9,179	9,525

Tab. 2 | Burimi: BQK – Raport mujor mbi instrumentet cash dhe jocash (shkurt 2016)

Siç mund të shihet nga të dhënat e paraqitura në tabelën 2, të gjitha vlerat kanë shënuar rritje me ç'rast në fund të vitit 2015 numri i pikave shitëse (POS) është rritur për 3.8% në raport me vitin 2014, përderisa numri i bankomatëve (ATM) është rritur për 8.4%. Nëse e bëjmë një krahasim të njëjtë për një periudhë më të gjatë ndërmjet viteve 2009-2015, atëherë mund të shihet se numri i bankomatëve është rritur për 59.2%, përderisa numri i pikave shitëse është rritur për 84.8%.



Numri dhe vlera e transaksioneve me kartela përmes terminaleve

Në tabelën 3 dhe 4 mund të shohim se sa përdoren kartelat bankare për nga numri dhe vlera e transaksioneve në bankomate dhe në pikat shitëse të industrisë bankare. Më saktë tabela 3 e tregon numrin e transaksioneve të realizuara me kartela nëpër vite.

NUMRI I TRANSAKSIONEVE ME KARTELA PËRMES TERMINALEVE				
Nr.	Përshkrimi	2013	2014	2015
I.	Total i transaksioneve me kartela prej të cilave:	13,129,074	14,734,189	16,183,996
	1-ATM tërheqje cash	9,251,512	9,926,136	10,422,617
	2-ATM depozitime	5,314	27,724	232,625
	3-Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve	108,308	70,160	42,572
	4-Tërheqje cash në terminale POS	21,964	13,333	14,523
	5-Pagesa me kartela në terminale POS	3,741,976	4,696,836	5,471,659

Tab. 3 | Burimi: BQK – Raport mujor mbi instrumentet cash dhe jocash (shkurt 2016)

Totali i transaksioneve në fund të vitit 2015 është rritur për 9.8% në raport me vitin 2014. Numri i transaksioneve përmes ATM-ve është rritur për 5%, përderisa pagesa me kartela përmes POS është rritur për 16.4%. Është e rëndësishme të theksohet se depozitimet në ATM kanë filluar gjithashtu të shënojnë rritje të ndjeshme në raport me vitin 2014, megjithëse në vlera më të vogla, me ç'rast rritja ishte për 739% në fund të vitit 2015.

Trend afërsisht të ngjashëm kanë shënuar edhe vlerat e transaksioneve të realizuara përmes këty instrumenteve të pagesave. Tabela 4 i tregon këto të dhëna.

VLERA E TRANSAKSIONEVE ME KARTELA PËRMES TERMINALEVE				
Nr.	Përshkrimi	2013	2014	2015
I.	Total i transaksioneve me kartela prej të cilave:	1,115,499,704	1,262,232,598	1,728,032,876.06
	1-ATM tërheqje cash	936,184,272	996,236,120	1,222,659,417.13
	2-ATM depozitime	1,953,275	13,488,633	181,428,729.23
	3-Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve	781,258	515,457	373,621.03
	4-Tërheqje cash në terminale POS	24,576,284	13,878,586	20,357,075.19
	5-Pagesa me kartela në terminale POS	191,954,615	238,113,801	303,214,033.48

Tab. 4 | Burimi: BQK – Raport mujor mbi instrumentet cash dhe jocash (shkurt 2016)

Siç mund të shihet, totali i gjithsej vlerës së transaksioneve me kartela në vitin 2015 është rritur për 36.9% në raport me vitin 2014. Vlerat e tërheqjeve në ATM në fund të vitit 2015 kanë shënuar rritje poashtu prej 22.7% në raport me vitin 2014. Gjithashtu vlera e pagesave me kartela në terminalet e POS-it kanë shënuar rritje prej 27.3%.



Numri dhe vlera e llogarive e-banking

Zhvillimi i shërbimeve teknologjike ka bërë që njerëzit të shfrytëzojnë ato në masë të madhe, duke bërë kështu që edhe nevoja për ta vizituar degën e bankës nga klienti të jetë shumë më e vogël në krahasim me të kaluarën. Kjo për faktin se qytetaret e Kosovës përdorin gjithnjë e më shumë shërbimin elektronik e-banking përmes secilës mundësohet që të realizohen pothuajse të gjitha llojet e transaksioneve duke filluar nga pagesat më të thjeshta (pagesa të faturave të përditshme) të nevojshme deri tek ato pagesa përmes secilave u mundësohet qytetarëve që të shlyejnë obligimet e tyre tatimore, doganave, kontributeve dhe shumë mundësive tjera.

Tabela 5 tregon rritjen e numrit të llogarive e-banking ndër vite. Në fund të vitit 2015 numri i llogarive e-banking është rritur për 18.7% në raport me vitin 2014. Nëse numri i llogarive e-banking në fund të 2015 krahasohet me vitin 2010, atëherë ky numër është rritur për 238%.

NUMRI I LLOGARIVE E-BANKING							
Nr.	Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
I.	Numri i llogarive E-Banking	55,292	68,990	97,089	131,365	157,761	187,297

Tab. 5 | Burimi: BQK – Raport mujor mbi instrumentet cash dhe jocash (shkurt 2016)




Fig. 2 | Burimi: BQK – Raport mujor mbi instrumentet cash dhe jocash (shkurt 2016)

Trendi i rritjes së numrit të llogarive e-banking mund të vërehet edhe nga figura 2 e paraqitur, e cila ka shënuar gjithnjë trend pozitiv në të gjitha vitet e marra për krahasim.

VËLLIMI I TRANSAKSIONEVE E-BANKING PARAQITUR NË NUMËR DHE VLERË GJATË VITEVE								
Nr.	Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
1.	Numri i transaksioneve	228,886	318,375	424,273	625,762	1,056,655	1,579,838	2,311,564
2.	Vlera e transaksioneve	607,305,816.66	782,383,356.93	1,218,089,663.00	1,499,093,438.23	2,671,011,545.81	4,220,405,695.61	5,746,325,675.39

Tab. 6 | Burimi: BQK – Raport mujor mbi instrumentet cash dhe jocash (shkurt 2016)

Rritja e numrit dhe e vlerave të transaksioneve përmes e-banking mund të shihet në tabelën 6. Kjo rritje dëshmon se qytetarët e Kosovës kanë pranuar pa problem zhvillimin elektronik të shërbimeve të bërë nga industria bankare, për faktin se këto zhvillime janë konform edhe nevojës së tregut.

II. INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRISË BANKARE

Industria bankare në Kosovës ka treguar stabilitet dhe qëndrueshmëri në vazhdimësi që nga paslufta dhe deri në vitet e fundit, duke ofruar siguri si dhe duke treguar besueshmëri tek qytetarët e Republikës së Kosovës. Industria bankare ka shënuar vlera pozitive të rritjes pothuajse në të gjithë indikatorët kryesorë të saj, çka tregon për një treg të shëndoshë të kësaj industrie.

Struktura e asetëve

Tabela 7 tregon të dhëna mbi gjithsej asetet e industrisë bankare si dhe të strukturës së kësaj industrie.

STRUKTURA E ASETËVE TË INDUSTRISË BANKARE (milion euro)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.2
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.7	316.0
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.5
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,019.4
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.3
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	27.9	29.8
Gjithsej Asete	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,185.6	3,387.3

Tab. 7 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Në kuadër të gjithsej asetëve të industrisë bankare, pjesën kryesore e përbëjnë kreditë dhe lizingu me gjithsej 59.6% (2015), pastaj paraja e gatshme me 14.5%, letrat me vlerë 14.0% dhe kështu me radhë.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Trendi i rritjes të gjithsej asetëve dhe kredive mund të vërehet edhe nga figura 3 e paraqitur. Në fund të vitit 2015, gjithsej asetet janë rritur për 6.3% në raport me vitin 2014, përderisa kreditë dhe lizingu është rritur për 7.2% gjatë të njëjtës periudhë.

Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (milion euro)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.6	43.4
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,701.4
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	3.1
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.2	191.2
Borxhi i ndërvarur	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3	36.8
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.0	393.8
Gjithsej Detyrime	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,185.6	3,387.3

Tab. 8 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Në kuadër të strukturës së detyrimeve nga tabela 8 mund të shihet se depozitat dominojnë pjesën kryesore me gjithsej 79.8% të gjithsej detyrimeve në fund të vitit 2015, përderisa pjesën tjetër e përbëjnë mjetet vetanake me 11.6%, detyrime tjera me 5.6% dhe kështu me radhë.

Tabela 9 tregon mbi raportin ndërmjet depozitave dhe kredive të industrisë bankare. Nga të dhënat e marra për bazë krahasimi, mund të shihet se industria bankare gjithnjë ka mbajtur raportin ndërmjet kredive dhe depozitave në afërsisht 80%, duke qenë kështu likuide gjatë gjithë kohës dhe e gatshme të mbuloj obligimet e saj në çdo kohë.

KREDITË BRUTO NË RAPORT ME DEPOZITAT (milion euro)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,701.4
Kreditë bruto dhe lizingjet	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,019.4
Raporti	75.3%	80.7%	77.4%	73.7%	74.2%	74.8%

Tab. 9 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Në figurën 4 gjithashtu mund të vërehet trendi rritës i të dy indikatorëve më kryesorë të industrisë bankare që janë depozitat dhe kreditë.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Rritja e depozitave dhe kredive është në raport afërsisht të ngjashëm me njëra tjetrën, duke siguruar që kreditë e lëshuara nga kjo industri të mos tejkalojnë asnjëherë depozitat e qytetarëve që i kanë deponuar.

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4

Tab. 10 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik (shkurt 2016)

Në kuadër të strukturës së kredive të lëshuara për sektorë të ekonomisë, dominojnë kreditë e lëshuara për tregti të cilat në fund të vitit 2015 përbënin 51.2% të gjithsej kredive sipas aktivitetit ekonomik, pastaj prodhimi me 12.3%, shërbimet tjera me 9.3% dhe kështu me radhë. Në shumicën e sektorëve ekonomik, vlerat e kredive kanë shënuar rritje nëpër vite, më përjashtim të ndërtimtarisë e cila ka shënuar një rënie të lehtë.



Të hyrat dhe shpenzimet

Industria bankare në Kosovë gjithashtu ka shënuar vazhdimisht vlera pozitive të të hyrave në raport me shpenzimet. Në tabelën 11 dhe 12 mund të shohim këtë raport të këtyre dy indikatorëve.

TË HYRAT E INDUSTRIËS BANKARE (milion euro)								
Perioda	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimi	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	169.6	2.7	3.1	0.4	37.5	3.9	.	217.2
2011	186.3	4.1	4.2	0.5	41.7	3.3	.	240.1
2012	194.9	2.0	3.0	0.6	44.2	2.4	.	247.0
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	190.7	1.1	2.9	2.5	44.6	3.1	0.5	245.3
2015	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 11 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Në tabelën 11 mund të shohim se të hyrat nëpër vite të marra për krahasim kanë qenë afërsisht të njëjta, përderisa shpenzimet nëpër vite kanë shënuar ulje sidomos në tri vitet e fundit, çka ka bërë që edhe fitimi i realizuar për këtë sektor të rritet.

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)										
Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
2010	49.4	4.8	1.1	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.5	184.8
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	36.4	3.3	4.5	11.1	20.5	42.7	35.1	24.4	6.8	184.8
2015	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 12 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Në figurën 5 janë të paraqitura trendet e të hyrave dhe shpenzimeve si dhe ndryshimin ndërmjet këtyre dy indikatorëve, përkatësisht fitimin e realizuar nga industria bankare.




Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Industria bankare në fund të vitit 2015 shënoj një fitim në vlerë prej 94.7 milionë euro, që paraqet një rritje prej 56.5% më shumë se sa në vitin 2014.



Normat efektive të interesit

Industria bankare gjatë dy viteve të fundit ka arritur që të zvogëloj ndjeshëm normën efektive të interesit në kredi, çka nënkupton se kostoja e kredisë për qytetarët e Kosovës është zvogëluar. Me uljen e normës efektive të interesit në kredi, pavarësisht rënies së normës efektive të interesit në depozita, ka bërë që të zvogëlohet edhe diferenca në përqindje ndërmjet këtyre dy normave.




Fig. 6 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi dhe depozita të reja (shkurt 2016)

Siç shihet edhe nga trendi i paraqitur në figurën 6, që nga viti 2013 të dy normat e interesit, duke përfshirë edhe margjinën ndërmjet normës së interesit në kredi dhe depozita kanë shënuar ulje të ndjeshme.

Është e rëndësishme të potencohet se norma efektive e interesit në kredi ka arritur vlerën më të ultë që ka shënuar ndonjëherë industria bankare në Kosovë, që në fakt paraqet një sukses shumë të rëndësishëm për këtë industri.



Kreditë jo-performuese

Shëndeti i industrisë bankare mund të vlerësohet edhe nga përqindja e kredive të këqija të cilat industria bankare i ka shënuar. Tabela 13 paraqet përqindjen e kredive të këqija si dhe provizionet për humbjet nga kreditë.

KREDITË JO-PERFORMUES - NPL						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
NPL	5.9%	5.8%	7.5%	8.7%	8.3%	6.2%
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%

Tab. 13 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore (shkurt 2016)

Industria bankare ka arritur që të administroj mirë portofolion e saj kreditore, krahas rritjes në vlerë të kredive, me ç'rast në fund të vitit 2015 ka shënuar ndër vlerat më të ulëta në këto vite të marra për bazë krahasimi, pra në 6.2%.

Referencat

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, janar 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, dhjetor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, shkurt 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, shkurt 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, shkurt 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash, shkurt 2016, <http://bqk-kos.org/?id=125>;

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN JANAR 2015

PEZULLOHET MARRËVESHJA KOLEKTIVE

Dy euro në ditë rritje të pagës për 0,5 për qind për çdo vit pune, tetë orë punë, e siguri në vend të punë. Pak a shumë këto ishin pritjet e punëtorëve në rast se do të fillohej të zbatohet nga 1 janari Marrëveshje Kolektive. Mirëpo, zbatimi i kësaj marrëveshje tashmë është pezulluar. Pezullimin e marrëveshjes e ka konfirmuar Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi. Ai ka njoftuar se pezullimi është bërë për shkak se ajo nuk është në harmoni me Ligjin e Punës. (Zëri, 8 janar 2015)



KOSOVA ME BILANC POZITIV TË INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), ka njoftuar se Kosova vazhdon të regjistrojë bilanc pozitiv të pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN) i cili në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014, duke arritur vlerën prej 396.7 milionë euro. BQK-ja, ka njoftuar se në fund të tremujorit paraprak, kjo vlerë ishte 327.8 milionë euro. Edhe detyrimet ndërkombëtare kanë shënuar rritje në vlerë prej 115.4 milionë euro të cilat kanë shënuar vlerën 3.90 miliardë euro në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014. (Telegrafi, 8 janar 2015)



ZYRA LIGJORE: MARRËVESHJA KOLEKTIVE NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN E PUNËS

Marrëveshja Kolektive nuk është në harmoni me Ligjin e Punës. Kjo është përgjigjja zyrtare që Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi e ka marrë nga zyra Ligjore e kësaj ministrie. Burime të Gazetës Tribuna brenda kësaj ministrie, bëjnë të ditur se zyra ligjore ka konstatuar se shumë nene të Marrëveshjes Kolektive janë në kundërshtim me Ligjin e Punës. Sipas burimit, një nga nenet kundërthënëse të Ligjit të Punës me Marrëveshjen Kolektive është neni 90.5, që ka të bëjë me palët që detyrohen që zbatojnë këtë kontratë. Ndërkaq, javën e kaluar ministri Abrashi për Tribuna ka thënë se, në rast se konstatohet se marrëveshja kolektive është në kundërshtim me Ligjin e Punës, atëherë nuk do të fillojë zbatimi i saj. Ai ka thënë se ka gjasë që zbatimi i marrëveshjes kolektive të shtyhet edhe për një kohë për shkak se do të ndryshojë edhe Ligji i Punës. “Ne do të ndryshojmë edhe Ligjin e Punës, në mënyrë që ky ligj të jetë më atraktiv si për punëdhënësit ashtu edhe për punëmarrësit. Pasi që ligji është në procedurë të ndryshim është e logjikshme që të pritet që Marrëveshja Kolektive të amendamentohet në bazë të ligjit të ri”, ka thënë Abrashi. (Tribuna, 13 janar 2015)



KOMITETET NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS PËRZGJEDHIN KRYESINË E RE

Në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) funksionojnë dhjetë komitete të fushave të ndryshme të sektorit bankar. Komitetet përbëhen nga përfaqësues respektiv të tetë anëtarëve të SHBK-së. Komitetet kanë funksione tejet të rëndësishme për të trajtuar çështje specifike që ndikojnë në funksionimin më të mirë të sektorit. Në pjesën e dytë të vitit 2014 u bë përzgjedhja e kryesisë së re në disa nga komitetet aktive në SHBK.

Komitetet të cilat kanë përzgjedhë kryesinë e re janë:

Emri i komitetit	Kryetari i përzgjedhur	Institucioni	Nënkryetari i përzgjedhur	Institucioni	Data e përzgjedhjes së kryesisë së re
Komiteti i Pa- jtueshmërisë dhe AML-së	Ali Krasniqi	BKT	Alban Hetemi	ProCredit Bank	24 tetor 2014
Komiteti Ligjor	Agron Krasniqi	BpB	Ilir Gaxha	TEB Bank	17 dhjetor 2014
Komiteti i Financave	Rezak Fetai	ProCredit Bank	Rudin Lleshaj	BKT	23 tetor 2014
Komiteti i Marketingut dhe PR	Antigona Bejtul- lahu	Raiffeisen Bank	Zana Rizva- nolli	NLB Prishtina	22 shtator 2014
Komiteti i Riskut	Gem Maloku	NLB Prishtina	Besian Mus- tafa	TEB Bank	17 shtator 2014

Ashtu siç edhe është e përcaktuar në procedurat e punës së këtyre komiteteve, mandati i kryesisë së re është dyvjeçar. Drejtori Ekzekutivë i SHBK-së z. Petrit Balijsa dhe stafi i SHBK-së shfrytëzojnë rastin të falenderojnë të gjithë përfaqësuesit e kryesive të kaluara për punën dhe kontributin e palodhshëm të dhënë gjatë mandatit të tyre, përderisa ju dëshiron shumë suksese kryesive të reja të zgjedhura. (Shoqata e Bankave të Kosovës, 9 janar 2015)


REMITENCAT, 214 MILIONË EURO

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), ka njoftuar se remitencat në Kosovë në tremujorin e tretë 2014 ishin 214 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 9.2 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sipas BQK-së, në tremujorin e tretë të vitit 2014 deficiti i llogarisë rrjedhëse ishte 91.8 milionë euro, që paraqet një rënie prej 7.9 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2013. (Telegrafi, 6 Janar 2015)



EURO NË “VITIN ZERO”!

Me rënien konstante të ditëve të para të këtij viti, monedha e përbashkët europiane nuk ka prekur vetëm nivelet më të ulta në nëntë vitet e fundit, por është rikthyer 16 vite pas. Në mbylljen e ditës së parë të debutimit në treg, më 4 janar 1999, Euro këmbëhej me 1,1825 dollarë. Sot ajo vlen thujt njësoj sa vlete në momentin e parë të hyrjes në tregjet europiane, duke u këmbyer me 1,1868 dollarë. Gjatë këtyre 16 viteve, monedha e përbashkët europiane ka përshkuar një trajektore jo të lehtë: tre presidentë të bankës qendrore europiane, 2 recesione ekonomike apo edhe zgjerim i vazhdueshëm kufijsh. (Telegrafi, 8 janar 2015)



BB: NË 2015 RITJA E EKONOMISË GLOBALE DO TË ARRIJË 3%

Në vitin 2015, rritja e ekonomisë globale do të arrijë në 3 për qind, sipas Bankës Botërore në raportin e saj të fundit "Perspektiva e Ekonomisë Globale". BB-ja vuri në dukje se me përmirësimin e nivelit të punësimit dhe politikave lehtësuese monetare, shihet një fuqizim i ekonomisë amerikane dhe asaj britanike. Ndërsa, në Eurozonë dhe në Japoni ende nuk ka një situatë optimiste dhe nga ana tjetër deflacioni që ka goditur Eurozonën duket se do vazhdojë për një kohë të gjatë. (Telegrafi, 14 janar 2015)



KREDI PA INTERES PËR AGROBIZNESET

Agrobizneseve dhe ndërmarrjeve të vogla në Gjilan do t'u ofrohet sivjet një mundësi e mirë që të përfitojnë kredi bankare, pa qenë të detyruar të paguajnë edhe një cent më shumë se sa kanë marrë. Bizneset mikro, si dhe fermerët mund të përfitojnë kredi në shumat 5.000, 7.000 dhe 10.000 euro, për një periudhë trevjeçare ose edhe më të gjatë, varsisht nga banka dhe do të jenë të obliguar të kthejnë vetë, shumën bazë, pa normën e interesit. Interesin e paguan Komuna kurse riskun e kredisë e merr përsipër vetë banka. (Kosova Sot, 23 janar 2015).



LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN SHKURT 2015

PANAIRI I PUNËS NGA SHBK DHE EUICC

Rreth 200 të rinj që studiojnë apo kanë mbaruar studimet Bachelor/Master në drejtimet përkatëse, kanë shfrytëzuar panairin e punësimit me bankat komerciale të mbajtur në Qendrën Informativë dhe Kulturore të BE-së në Prishtinë për t'u njoftuar mbi mundësitë e punësimit apo mbajtjes së praktikës në industrinë bankare.

Panairi u organizua nga Qendra Informativë dhe Kulturore e BE-së (EUICC) në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës (SHBK) dhe në të morën pjesë pesë banka komerciale: Raiffeisen Bank, Pro Credit Bank, NLB Prishtina, Banka Kombetare Tregtare dhe İşBank.

Përfaqësuesit e bankave shpalosën para të interesuarve mundësitë që ofrojnë për praktikë profesionale dhe punësim, teksa mblodhën CV të kandidatëve që shfaqën interesim për t'u punësuar në sektorin bankar. Panairi i Punës ishte një mundësi për studentët apo të diplomuarit që të takohen sy më sy me përfaqësues të bankave, të cilët rekrutojnë kandidatë të suksesshëm për punë. Ai ofroi një pasqyrë më reale të tregut të punës në industrinë bankare, që është mjaft aktraktive për të rinjtë. Në këtë mënyrë studentët patën mundësinë që ta kuptojnë se tregu është mjaft konkurrues dhe ata duhet të përgatiten mirë profesionalisht që të arrijnë të punësohen.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balijsa theksoi rëndësinë e angazhimit të të gjithëve për uljen e papunësisë në Kosovë.

“Punësimi është çelësi i shumë prej problemeve me të cilat ballafaqohet shteti ynë i ri. Prandaj është me rëndësi që të vëhen në lëvizje jo vetëm qeveria e Kosovës por edhe sektori privat, organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, universitetet dhe kolegjet si dhe mediat në mënyrë që të gjithë të kontribuojnë në uljen e papunësisë për të përmirësuar perspektivën e të rinjëve në Kosovë”, tha ai.

Panairi i punësimit me bankat komerciale në Kosovë është pjesë e fushatës së Qendrës Informativë dhe Kulturore të Bashkimit Evropian për zhvillimin ekonomik. (Zeri, Kosova Sot, Telegrafi, 27 shkurt, 2015)



HAMZA: RITJA EKONOMIKE 4%

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Bedri Hamza, ka deklaruar se, pavarësisht zhvillimeve negative, në shumë vende të Evropës dhe më gjerë, Kosova e ka ruajtur stabilitetin financiar dhe bankar në vend. Hamza në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se që nga paslufta, Kosova ka pasur rritje ekonomike dhe kjo ka bërë që edhe sistemi bankar në vend të zhvillohet. Sipas tij, investimet, qoftë publike apo edhe private, kanë ndikuar të rritet edhe numri i bankave në Kosovë. Sa i përket rritjes ekonomike për vitin 2015, guvernatori Hamza ka bërë me dije se, sipas parametrave që i ka BQK-ja, Kosova do të ketë rritje ekonomike rreth katër për qind, e që është rritja më e madhe ekonomike në vendet e rajonit. (Epoka e Re, 11 shkurt 2015).

KU DO TË INVESTOHEN RRETH 115 MILIONË EUROT E OJQ-VE MIKROFINANCIARE?

Aktiviteti i OJQ-ve mikrofinanciare pa bazë ligjore duket se iu ka ardhur fundi. Kjo pasi komisioni parlamentar për buxhet dhe financa është i vendosur që deri në muajin korrik të hartoj ligjin mbi veprimtaritë e tyre. Problemi kryesor i ligjvënësve duket të jetë shpërndarja e kapitalit të tyre dhe titullari i aksionarëve, pasi këto OJQ me ligj kanë pasur statutin e donatorëve, mirëpo kanë ushtruar veprimtari bankare në dhënien e kredive me norma të kamatave deri në 28 %. (Telegrafi, 12 shkurt 2015).



TREGTIA, AKTIVITETI MË I PREFERUAR

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Repertorin Statistikor mbi Ndërmarrjet në Kosovë, TM4 2014", mbi bizneset e reja të regjistruara në Agjencionin për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë (ARBK). Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014 (TM4 - 2014) gjithsej janë regjistruar 2175 ndërmarrje, ndërsa në tremujorin paraprak (TM3 - 2014) kanë qenë 1919 sosh, që vërehet rritje në mes tremujorëve të të njëjtit vit për 256 ndërmarrje, e që shprehur në përqindje kemi për 13.3% më shumë ndërmarrje të reja në këtë tremujor. Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: tregtia me 648 ndërmarrje të reja (29.8%); akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 222 ndërmarrje (10.2%); prodhim me 216 ndërmarrje (9.9%); bujqësi, pylltari dhe peshkatarë me 168 ndërmarrje (7.7%); ndërtimtaria me 166 ndërmarrje (7.6%); aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, me 148 ndërmarrje (6.8%); transport dhe ruajtje me 143 ndërmarrje (6.5%); aktivitete të shërbimeve të tjera me 120 ndërmarrje (5.5%); informacion dhe komunikim me 80 ndërmarrje (3.7%); ndërsa, aktivitetet e tjera marrin pjesë në shkallë shumë të vogël. (Zeri, 6 shkurt 2015).



TURQIA KËRKON PËRMIRËSIMIN E AMBIENTIT TË BIZNESIT

Kosova duhet ta përmirësojë edhe më tej ambientin biznesor në mënyrë që të tërheqë investitorë të jashtëm. Sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja Kosova nuk qëndron mirë, kjo për faktin se investitorët kapitalin e tyre e bartin aty ku vendet u ofrojnë lehtësira në biznes. Këto shqetësime u diskutuan gjatë takimit të anëtarëve të Odës tregtare kosovaro-turke (OTKT) me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, të cilët diskutuan për klimën biznesore në vend. Gjithashtu u trajtuan temat e ndryshimeve të fundit në Kosovë, ikjet ilegale në Evropë, reformat e parapara nga Qeveria e Kosovës, sektorët që kanë potencial për investim në Kosovë, si dhe ambientet e investimeve dhe bashkëpunimeve. (Kosova Sot, 5 shkurt 2015).



DALIN MONEDHAT E REJA 1 DHE 2 EURO

Që nga dita e djeshme në Spanjë kanë dalë monedhat e reja prej 1 dhe 2 euro, me fytyrën e mbretit Felipe VI, të cilat gradualisht do të zëvendësojnë monedhat e mëparshme me imazhin e babait të tij, Juan Carlos. Në një komunikatë të shpërndarë sot Ministria e Ekonomisë në Spanjë, informoi se është parashikuar nxjerrja në qarkullim e katër milionë monedhave në vit. Monedhat e reja do të zëvendësojnë të vjetrat gradualisht. Ndryshimi i fytyrës së monarkisë i përket vetëm pamjes në njërën anë, pasi në anën tjetër monedha do të ketë të shkruar vlerën prej 1 ose 2 euro. (Zeri, Telegrafi, 5 shkurt 2015).



E MBAJNË FRANGUN NË MINIMUM



Banka Nazionale e Zvicrës duket se pas vendimit për heqjen e fiksuar të kursit të këmbimit të frangut kundrejt euros vendosi të mbajë normën minimale të këmbimit ndaj euros, që do t'i kushtojë shtetit. Shkrimi i gazetës zvicerane "Schweiz am Sonntag", që citon një burim të paidentifikuar në Bankën Nazionale të Zvicrës, pretendon të jetë minimum midis 1.05 - 1.10 franga". Objektivi i cili nuk është bërë publik, do t'i kushtojë Bankës Nazionale të Zvicrës 10 miliard franga. (Zeri, 4 shkurt 2015).

BE PARASHIKON RITJE EKONOMIKE PREJ 1.3 PËR QIND NË 2015

Bashkimi European ka publikuar raportin e fundit për situatën ekonomike, duke parashikuar një rritje modeste të saj në 19 vendet e eurozonës, pavarësisht rënies së kohëve të fundit të çmimit të naftës dhe euros. Zyrtarët ekonomikë të BE-së parashikojnë që këtë vit rritja ekonomike e eurozonës do të jetë 1.3%, duke shënuar një rritje prej 1.1% nga vlerësimi i nëntorit të kaluar. Në të njejtën kohë, parashikimi për 28 vendet anëtare të BE-së vlerëson rritjen e parë ekonomike prej 1.7% pas 8 vjetësh, të ndërthurur me ekspansion. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 6 shkurt 2015).



LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN MARS 2015

SEKTORI BANKAR KA SHËNUAR PËRMIRËSIME TË DUKSHME



Delegacioni i Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Kosovë, të premtën është takuar me zyrtarë të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) të cilët po vizitojnë Kosovën këto ditë. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka deklaruar se në këtë takim u diskutuan arritjet e sektorit bankar në Kosovë dhe mundësitë e mëtutjeshme për përmirësime.

Gjithashtu u identifikuan dhe diskutuan se cilat janë përmirësimet që duhet bërë për të përmirësuar mjedisin për të bërë biznes në Kosovë me theks të veçantë në zbatimin e kontratave si një fushë që ka ngecur dukshëm në Kosovë dhe që është jetike si për bankat dhe bizneset tjera që operojnë në Kosovë, ashtu edhe për investime të huaja direkte. Për më shumë, sektori bankar ka shënuar përmirësime të dukshme si në normat e interesit për kredi ashtu edhe në mbajtjen e kredive jo performuese në nivele më të ultat në rajon.

Kjo tregon një stabilitet të mirë të industrisë bankare në Kosovë dhe siguri për depozitorët, shtoi në fund zt. Balija. Fondi Monetar Ndërkombëtar në këtë takim u përfaqësua nga përfaqësuesi rezident i FMN-së për Kosovë, zt. Frank Lakwijk, zt. Giuseppe Cipollone ekonomist i lartë i Departamentit Evropian, zt. Jason Weiss ekonomist – Departamenti Evropian, znj. Aleksandra Zdzienicka, ekonomiste, Departamenti për Strategji, Politika dhe Rishikim, zt. Florian Misch, ekonomist Departamenti i Çështjeve Fiskale, zt. Selim Thaçi, ekonomist, zyra e përfaqësuesit rezident në Kosovë dhe zt. Jacques Miniane, shef i misionit të FMN-së për Kosovë, Departamenti Evropian.

Në këtë takim ishin prezent edhe të gjithë kryeshefët ekzekutiv të bankave komerciale që operojnë në Kosovë, anëtarë të SHBK-së. (Agjencia e lajmeve Ekonomie, Kosova live, 23 mars, 2015).

INTERVISTE ME SHBK PËR JAVËN NDËRKOMBËTARE TË PARASË



RTK: Përshendetje dhe mire se erdhët në programin e mëngjesit z. Balija

Petrit Balija, SHBK: Përshendetje, përshendetje për të gjithë shikuesit e Radio Televizionit të Kosovës, faleminderit për ftesën

RTK: Do të flasim për Javën Ndërkombëtare të Parasë, një javë e cila shënohet në gjithë botën dhe ka filluar të zhvillohet edhe në vendin tonë që nga viti I kaluar. Fillimisht do të flasim se si është manifestuar vitin e kaluar, çfarë aktivitete ka pasur, dhe do të kalojmë pastaj për këtë vit çfarë keni menduar.

Petrit Balija, SHBK: Kjo javë shënohet në mbi 180 vende në botë dhe ne si Kosovë jemi anëtarësuar vitin e kaluar në Organizatën Ndërkombëtare për Edukimin Financiar të të rinjëve, dhe vitin e kaluar në bashkëpunim me Bankën Qëndrore të Kosovës kemi organizuar një event me ciklin e ulët të nxënësve ku temë kryesore kanë qenë kursimet, kurse këtë vit Banka Qëndrore ka vazhduar me eventin e ngjashëm kanë pasur për qëllim cilin e ulët të një shkollë këtu në Prishtinë dhe janë informuar studentët, nxënësit në fakt, se cilat janë parimet themelore për kursime, janë shpërndarë disa arka të kursimeve dhe është mbajtur një ligjeratë nga guvernatori i Bankës Qëndrore.

RTK: Sa dimë ne për kursimet, sa jemi kursimtar ne si popull?

Petrit Balija, SHBK: Ne si popull, si traditë, si kulturë besoj që kemi një kulturë të mirë të kursimeve kjo dëshmohet edhe me nivelin e lartë të depozitave që i kemi në industrinë bankare, kemi diku 2.5 miliardë euro të depozituara në bankat komerciale në Kosovë dhe duke pasur parasysh numrin mjaft të ulet të

klientëve, pasi që jemi një vend i vogël besoj që ky është një nivel i lartë i depozitave që dëshmon që Kosovaret janë duke kursyer mjaft mirë.

RTK: Ne jemi mësuar të kursejmë disa para për dite të vështira, por tani kush janë kursimtarët më të mëdhenj, dihet që standardi i jetës në Kosovë nuk na lejon të kursejmë edhe aq prej të ardhurave mujore!

Petrit Balija, SHBK: Në sistemin bankar kemi kursime nga ekonomitë familjare por edhe nga bizneset diku 70% të depozitave vijnë nga ekonomitë familjare që do të thotë se ekonomitë familjare janë duke financuar në njëfar forme bizneset e Kosovës.

RTK: Do të flasim pak edhe për aktivitetet që përmendet që është edukimi financiar i klientëve bankar të Kosovës, një aktivitet, një projekt që do të zgjasë pak më gjatë dhe do të ketë aktivitete të shumta.

Petrit Balija, SHBK: Shoqata e Bankave të Kosovës ka nënshkruar një marrëveshje tash së fundmi me grupin e Bankës Botërore për një projekt dy vjeçarë ku do të përfshihet një numër mjaft i madh mjaft i konsiderueshëm i klientëve bankar dhe si temë kryesore në këto seminare do të jetë edukimi financiar në lidhje me kursimet, në lidhje me menaxhimin e kredive, menaxhimin e financave personale në jetën e përditshme dhe kemi për synim që të ulim sa më shumë asimetrinë e informacionit që mund të egzistojë në mes të institucioneve financiare dhe klientëve financiarë.

RTK: Pra projekti ka filluar tani?

Petrit Balija, SHBK: Projekti veq ka filluar kemi bërë përgaditjet e para ku janë përgaditë trajnerët për të filluar me seminare. Ky projekt financohet nga bankat komerciale të Kosovës dhe implementohet nga IFC-ja e Bankës Botërore dhe Shoqata e Bankave është si partner implementues gjatë tërë kohës.

RTK: Pra do të zgjasë dy vite dhe me siguri që kohë pas kohe do të ketë aktivitete në kuadër të këtij projekti.

Petrit Balija, SHBK: Do të ketë seminare në të gjitha qendrat e Kosovës me segmente të caktuara të klientëve që ne mendojmë që kanë nevojë më shumë për informacion, këtu si target kryesorë janë edhe studentët të cilët sapo kanë filluar raportet e tyre me institucionet financiare ndoshta e kanë hap një llogari të kursimeve apo një llogari rrjedhëse por nuk i njohin shumë produktet dhe mundësitë dhe kështu që është me rëndësi që të njoftohen qysh

në fillim me terminologjinë financiare me parimet se si të menaxhohen financat personale si të krijohen shprehitë e kursimeve e kështu me radhë. Në këtë projekt ne do të mundohemi të tregojmë edhe për edukimin financiar qysh në moshë të re që si prind të ri këto grup moshë do të mund të fillojnë të edukojnë edhe fëmijët e tyre qysh në ciklin parashkollor se sa është e rëndësishme të kursejmë, sepse dihet që në Kosovë ka ekonomi familjare që ndoshta për shkak të kushteve nuk kanë mundësi të fillojnë me kursime monetare megjithatë parimet bazë për kursime mund të mësohen edhe në qështje tjera si për shembull kursimi i energjisë elektrike, kursimi i ujit të pijshëm, kursimi i shpenzimeve në telefoninë mobile e kështu me radhë, pra parimet e kursimeve mund të instalohen qysh në moshë të re edhe në aspektet tjera e jo vetëm në aspektin monetar. Por mendohet që është më mirë që edhe fëmiju të kuptojë vlerën e parasë, të kuptojë se si fitohet paraja dhe si kursehet paraja dhe si mund të përgatitemi për projektet të cilat dëshirojmë ti financojmë në të ardhmen qoftë në shkollimin e mëtutjeshëm të këtyre fëmijëve ose në ndonjë projekt personal që mund të kemi si ekonomi familjare.

RTK: Pra nuk është me rëndësi se çfarë shume mund ta kursesh është me rëndësi që të fillohet me pak?

Petrit Balija, SHBK: Pikërisht këtu është esenca që shumë persona ose individë, shumë nga ne ankojemi që nuk mund të kursejmë sepse i kemi të ardhurat e ulëta megjithatë konsideroj që nuk është gjithmone niveli i të ardhurave që përcakton se a kurseni apo jo , sepse ka edhe individë të cilët kanë të ardhura mjaft të larta, por megjithatë shpenzojnë më shumë se sa që kanë të ardhura, kështu duke krijuar një bilanc negativë në fund të muajit çdo herë, dhe çdo herë kur ata i rrisin të ardhurat i rrisin edhe shpenzimet dhe në këtë formë nuk arrijnë të kursejnë, prandaj është me rëndësi që parimet të egzistojnë dhe pastaj kursimi të jetë në proporcion me të ardhurat që i gjenerojmë.

RTK: Ka ankesa vazhdimisht për normat e ulëta të depozitave, pse ndodh kjo apo si ndikojnë në përgjithësi në gjithë procesin?

Petrit Balija, SHBK: Deri në vitin 2013 mundem të them, Kosova ka pasur normat ndoshta më të lartat në rajon për kursimet , pra normat e interest në depozita por si rezultat i ndryshimeve në bilancet e bankave komerciale ku është krijuar një akumulim i depozitave dhe një likuiditet i tepërt ka ardhur deri te rënia e normave të interesit për depozita. Sektori bankar i Kosovës është mjaft i izoluar nga ndikimet e jashtme megjithatë nëse shikojmë jashtë

Kosovës, jashtë kufijve të Kosovës i shohim trendet e ngjashme si p.sh në Gjermani për të deponuar mjete në një bankë, në shumë banka duhet që ti paguajmë para bankës për t'i ruajtur ato atje, do me thënë ka raste kur norma e interesit të depozitave është negative, duhet të paguajmë 25 cent për çdo euro që e deponojmë në disa banka sepse kanë likuiditet të tepërt. Është e ngjashme këtu në Kosovë ku bankat kanë një likuiditet më të madhë se sa që dëshirohet dhe për këtë arsye i kanë politikatat të cilat nuk janë të orientuara drejt rritjes së depozitave.

RTK: Pastaj kemi një rritje të nivelit të depozitave këto viteve të fundit, si erdhi deri te kjo?

Petrit Balijs, SHBK: Po mendoj që prap çdo herë kur konsumatorët hezitojnë të investojnë ata orientohen në kursime dhe në depozita dhe si rezultat i krizës që ndodhi, që e përfshiu edhe Kosoven nga viti 2008 mendoj që qytetarët kanë hezitu t'i investojnë ato para dhe iu janë drejtuar bankave duke deponu mjete më shumë sesa në vitet e mëhershme, kështu që ky akumulim i depozitave ka rezultu me një nivel mjaft të lartë të depozitave e që nuk është edhe negative sepse është mirë që të kemi depozita të mjaftueshme dhe qytetarët të kenë kursime të mjaftueshme, por në anen tjetër mendojmë që është mirë edhe të investohet d.m.th të mendojmë që një pjesë të kursehet kurse një pjesë tjetër të investohet në mënyrë që të mos akumulojmë depozita dhe mos të kemi investime në vend, sepse dihet që rritja ekonomike e vendit bazohet në atë se sa konsumojmë dhe sa investojmë mjetet tona.

RTK: z. Balijs, sa janë të sigurta këto kursime?

Petrit Balijs, SHBK: Kjo është pyetje e mirë sepse, siguria e mjeteve është mbi të gjitha, ky është parim edhe për Bankën Qëndrore të Kosovës por edhe për bankat komerciale të Kosovës që siguria e depozitorëve të jetë në nivelin më të lartë, për momentin mund të them me plotë konfidencë,

me plotë përgjegjësi që sistemi bankar i Kosovës është ndër sistemet më të sigurta në rajon dhe më gjerë, kjo konfirmohet edhe nga komentet që vijnë nga Banka Qëndrore Evropiane nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe nga vetë Banka Qëndrore e Kosovës e cila e vlerëson si një sistem mjaft të sigurt dhe stabil.

RTK: Pra, kjo ja vlen që paratë mos të mbahen në shtëpi, të ruhen në vende brenda shtëpisë, por të dërgohen në bankë aty ku është vendi i sigurtë?

Petrit Balijs, SHBK: Mendoj se ruajta e parasë në shtëpi vjen ndoshta nga, na ka mbetë nga kohët e mëhershme kur nuk kemi pas banka tona komerciale, dhe jemi frikësuar që ti dërgojmë paratë në bankat shtetërore të atëhershme, sepse edhe ka pas potencial për ti humb, mirëpo tani që kemi sistemin tonë bankar nuk kemi asnjë arsye që ti ruajm parat në shtëpi, është një pozicion i rrezikshëm për kursime sepse shohim shpesh herë që shtëpitë ose ju ndodh ndonjë fatkeqësi të djegies, të zjarrit, vërshimeve ose ndonjë vjedhje ose diçka të tillë, që sigurisht që ato mjete nuk janë të sigurta aty, ndërsa në sistemin bankar mjetet janë 100 përqind të sigurta, dhe pa marr parasysh çfarë ndodh, gjithmonë do të kenë qasje në ato mjete.

RTK: z. Balijs une të falenderoj për kohën që ofruat për ne dhe për shikuesit, faleminderit edhe për këto këshilla që i japëm aty këtu brenda bisedës dhe suksese me aktivitetet.

Petrit Balijs, SHBK: Faleminderit shumë!

(Intervista në Radio Televizionin e Kosovës <http://www.rtklive.com/?id=27&r=24136> , 16 mars 2015)

BQK SHËNOI JAVËN NDËRKOMBËTARE TË PARASË



Edhe në Kosovë u shënuar "Java Ndërkombëtare e Parasë", aktivitet i cili shënohet në gjithë botën. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, si pjesë e Organizatës Ndërkombëtare për Fëmijë dhe të Rinjë dhe në kuadër të aktiviteteve të saja edukativo-financiare shënoi fillimin e kësaj jave me fëmijët e ciklit të ulët, përkatësisht, shkollës fillore "Ismail Qemali" në Prishtinë. I pranishëm në këtë ngjarje ishte edhe Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Bedri Hamza I cili iu drejtua fëmijëve me një fjalë rasti, ku mesazhi kryesor ishte përdorimi i drejtë i parasë. (Indeksonline, 13 mars, 2015).

'ZIRAAT BANK' SË SHPEJTI DO TË HAPET NË KOSOVË



Një bankë e re komerciale së shpejti do të hapet në Kosovë. Banka turke 'Ziraat Bank' tashmë është duke i bërë përgatitjet e fundit për t'ia filluar punës në Prishtinë. Tregut bankar në Kosovë po i shtohet edhe një bankë e re komerciale. Edhe pse zyrtarët e kësaj banke nuk pranuan të flasin për media, mësojmë se 'Ziraat Bank' tashmë e ka gjetur objektin në Prishtinë dhe është duke i bërë përgatitjet e fundit për t'ia filluar punës, transmeton RTK.

'Ziraat Bank' pas Prishtinës, do të hap një degë edhe në Prizren. Por, hapja e një banke të re, nuk ka nënkuptuar deri tash ulje të kamatave, tha për Radio Kosovën, drejtori i Odës Amerikanë Arian Zeka. "Futja e lojtarëve të rinj në sistemin financiar në Kosovë, jo domosdoshmërisht ka rezultuar edhe në përmirësimin e ofertës, meqenëse problemi qëndron që zbatimi i kontratave nuk është në nivelin e duhur. Do të duhej që institucionet përkatëse, ministria e drejtësisë, institucionet e tjera përkatëse të punonin më tepër në rritjen e efikasitetit të gjyqësorit, që së paku ky arsytim të mos mund të ekzistonte." Ndërkaq, drejtori i organizatës "Konsumatori", Selatin Kaçaniku shpreson se banka e re do të ndikojë në uljen e kamatave: "Mund të them se jo vetëm që shpresojmë, por ne mendojmë se është obligim i çdo banke të re që hyn në tregun e Kosovës, që të dëshmojë praninë e saj me produkte të reja, me oferta të reja, në këtë kontekst ajo kryesorja që ne si klientë presim është që norma e kamatave të ulet..."

Ndryshe, Ziraat Bankasi që kuptimin në shqip e ka Banka e Agrikulturës, është njëra ndër tre bankat publike. (Zëri, Kosova Sot, 3 mars, 2015)

FORMOHET GRUPI PËR HARTIMIN E FONDIT PËR INVESTIM DHE PUNËSIM

Qeveria e Republikës së Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Isa Mustafa, ka zhvilluar mbledhjen e saj të rregullt dhe ka miratuar politika dhe vendime të përgjegjësive të saj kushtetuese dhe ligjore. Në vazhdim të mbledhjes, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për themelimin e Grupit Punues për Hartimin e Koncept Dokumentit për Themelimin e Fondit për Investim dhe Punësim (Fondi Zhvillimor). Grupi Punues mund të ftoj edhe përfaqësues nga institucione tjera të Republikës së Kosovës dhe nga sektori i biznesit të cilët mund të kontribuojnë në këtë çështje. (Agjencia e lajmeve Ekonomia, 5 mars 2015).

TELEGRAFI: SEKTORI FINANCIAR NË KOSOVË KA PERFORMUAR STABIL. A DO TË MUND TË PRESIM ULJE TË KAMATAVE PËR KREDI?



Hoti: Kamatat për kredi kanë filluar të ulen. Për herë të parë këtë janar kemi parë norma njëshifrore të interesit për kredi. Nëse kredia merret me një plan biznesi të mirë edhe në sektorët që janë në zhvillim e sipër në tregun kosovar, interesi është deri në 6 apo 7 për qind, varësisht prej kolateralit që ofrohet për atë kredi. Ne jemi duke punuar në themelimin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive me ndihmën e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Ky fond do të ofrojë mbështetje për kreditë e marra nga bizneset. Kjo do të bëjë që normat e interesit të ulen më tutje. Si në çdo vend tjetër, bankat janë biznese që maksimizojnë fitimin. Por, tregu po zhvillohet vazhdimisht dhe unë pres që bankat të reflektojnë në këtë drejtim. Ajo për të cilën ne kemi nevojë është sigurimi i efikasitetit institucional në të gjitha nivelet e qeverisjes. Vetëm kështu bankat mund të jenë të sigurta në kreditë që lëshojnë, duke ulur kështu riskun financiar të kredive nga këndvështrimi i bankës. (Telegrafi, 10 mars, 2015).

TEB VAZHDON TË DIZAJNOJË DHE KRIJOJË MUNDËSI TË REJA PËR FEMRAT



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Banka TEB, me rastin e nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit me Gratë për Gratë International dhe Dhomën Ekonomike të Grave të Kosovës, organizoi një konferencë për media në Prishtinë. Në kuadër të programit të grave ndërmarrëse, banka TEB vazhdon të dizajnojë dhe krijojë mundësi të reja për femrat ambicioze dhe me vizion të qartë për të ardhmen e tyre dhe të shoqërisë. Prandaj, kjo iniciativë e palëve të lartpërmendura u prit shumë mirë nga shtresa e jofavorizuar e shoqërisë dhe pritet të ketë efekt edhe më të madh në nxitjen dhe përmbushjen e synimeve të grave ndërmarrëse. (Zëri, 11 mars, 2015)

JANË MBAJTUR TRAJNIMET NË KUADËR TË PROJEKTIT PËR EDUKIM FINANCIAR TË KLIENTËVE BANKAR



Më 23 – 17 Shkurt u mbajtën trajnimet e planifikuara në kuadër të projektit për Edukim Financiar të Klientëve Bankar, projekt i cili është iniciuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) dhe do të zbatohet në bashkëpunim me Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC, pjesë e Bankës Botërore). Zyrtarët përkatës të anëtarëve të SHBK-së kaluan trajnimet me sukses dhe u certifikuan në dy fusha.

Trajnimi i parë zgjati 2 ditë dhe i certifikoi trajnerët nga bankat anëtare në temën Trajnimi i Trajnerëve, të cilët pastaj do të mbajnë trajnime dhe punëtori të ndryshme për klientët e tyre, në

temat Menaxhimi i Financave Personale (Familjare), Kursimet, dhe Huamarrje e Mençur. Projekti parasheh që, brenda dy viteve të ardhshme, të trajnohen së paku 3000 klientë të bankave dhe individë tjerë të interesuar.

Trajnimi i dytë, Trajnimi i Këshilltarëve, zgjati 3 ditë dhe kishte për qëllim certifikimin e pjesëmarrësve që të trajnojnë stafin e tyre të brendshëm në shërbim të klientëve për të komunikuar në mënyrën e duhur me klientë të ndryshëm, në mënyrë që të kuptojnë kushtet e parapara të kontratave dhe të kuptojnë se si funksionojnë marrëdhëniet e tyre me bankën.

Projekti në fjalë ka edhe aktivitete tjera gjatë dy viteve të ardhshme, ku përfshihen fushata në medime të ndryshme dhe aktivitete për ngritjen e vetëdijes lidhur me shërbimet bankare.



LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN PRILL 2015

SË SHPEJTI SKEMA E GARANTIMIT TË KREDIVE



Panairi i përgjithshëm ndërkombëtar “Prishtina 2015”, është hapur të martën në fshatin Bërnice të Prishtinës. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu ka thënë se panairi ndërkombëtar po organizohet për herën e 15 në Kosovë dhe numri i pjesëmarrësve në të është i madh. Ndërsa, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Hikmete Bajrami tha se qëllimi i këtij panairi është që të krijoj lidhje mes bizneseve të vendeve të ndryshme dhe se Qeveria do të vazhdoi mbështetjen për bizneset. Së shpejti do të funksionalizohet edhe skema e garantimit të kredive, si dhe do të ndryshohen disa ligje ne te mire te biznesit theksoi ministria Hykmete Bajrami. (Zeri, 30 prill 2015)

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS TAKOHET ME BQK PËR IMPLEMENTIMIN E STANDARDEVE TË BAZEL-IT

Sot, më datë 3 prill, Shoqata e Bankave të Kosovës e përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv z. Petrit Balijs dhe kryetari i Komitetit Ligjor z. Agron Krasniqi, pritën në një takim pune ekipin e projektit për implementimin e standardeve të Bazel-it, i kryesuar nga z. Ralf Raab, këshilltar i lartë pranë departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK. Ky takim kishte për qëllim prezantimin e projektit të Implementimit të standardeve të Bazel, i cili veçse është në proces, si dhe të krijoj marrëdhënie bashkëpunimi mes SHBK, z. Raab dhe ekipit të tij i cili përfshin stafin nga BQK dhe konsulent të jashtëm.



Gjatë takimit u prezantuan objektivat e projektit për implementimin e standardeve të Bazel-it dhe format e bashkëpunimit me SHBK. Për këtë takim drejtori ekzekutiv i SHBK-së z. Balijs tha ‘Ky projekt ka një vlerë të veçantë për industrinë bankare në Kosovë pasi që paraqet përbushje të kriterëve ndërkombëtare për funksionimin më të mirë të sistemit bankar dhe integriteteve të mëtutjeshme në arenën ndërkombëtare financiare. Ky projekt është duke u mbështetur nga organizata gjermane GIZ. (Botapress, 3 prill 2015)

RRITJA EKONOMIKE 4.4%



Ministri i Ekonomisë së Kosovës, Avdullah Hoti ka bërë të ditur se në Qeverinë e Republikës së Kosovës u aprovua Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) për periudhën 2016 – 2018. Sipas tij, ajo vendos kufijtë buxhetor dhe kufijtë e të hyrave për këtë periudhë. “Është e rëndësishme së veçantë pasi pothuajse plotësisht i akomodon objektivat që i ka kjo Qeveri për 3 vitet e ardhshme të prezantuara në programin qeverisës, që është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës”, tha ministri i Financave Avdullah Hoti, në konferencën për media, pas mbledhjes së rregullt të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Sipas ministrit Avdullah Hoti, rritja ekonomike në vend në bazë të KASH-it parashihet që të jetë më e lartë sesa 2-3 vitet e fundit, pritet që të arrijë diku në 4.4 % mesatarisht për 3 vitet e ardhshme me tendencë që kjo të rritet. (Zeri, 30 prill 2015)

KOSOVA ME PROGRAM TË RI ME FMN-NË



Institucionet e Kosovës gjatë takimeve pranverore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore të mbajtura në Uashington kanë arritur një marrëveshje në parim për një program të ri me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Këtë e kanë konfirmuar gjatë një konference për media ministri i Financave Avdullah Hoti dhe guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës Bedri Hamza. Ky program, sipas ministrit të Financave Avdullah Hoti do të hapë mundësitë për projekte zhvillimore në Kosovë. “Kosova ka stabilitet makro fiskal dhe nuk ka nevojë për program më Fondin Monetar Ndërkombëtar për të ruajtur stabilitetin makro fiskal sepse ne e mbajmë vetë atë, por kemi nevojë për mbështetje të Fondit për të siguruar një kredibilitet të organizatat ndërkombëtare karshi financave publike, që ne të kemi mundësi që të hyjmë në kredi ndërkombëtare tek Banka Botërore dhe të organizatat tjera financiare ndërkombëtare që janë të gatshme të financojnë projektet e Qeverisë së Kosovës”, sqaron Hoti. (Telegrafi, 27 prill 2015)

DRAGHI: EUROZONA PO FITON VRULL TË RI



Shefi i Bankës Qendrore Evropiane tha të mërkurën se ekzistojnë “prova të qarta”, që programi i saj stimulues po e përmirëson ekonominë e vendeve të eurozonës. Presidenti i Bankës Mario Draghi tha se ekonomia e eurozonës “ka fituar një vrull të ri”, që nga fundi i vitit të kaluar dhe se ai pret që rimëkëmbja të “zgjerohet dhe forcohet ndjeshëm.” Banka është në fazat fillestare të blerjes së bonove me vlerë 1.1 miliard dollarë për të rritur aktivitetin e biznesit evropian dhe për të ulur papunësinë që arrin në 11,3 për qind. (Zeri i Amerikës, 16 prill 2015)

BANKAT ‘DORËSHTRËNGUAR’



Mekanizmat financiarë ndërkombëtarë dhe ekspertët e çështjeve ekonomike, iu bëjnë thirrje bankave komerciale që operojnë në Kosovë që të rrisin qasjen në financa. Sipas tyre, derisa këto banka janë mirë të kapitalizuara dhe të mbikëqyrura, duhet të lehtësojnë kushtet në dhënien e kredive. Fondi Monetar Ndërkombëtar, gjatë vizitës dy javore që i kishte bërë Kosovës kishte theksuar se “bankat komerciale në Kosovë janë të shëndosha dhe të mbikëqyrura mirë, por duhet që të bëhen në përgjithësi më shumë përpjekje për ta rritur qasjen në financa”. Milazim Abazi, ekspert për çështje financiare, në një prononcim për Radion Evropa e Lirë i quan të ashpëra kriteret e bankave për dhënien e kredive dhe mbi të gjitha sipas tij, normat e interesit janë të larta. Normat efektive të interesit për kredi, sipas raporteve të Bankës Qendrore të Kosovës, fillojnë nga 10.8 për qind, por kjo varet nga banka dhe lloji i kredisë. Në anën tjetër, Petrit Balijs, drejtor i Shoqatës së Bankave të Kosovës, për Radion Evropa e Lirë, thekson se bankat komerciale kanë pasur rritje të kreditimit gjatë vitit 2014. “Kjo është një shenjë e mirë që ka kreditim më të madh. Edhe bankat do të donin të ketë kreditim edhe më të madh, pasi që edhe likuiditeti është mjaft i lartë, por kjo varet nga kërkesat e bizneseve, sa do të ketë zhvillim ekonomik në vitin 2015 dhe a do të ketë rritje të kërkesës së bizneseve për kredi drejtë bankave”, shton Balijs. (Telegrafi, 3 prill, 2015)

BERZH: KORRUPSIONI NJË NGA PROBLEMET KRYESORE E TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË



Gara nga ekonomia informale, problemet me furnizim me energji elektrike dhe praktikat korruptive janë identifikuar tri pengesat kryesore për të bërë biznes në Kosovë sipas një analize të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, (BERZH). Lajmi është bërë i ditur nga BERZH-i të enjten ku thuhet më një komunikatë për media se ekonomia informale është përmendur nga pronarët e bizneseve në Kosovë si sfida kryesore, duke u llogaritur si 66 për qind e problemit të të bërit biznes. Kjo shifër është më e larta në 30 shtete ku është bërë hulumtimi në fjalë. BERZH ka njoftuar se kjo është hera e pestë që së bashku me Bankën Botërore e kanë realizuar hulumtimin e quajtur “Ambienti i Biznesit dhe Afarizmi i Ndërmarrjeve” për vitet 2013 dhe 2014. (Zeri, Kosova Sot, 10 prill, 2015)

SHOQATA E BANKAVE REAGON PAS AKSIONIT TË VETËVENDOSJES

Shoqata e Bankave të Kosovës (ShBK) ka reaguar sot ndaj aksionit të djeshëm të aktivistëve të Vetëvendosje kundër kamatave të larta të bankave në Kosovë.

SHBK thekson se ‘liria e shprehjes është shumë e rëndësishme për zhvillimin e debatit dhe demokracisë në një vend dhe ne e respektojmë këtë parim, megjithatë, është mirë që ankesat apo pakënaqësitë të shprehen në mënyrë institucionale dhe në adresat e duhura ku pastaj mund të trajtohen dhe të kthehet përgjigja në lidhje me ankesat specifike. Bankat komerciale në Kosovë i kanë departamentet e tyre për ankesa dhe po ashtu ekziston departamenti për mbrojtjen e konsumatorit edhe ne Bankën Qendrore të Kosovës por edhe në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ku mund të adresohen çfarëdo shqetësimi apo ankese që mund të ketë ndonjë qytetar. Sa i përket pankartave të vendosura sot në bankat komerciale të Kosovës neve ende nuk kemi ndonjë konfirmim zyrtar se a janë të vendosura nga aktivistet e Vetëvendosjes siç është pohuar në media. Megjithatë, cilëndo organizatë që i takojnë këta aktivistë asnjëherë nuk e kanë marrë mundin që të na drejtohen për ndonjë takim apo diskutim ku ata mund ti adresojnë shqetësimet e tyre dhe ku mund të marrin informata më të sakta pasi që nga prononcimet e këtyre aktivisteve në media shihet se nuk i kanë informatat e sakta sepse citojnë se mesatarja e normës së interesit është 14% përderisa në realitet mesatarja është 9.3% e që është afër mesatares së rajonit.

Në të njëjtën kohë ata bëjnë krahasime me normat e interesit në vendet e BE duke ditur mirë se Kosova ende nuk ka përbushur kushtet për të bërë biznes si në vendet e BE-së dhe sigurisht që kjo reflekton edhe në normat e interesit, jo vetëm në Kosovë por në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi. Normat e interesit kanë shënuar përmirësim të vazhdueshëm në Kosovë duke pësuar rënje për 30% në 5 vitet e fundit dhe duke shënuar norma njëshifrore për here të parë në vitin 2014. Nëse vazhdohet me këtë trend ne do të kemi ofertë edhe më të mirë dhe kreditim edhe më të madh nga bankat komerciale të Kosovës në vitet në vijim.

‘Ne mbesim të hapur për të gjitha organizatat e interesuara për të marrë më shumë informata në këtë drejtim dhe për të diskutuar trendet aktuale dhe sfidat me të cilat ballafaqohet sektori financiar në Kosovë’ thuhet në fund të reagimit. (RTK Live, 8 Prill, 2015)

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN MAJ 2015

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS MERR PJESË NË TAKIMIN E KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI



Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) e përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv z. Petrit Balija mori pjesë në një takim të përbashkët të Komisionit parlamentar për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri dhe Komisionit parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, me pjesëmarrje të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Odave Ekonomike, për të diskutuar lidhur me kontestet biznesore dhe mos-efikasitetin e gjykatave në zgjidhjen e rasteve të tyre. SHBK me anë të një shkrese zyrtare drejtuar paraprakisht Komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri ka adresuar disa nga sfidat

me të cilat ballafaqohet industria bankare. Në lidhje me këtë takim, drejtori ekzekutiv i SHBK-së, z. Balija tha “Krahas shumë faktorëve të tjerë të riskut me të cilët ballafaqohet sistemi bankar në Kosovë, sistemi i drejtësisë paraqet një nga faktorët e rëndësishëm i cili e rritë ndjeshëm ambientin e riskut në të cilën vepron ky sektor. Sipas raportit për Të bërit biznes 2015, të Bankës Botërore, Kosova listohet në vendin 138 për zbatimin e kontratave nga gjithsej 189 vende në rang-listë dhe kjo duhet të ndryshojë në mënyrë që industria bankare mos të hasë në vështirësi në të ardhmen.” Komisionet parlamentare u zotuan se do të bëjnë gjithë çfarë është e mundur për të zgjedhur këto probleme në sistemin e drejtësisë të cilat janë identifikuar nga shoqatat e bizneseve dhe odat ekonomike. (Botapress, 6 maj 2015)

PUBLIKIMI PROMOVON EDUKIMIN FINANCIAR NË KOSOVË



Fondi Evropian për Evropë Juglindore për Lehtësim të Zhvillimit do të vazhdoj përkrahjen e tij për revistën “The Kosovo Banker” deri në fund të 2016. EFSE DF e ka përkrahur revistën “The Kosovo Banker” e cila është publikuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) që nga 2013, përmes asistencës financiare si dhe ka dhënë kontributin e saj redaktues në ndërlidhje me projektet e EFSE DF-së në Kosovë. Revista shërben si një mjet i rëndësishëm e cila ofron informata të besueshme mbi zhvillimet aktuale në industrinë bankare për publikun e gjerë në Kosovë. “The Kosovo Banker” publikohet dy herë në vit dhe shtypet në 10,000 kopje për edicion në gjuhën shqipe dhe angleze dhe e cila shpërndahet përmes postës elektronike dhe gazetës ditore lokale “Koha Ditore”. Aktualisht është revista e vetme e kësaj natyre në Kosovë. Përveç kësaj, EFSE DF do të siguroj fonde

për një vit për “Periodikun Bankar”, një pasqyrë mujore mbi indikatorët kryesorë të sektorit financiar e cila ka filluar të publikohet tash së fundmi nga SHBK. Çdo muaj, publikimi trajton çështje specifike të sistemit financiar që ka për fokus kryesor sektorin bankar në Kosovë. “Duke pasur parasysh se edukimi financiar bën pjesë të rëndësishme në kuadër të agjendës mbi Përgjegjësinë Financiare, ne e vlerësojmë shumë këtë bashkëpunim/partneritet”, theksoj Markus Aschendorf, Udhëheqës i Komitetit të EFSE DF-së. “SHBK është dëshmuar si një partner i rëndësishëm në përmirësimin e nivelit të edukimit financiar në Kosovë”. “Industria bankare në Kosovë është e prirur për të promovuar edukimin financiar ndërmjet konsumatorëve të saj si dhe me publikun e gjerë. Ky është projekti i parë i kësaj natyre dhe sigurisht se do të luaj një rol të rëndësishëm në përmirësimin e edukimit financiar në Kosovë. Shpresojmë se në të ardhmen do të ketë edhe projekte të tjera të ngjashme në të cilat ne do të mund të bashkëpunojmë me organizatat e tjera lokale dhe ndërkombëtare për ta shtyrë më përpara këtë kauzë”, shtoj Petrit Balija, Drejtor Ekzekutiv i SHBK-së. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 18 maj 2015)

PERFORMANCA DHE SFIDAT E SEKTORIT BANKAR U PREZANTUAN NË KONFERENCËN ‘AKTIVIZIMI I BURIMEVE TË RRRITJES EKONOMIKE NË KOSOVË’



Shoqata e Bankave të Kosovës e përfaqësuar nga kryetari i Bordit të drejtorëve z. Robert Wright mori pjesë në sesionin e parë të konferencës ‘Aktivizimi i Burimeve të Rritjes Ekonomike në Kosovë’. Sesioni i parë trajtonte temën ‘Investimi për rritje-Mjedisi biznesor dhe kufizimet e tij’, ku në mesin e panelistëve të cilët vinin nga institucione të ndryshme si Ministria e Financave, Banka Botërore, Institute dhe universitete të ndryshme, z. Wright dha një prezantim mbi performancën dhe sfidat e industrisë bankare në Kosovë. Ndër të tjera në prezentimin e tij z. Wright përmendi një ndër sfidat më të theksuara të sektorit bankar, por edhe të sektoreve tjera në Kosovë, e që është zbatimi i kontratave. Sipas vlerësimit të Bankës Botërore, Kosova radhitet në vendin e 138-të në raportin e të bërit biznes, sa i përket zbatimit të kontratave, duke qëndruar kështu dukshëm në pozitë më të dobët se vendet e rajonit, dhe duke pamundësuar zhvillime pozitive në ekonominë e Kosovës. Ndërsa, Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija vlerëson se është shumë pozitive që të mbështetën këto platforma të debatit dhe dialogut për zhvillim ekonomik pasi që në këtë formë mund të identifikohen sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të mëtutjeshëm ekonomik. Kjo konferencë është organizuar nga Instituti Riinvest me mbështetje të Shoqatës së Bankave të Kosovës si një ndër sponsorët kryesorë, me rastin e njëzet vjetorit të themelimit të këtij instituti. (Shoqata e Bankave të Kosovës, 18 maj 2015).

KRYETARI I PARLAMENTIT KRIJON ZYRE PËR BIZNESET NË KUVEND



Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli ka bërë të ditur se ka vendosur që t’i jap komunitetit të biznesit një zyrë në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që bizneset të kenë qasje më të mirë në hartimin dhe ndryshimin e ligjeve për ekonominë. Veseli e ka bërë këtë të ditur gjatë konferencës së organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës me temë “Dialogu dhe partneriteti me komunitetin e Biznesit në hartimin e Legjislacionit”. Veseli tha me këtë rast se këtë vendim po e merr me qëllim që të hartohen ligje sa më të mira të cilat do ta shtyjnë përpara zhvillimin ekonomik. “Kam marrë një vendim për krijimin e zyrës suaj në Kuvend në mënyrë që të keni qasje më të afërt me deputetët në hartimin e legjislacionit për ekonominë” ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se këtë vendim e ka marrë për dy arsye të rëndësishme që janë bërja e ligjeve sa më të mira për zhvillimin ekonomik përmes këshillave profesionale nga bizneset dhe për rritur mundësinë e shndërrimit të ideve inovative të ndërmarrësve në ligje sa më të mira për ekonominë. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Balija ka falenderuar kryetarin Veseli për mundësinë e dhënë për këtë takim, si dhe për hapjen e zyrës përfaqësuese të bizneseve. Ai ka shtuar se industria bankare ballafaqohet me probleme të ngjashme si bizneset e tjera në Kosovë, ku kontratat nuk gjejnë zbatim, ku informaliteti është i lartë dhe ku sistemi gjyqësor është i ngulfatur me lëndë të pazgjidhura. Përfaqësuesit e bizneseve të pranishme në këtë konferencë e vlerësuan si shumë të rëndësishëm vendimin e kryetarit Veseli duke thënë se kjo iniciativë është tepër e rëndësishme për zhvillimin e bizneseve dhe në përgjithësi të ekonomisë kosovare. (Zëri, Kosova Sot, 21 maj 2015).

DËNOHEN HAKERËT BULLGARË PËR VJEDHJE NË BANKOMATËT E PRISHTINËS



Dy shtetasit bullgarë Aleksandër Gradev dhe Bogdan Haxhiev të akuzuar për keqpërdorim të kartelave bankare në disa bankomatë në Prishtinë, Mitrovicë dhe Fushë-Kosovë u dënuan me burgim unik prej 2 vjetësh secili. Përveç këtij dënimi, ata u obliguan nga gjykata që në mënyrë proporcionale t'u kompensojnë dëmin prej 18 mijë, përkatësisht, 150 eurove dy bankave komerciale në Kosovë. Prokuroria Themelore në Prishtinë kundër këtyre dy shtetasve bullgarë ngriti aktakuzë më 12 mars 2015, duke i akuzuar se në mënyrë të paautorizuar gjatë muajit dhjetor të vitit 2014 deri më 21 janar 2015 kanë vendosur pajisje për kopjimin e të dhënave bankare të kartelave në disa bankomatë. Sipas prokurorisë, dy bullgarët krijuan

kartela false nga të dhënat e klientëve të kopjuara nëpër bankomatë, duke shkaktuar dëm prej 18 mijë eurosh. (Kallxo.com, 22 maj 2015).

BIEN NORMAT E INTERESIT



Normat e interesit të kredive kanë arritur nivelin më të ultë që nga periudha e pasluftës, mesatarisht janë 9.3 për qind. Por edhe normat e interesit në depozita kanë rënë ndjeshëm krahasuar me vitet paraprake. Drejtori i shoqatës së bankave, Petrit Balijs thotë se ky trend do të vazhdojë. Sektori bankar i Kosovës edhe më tej luan rol të rëndësishëm për ekonominë vendore. Kreditimi i cili kishte ngecur gjatë viteve 2013 dhe 2012, tashmë ka filluar të shënojë rritje. Vitin e kaluar kreditë arritën vlerën rreth 1.9 miliardë euro, me një ngritje prej 4.2 për qind në krahasim me vitin 2013. Në mënyrë të ngjashme depozitat shënuan një rritje prej 3.6 për qind, duke arritur vlerën prej 2.5 miliardë euro. Ndërkohë, ka vazhduar edhe rënia e interesit si të kredive, ashtu edhe të depozitave, thotë për radio Kosovën drejtori i shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balijs. “Në fund të vitit 2014 dhe fillim të vitit 2015 për herë të parë kemi vërejt normat njëshifrore të interesit në kredi, ku norma mesatare për kredi ka rënë nën 9.3 për qind. Njëkohësisht vërejmë edhe rënie të normës së interesit për depozita në një nivel më të ultë sesa më herët. Kjo është si rezultat i shtimit të likuiditetit më të lartë të bankave”, thotë ai. Balijs thotë se ky trend i rënies së interesave si në kredi po ashtu edhe në depozita do të vazhdojë. Nga ana tjetër, drejtori i Institutit GAP, Agron Demi vlerëson pozitivisht uljen e normave të interesit në kredi, por thekson se për disa kategori janë ende të larta. (Ekonomiksi, 12 maj 2015)

FONDI DO TË LEHTËSOJË QASJEN NË FINANCA PËR BIZNESET



Fondi për Investim dhe Punësim, pritet të përmirësojë qasjen në financa me kushte të volitshme për sipërmarrësit e rinj, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe korporatat. Kryeministri i Kosovës Isa Mustafa, gjatë një konference ditë më parë, ka paralajmëruar se ky fond, përveç tjerash, do t'iu ofrojë bizneseve fillestare qasje në financa, kredi më të lira për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe korporatat që synojnë t'i zgjerojnë bizneset e tyre. Bizneset në Kosovë, të cilat vazhdimisht janë ankuar për norma të larta të interesit dhe qasje të kufizuar në financa, thonë se kjo do të ndihmojë shumë zhvillimin e tyre dhe, njëkohësisht, zhvillimin ekonomik të vendit. Shuma e përgjithshme e kredive që qytetarët kanë në bankat komerciale ka arritur në 1.85 miliard euro, kreditë për ndërmarrje vazhdojnë të kenë përqindjen më të lartë, pasuar nga kreditë për ekonomitë familjare. Ekspertët e fushës së ekonomisë vazhdimisht iu kanë bërë thirrje autoriteteve kompetente që të shqyrtojnë mundësitë që bizneseve t'iu krijojnë qasje më të mirë në financa, derisa nga bankat komerciale kishin kërkuar uljen e interesit në kredi. (Radio Evropa e Lirë, 12 maj 2015)

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN QERSHOR 2015

BQK LICENCON BANKËN TURKE ZIRAAT



Njoftohet se Banka Ziraat ka marrë licencën e operimit për degën e saj në Prishtinë nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Në deklaratën e publikuar në Platformën për Informimin e Publikut të Bankës Ziraat është theksuar se banka ka marrë lejen e operimit me degën e Prishtinës nga Banka Qendrore e Kosovës. (Telegrafi, 2 qershor 2015)

NGA MBI 213 MIJË LËNDË TË VJETRA GJYQËSORE, 10.500 I TAKOJNË SEKTORIT BANKAR



Një proces i nisur nga viti i kaluar për lehtësimin e zgjidhjes së kontesteve që bankat kanë me klientët e tyre apo edhe anasjelltas, nuk po funksionon. Këshilli Gjyqësor ka emëruar një numër gjykatësish të rinj, por që zgjidhja e tërësishme e këtyre lëndëve nuk pritet të ndodhë as këtë vit, raporton KTV. Enver Peci ka thënë se me shtimin e gjykatësve dhe zgjidhjen e lëndëve me vlera të mëdha, do të ulej sadopak numri i madh i lëndëve të këtij sektori, mirëpo sërish nuk do të përfundonin. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e bankave po presin që këtë vit institucionet të marrin më seriozisht zgjidhjen e këtij problemi, transmeton Koha.net. Nga mbi 213 mijë lëndë të vjetra, 10.500 i takojnë sektorit bankar. (Koha.net, Kohavision, 3 qershor 2015).

7,9 % NORMA MESATARE E INTERESIT NË KREDI



Norma e interesit në kredi, por edhe në depozita, ka rënë dukshëm gjatë tremujorit të parë të këtij viti, në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Bazuar në të dhënat e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se në fund të muajit mars, norma e interesit në kredi ishte 8,9 për qind, e derisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar norma mesatare e interesit ishte 11,2 për qind. Gjatë kësaj periudhe kohore ka rënë dukshëm edhe norma e interesit në depozita nga 1,7 për qind në fund të marsit të vitit 2014 në 0,7 për qind në fund të marsit të këtij viti. Në raportin e fundit të BQK-së thuhet se rënia mund të jetë ndikuar nga presioni i konkurrencës bankare dhe zvogëlimit të kostos së financimit të aktivitetit bankar. Ndryshe, norma e interesit në kredi si për ndërmarrje po ashtu edhe për ekonomitë familjare, sipas të dhënave të BQK-së ka një rënie të vazhdueshme. Derisa në fund të vitit 2014 norma e interesit ka qenë 9.2 për qind, kjo normë në muajin prill ishte 8.3 për qind, ndërsa në muajin maj 7.9 për qind. Sidoqoftë, edhe kjo normë për ekspertët e ekonomisë vlerësohet të jetë e lartë. (Zëri, 10 qershor, Telegrafi 27 qershor 2015).

SHËRBIMET MODERNE BANKARE DHE INOVACIONET TEKNOLOGJIKE E PA-VARËSOJNË DHE E FUQIZOJNË KLIEN-TIN E BANKAVE (SHKRUAR NGA E. BIBOLLI, 18 QERSHOR 2015)



Jetojmë në shekullin e XXI-të, shekullin e progresit teknologjik dhe të novacionit. Sot është fakt që zhvillimet teknologjike i kanë dhënë një dimension tjetër mënyrës se si jetojmë, si informohemi, si komunikojmë dhe si e perceptojmë realitetin. Për gjenerata të tëra sot është e vështirë të imagjinohet jeta e përditshme dhe puna profesionale pa një mori pajisjesh elektronike. Në këtë kontekst, si çdo fushë tjetër, edhe sistemet financiare në mbarë botën kanë qenë subjekt i avancimeve teknologjike dhe kanë adaptuar me ritme të shpejta teknologjitë më bashkëkohore në fushën e komunikimit dhe të ofrimit të shërbimeve për klientë. Edhe sistemi bankar në Kosovë, nuk bën përjashtim nga kjo tendencë. Me konfidencë mund të thuhet që vitet e fundit ky sistem ka adaptuar teknologjitë më bashkëkohore, të krahasueshme me ato të vendeve të Evropës Perëndimore me intensitet dhe shpejtësi të admirueshme. (Koha Ditore, 18 qershor 2015).

RRITEN DEPOZITAT BANKARE



BQK, ka njoftuar se depozitat në sektorin bankar në mars 2015 arritën vlerën 2.57 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 5.9 për qind, por në vitin 2014, kishte rritje prej 7.1 për qind. “Faktori kryesor që mund të ketë ndikuar në ngadalësimin e rritjes së depozitave mund të jetë rënia e theksuar e normës së interesit në depozita që po karakterizon

sektorin bankar. Ndikim në ngadalësimin e rritjes së depozitave mund të ketë pasur edhe rritja e emigrimit nga Kosova në muajt e parë të vitit 2015. Struktura e depozitave në sektorin bankar vazhdon të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 74 për qind të gjithsej depozitave”, është thënë në raportin e Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për vlerësimin tremujor të ekonomisë. Sipas BQK-së, kategoria e dytë për nga pesha në strukturë është ajo e depozitave të ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 20.3 për qind në gjithsej depozitat. (Bota Sot, Zëri, 12 qershor 2015).

FONDI PËR GARANCI KREDITORE PËR 6 VJET, 20 MIJË TË PUNËSUAR



Ministria e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami pasi që u miratua themelimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në mbledhjen e Qeverisë, tha në një konferencë për media se me këtë Fond do të përmirësohet ambienti i biznesit. Bajrami po ashtu tha se me këtë Fond do të zvogëlohen barrierat e krijuara ndër vite për marrjen e kredive, dhe se brenda 6 viteve nga kreditë që do të përfitohen, krijohet mundësia për shtimin e 20 mijë vendeve të reja të punës. Sipas saj me këtë Fond do të ketë zbritje të kolateralit prej 50 për qind, për çka tha se shpreson në reflektimin e institucioneve bankare, të cilat pas kësaj ulje të rrezikut për 50 për qind të ulin edhe normat e interesit. Fondi fillimisht do të mbuloj 50 për qind të kolateralit, i cili në mënyrë automatike do e zbrit për 50 për qind të rrezikut për bankat dhe ne besojmë institucionet bankare dhe ato jo bankare dhe mikrofinanciare do të reflektojnë në uljen e këtij rreziku prej 50 për qind dhe sigurisht do të ulin edhe normat e interesit”, tha Bajrami. “Ky fond prej rreth 20 milionë eurove me kapital fillestar llogaritet që diku në gjashtë vitet e para do e rrisë mundësinë për kredi të reja rreth 360 milionë euro dhe pritet që nga këto 360 milionë hua të reja mund të krijohen deri në 20 mijë vende të reja të punës”, tha Bajrami. (Telegrafi, 18 qershor 2015).

KOSOVA PRITET TË KETË RRRITJE 3.5 PËR QIND



Sipas vlerësimeve të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), ekonomia e Kosovës, për këtë vit pritet të arrijë në 3.5 për qind. Ky përshejtim i rritjes ekonomike pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe investimet. Ndërsa për tre muajt e parë të këtij viti kishte një borxh publik 622.1 milion euro. Bazuar në publikimin e fundit të BQK-së në vlerësimin e tre mujorit të ekonomisë, investimet publike deri në mars të vitit 2015 kanë shënuar rënie prej 20.2 për qind, ndërkohë që investimet e huaja direkte (IHD) kanë shënuar rritje për 103.8 për qind. (Zëri, 18 qershor 2015).

FILLOI FUSHATA PËR EDUKIM FINANCIAR TË KLIENTËVE



Filloi fushata për edukim financiar e cila është realizuar në kuadër të Projektit për Edukim Financiar të klientëve bankar. Në kuadër të kësaj fushate janë publikuar videot vetëdijësuese në fushën e e-banking, huazimit të mençur dhe karakteristikave të produktit. Këto video kanë për qëllim të rrisin edukimin financiar të klientëve duke i bërë ata klient proaktiv të cilët janë të informuar mirë për financat personale, kuptojnë karakteristikat e produkteve bankare dhe rrjedhimisht bëjnë huazim të mençur.

Në lidhje me fillimin e kësaj fushate, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Baliqi tha “SHBK në kuadër të strategjisë së saj për edukim financiar, ka mbështetur projektin financiarisht, përderisa IFC, anëtare e grupit të Bankës Botërore, ka punuar së bashku me SHBK-në në realizimin e Projektit për Edukim Financiar, në mënyrë që të përmirësojë nivelin aktual të edukimit financiar të popullatës, posaçërisht duke targetuar klientët ekzistues dhe potencial të bankave në Kosovë”. Në mënyrë që klientët të kenë kuptim më të gjerë të financave personale, përveç fushatës vetëdijësuese, projekti për Edukim Financiar të Klientëve Bankar parasheh të ofrohen trajnime falas për klientët e bankave në këto fusha: Menaxhimi i financave personale, huazimi i mençur dhe kursimet.

Ky projekt ka gjetur përkrahje edhe nga bankat komerciale në vend, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, MasterCard dhe Visa. (Bota press, Kosovalive 360, InfoDirekt, Agjencia e lajmeve Ekonomia, Express, Blic, Lajmi.net, 24 qershor 2015).

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN KORRIK 2015

SHBK DHE IFC REALIZOJNË PROJEKT PËR EDUKIMIN FINANCIAR TË KLIENTËVE



Me një konferencë të organizuar sot nga Shoqata e Bankave të Kosovës dhe IFC-ja si pjesë e grupit të Bankës Botërore zyrtarisht u lansua projekti për edukim financiar të klientëve bankar. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të Bankës Botërore, IFC-së, Shoqatës së Bankave të Kosovës, përfaqësues të bankave anëtare si dhe pjesëmarrës të tjerë. Në fjalën e saj hyrëse znj. Syzana Dautaj falënderoi Shoqatën e Bankave të Kosovës për bashkëpunimin e shkëlqyer në këtë projekt. Ndërsa nga ana e Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Baliqi vlerësoi lartë këtë projekt dhe theksoi edhe një herë rëndësinë e edukimit financiar. Ndër të tjera ai tha 'Shoqata e Bankave të Kosovës duke nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me IFC-në në korrik 2014, hodhi hapin e parë të këtij projekti duke treguar kështu një përkushtim për edukimin financiar të klientëve. Qëllimi i projektit për edukim financiar të klientëve është që të ndihmojë në rritjen e aftësive dhe njohurive të klientëve egzistues dhe klientëve potencial të bankave në Kosovë mbi bazat e financave'. Gjatë konferencës u bë edhe dorëzimi zyrtar i materialeve të projektit nga IFC-ja tek Shoqata e Bankave të Kosovës. Me këtë rast, u ndanë certifikatë mirënjohje për të gjitha bankat komerciale në Republikën e Kosovës për kontributin e dhënë në implementimin e projektit për Edukim Financiar. Ky projekt është përkrahur nga bankat anëtare të Shoqatës së Bankave të Kosovës (Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, IsBank, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank dhe TEB Bank), IFC-ja si pjesë e grupit të Bankës Botërore, Master Card International, Visa International dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. (RTK live, Bota Sot, KosovaPress, Kosovalive 360, Kallxo.com, Telegrafi, Indeksonline, Blic, Zeri, Radio Televizioni i Kosoves, RTV 21, 10 korrik 2015).

HAMZA: PËR TRE VJET NORMAT E INTERESIT U ULËN PËR 50 PËR QIND



Për tre vjetët e fundit në Kosovë kanë rënë normat e interesit nga 14 për qind sa ishin, në 7.9 për qind. Këtë e ka bërë të ditur për emisionin Rubikon të KTV-së guvernatori i BQK-së, Bedri Hamza. Por ai nuk ia ka atribuuar të gjithë meritat vetës, por ka theksuar se rënia e normave për 50 për qind ndodhi për shkak të rritjes së konkurrencës, eliminimit të pengesave dhe hyrja në fuqi të ligjit për përmbaruesit privatë. Derisa i ka vlerësuar si të sigurtat bankat e Kosovës. "Kosova është treg i hapur, janë 10 banka dhe kjo ka bërë që të rritet konkurrenca dhe normalisht që normat u ulën brenda 3 vjetësh në 50 për qind, me çka Kosova u bë e barabartë me të gjitha shtetet e rajonit, duke përjashtuar Bosnjën dhe Maqedoninë. Po ashtu ndikoi edhe eliminimi i pengesave nga ana jonë, ne kemi krijuar infrastrukturën legale, çështja e përmbaruesve privatë ka ndikuar po ashtu shumë. Të mos harrojmë se edhe numri i kredive të këqija ka rënë dukshëm. Pra, të gjitha këto kanë plotësuar njëra-tjetrën dhe kanë bërë që bankat të krijojnë sigurinë e tyre". Ai ka thënë se askund në botë, por as në Kosovë, nuk mundet që shtetit të ndikojë në banka që të caktojë normën e interesit për asnjë lloj kredie. Rënie e përqindjes së depozitave në 1 për qind e ka arsytuar me atë që bankat kanë mjaft depozita të tyre. (Koha Ditore, KTV, 15 korrik 2015).

ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA NË KOSOVË ANËTARËSOHET NË SHOQATËN E BANKAVE



Që nga korriku i këtij viti, në Shoqatën e Bankave të Kosovës është shtuar një bankë anëtare. Kjo është banka T.C. ZIRAAT BANKASI A.S. – dega në Kosovë. Ziraat Bank është themeluar në vitin 1863, ndërsa konsiderohet se është njëra ndër bankat më të mëdha në Turqi. Ziraat Bank është një bankë sovraane (kapitali aksionar i Bankës është 100% në pronësi të Nënsekretariatit Turk të Thesarit). Deri më 31 Dhjetor 2014 rrjeti i Ziraat Bank përfshinte 1682 degë lokale dhe 25 degë ndërkombëtare.

Për anëtarësimin e Ziraat Bank në Shoqatën e Bankave të Kosovës, Menaxheri I degës në Kosovë z. Meriton Sunduri tha se “Është kënaqësi e jona që të jem anëtarë në Shoqatën e Bankave të Kosovës si dhe e mirëpresim bashkëpunimin gjatë viteve të ardhshme të rritjes sonë në Kosovë”.

Kurse, nga Shoqata e Bankave të Kosovës z. Petrit Balija, deklaroi se “Është një nder i madh të kemi një bankë dhe investitorë të tillë në Kosovë siç është Ziraat Bank. Mendoj se Ziraat Bank do të kontribuoj shumë pozitivisht në rritjen e qasjes në financa për qytetarët e Kosovës dhe bizneset në Kosovë. Kjo bankë sjell një përvojë të jashtëzakonshme duke pas parasysh që është një ndër bankat më të vjetra dhe më të mëdha në rajon dhe më gjerë. Ne si Shoqatë e Bankave të Kosovës do të jemi në mbështetje të plotë të stafit dhe menaxhmentit të Ziraat Bankës.” (Zeri, Botapress.info, 23 korrik 2015).

U MBAJT TRYEZA E RRUMBULLAKËT ME TEMËN “E DREJTA E TRANSFERIMIT TË QIRAMBAJTJES PËR PRONAT E PRIVATIZUARA NË KOSOVË PËR 99 VITE: IMPLIKIMET PËR BIZNESET, INSTITUCIONET FINANCIARE DHE KLIENTËT E TYRE”



Me datën 23 Korrik, 2015, zyra e Bankës Botërore në Kosovë ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temën “E drejta e transferimit të Qirambajtjes për pronat e privatizuara në Kosovë për 99 vite: Implikimet për bizneset, institucionet financiare dhe klientët e tyre”. Në këtë tryezë u diskutua për të drejtën e transferimit të Qirambajtjes dhe në veçanti për interpretimin ligjor të bërë së fundmi nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, në bazë të së cilës udhëzohet si të bëhet bartja e së drejtës së Qirambajtjes për 99 vite. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia e Privatizimit të Kosovës, Shoqata e Bankave të Kosovës, përfaqësues ligjor të pronarëve të pronave të privatizuara. (Shoqata e Bankave të Kosovës, Banka Botërore, 23 korrik 2015)

REVISTA ‘THE KOSOVO BANKER’ SHPËRNDAHET FALAS ME KOHA DITORE



Shoqata e Bankave të Kosovës, sot me 27 korrik 2015, shpërndan botimin e saj “The Kosovo Banker” falas, e cila vjen së bashku me gazetën e blerë Koha DITORE. Në këtë numër do të mund të mësoni rreth Modernizimit të shërbimeve bankare; Rritja e efikasitetit në sektorin bankar; Intervistë ekskluzive me Ministrin e Financave z. Avdullah Hoti; etj. (Koha Ditore, 27 korrik 2015).

BORDI I DREJTORËVE NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS ZGJEDH KRYETARIN E RI



Në takimin e fundit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) është bërë përzgjedhja e kryetarit të bordit të drejtorëve të SHBK-së. Me konsensus të plotë, kryetar i bordit të drejtorëve me një mandatë prej 2 vitesh u zgjodh z. Ilir Aliu njëherësh edhe drejtor gjeneral i ProCredit Bank në Kosovë.

Me rastin e përzgjedhjes së tij në funksionin e kryetarit të bordit të drejtorëve z. Aliu tha “Sektori bankar në Kosovë është një ndër sektorët më të zhvilluar dhe modernizuar dhe gjithashtu një kontribues i fuqishëm i zhvillimit ekonomik të vendit. Andaj të jesh në krye të Shoqatës së Bankave, që njëherit është edhe zëri i industrisë bankare është një përgjegjësi por edhe nder i madh. Kontributi im në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori do të jetë i pa kursyeshëm në mënyrë që oferta e shërbimeve bankare të avancoj në çdo aspekt, por edhe ambienti i të bërit biznes të përmirësohet”. Ndërsa drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balijsa, me rastin e përzgjedhjes së kryesisë së re të bordit të drejtorëve tha “ Detyra e kryetarit të bordit ka një rëndësi të madhe për Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe sektorin financiar në Kosovë. Me këtë rast përgëzoj z. Ilir Aliu për zgjedhjen e tij dhe jam i sigurtë që z. Aliu do të kontribuojë fuqishëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të industrisë bankare në Kosovë.” Shoqata e Bankave të Kosovës është themeluar në vitin 2002 dhe përfaqëson gjithsej 9 banka komerciale, anëtare në SHBK. (Shoqata e Bankave të Kosoves, 28 korrik 2015).

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS NDAN MIRËNJOHJE PËR Z. ROBERT WRIGHT



Shoqata e Bankave të Kosovës ndau mirënjohje për z. Robert Wright me rastin e përfundimit të suksesshëm të mandatit të tij të dytë si kryetar i bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK). Wright gjatë kohës sa ishte kryetar i bordit të SHBK-së dha një kontribut të çmuar për sektorin bankar dhe punën e SHBK-së. Me rastin e dorëzimit të mirënjohjes tek z. Wright, drejtori ekzekutiv i SHBK-së z. Balija tha “Në emër të bordit të SHBK-së dhe në emër të tim personal kam nderin të prezantoj këtë mirënjohje për z. Wright, për përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm në shërbimin e tij në pozitën e kryetarit të bordit të SHBK-së”.

Në anën tjetër z. Wright ishte falënderues për këtë mirënjohje duke thënë “Ka qenë kënaqësi dhe nder të jem Kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës gjatë dy mandateve të njëpasnjëshme dhe të jem i përfshirë në

shumë zhvillime pozitive brenda industrisë bankare gjatë kësaj kohe. I falënderoj sinqerisht kolegët e Bordit për gjithë përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre gjatë kohës sime si Kryetar, dhe gjithashtu do të doja të shpreh falënderimet e veçanta për z. Petrit Balija dhe ekipin e tij në SHBK për përkrahjen shumë profesionale dhe udhëzimet që na kanë ofruar gjatë 4 viteve të kaluara. I dëshiroj z. Ilir Aliut, nga banka ProCredit të gjitha sukseset si Kryetar i ri i Bordit në SHBK.” Z. Wright, njëherit edhe drejtor gjeneral i Raiffeisen Bank në Kosovë, është zgjedhur nga Bordi që të shërbej si zëvendës kryetarë i Bordit për një mandat të ri gjatë të cilit kryetar i bordit do të jetë z. Ilir Aliu, drejtor gjeneral i bankës ProCredit. (Shoqata e Bankave të Kosovës, 28 korrik 2015).

MIRËPRITET BANKA ZIRAAT NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS

Të Mërkurën, me 29 Korrik 2015, gjatë takimit të Bordit të Drejtorëve në Shoqatën e Bankave të Kosovës i është dorëzuar certifikata e anëtarësisë anëtarit më të ri ZIRAAT Bank, dega në Kosovë.

Kjo është hera e parë që Drejtori Ekzekutiv i bankës ZIRAAT, z. Meriton Sunduri, merr pjesë në mbledhjen e bordit, pas anëtarësimit. Në fund të takimit, z. Sunduri pranoi certifikatën e anëtarësisë me ç’rast kryetari i Bordit të Drejtorëve i shprehi mirëseardhje anëtarit më të ri në SHBK.



NUK MJAFTON VETËM INTERNETI

(opinion nga eksperti i ekonomisë Ibrahim Rexhepi, i publikuar në Koha Ditore më 14 korrik 2015)



Dikur moti, nga mesi i vitit 2001, Ali Sadriu, atëherë bashkëkryesues i AQF-së, i shoqëruar nga Andy Bearpark, shef i shtylles IV të UNMIK-ut, nxorri 100 marka nga bankomati i parë i instaluar në Kosovë. Ky ishte momenti kur nisi modernizimi i punës së bankave komerciale, përkatësisht futja e elektronikës në transaksione bankare me klientët. Këtë nismë e shënoi MEB-i i atëhershëm, tash ProCredit Bank. Ishte kohë e largët, që karakterizohej edhe me ecjet e

ngadalshme në sferën bankare, meqenëse ai ishte në ndërtim e sipër. Sot kjo duket si një përrallë, meqenëse bankat kanë avancuar dukshëm, jo vetëm për nga vëllimi i punëve që bëjnë, por edhe në ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit për shërbime ndaj klientëve.

Koha e tashme karakterizohet me zhvillime të hovshme në lëmin e elektronikës dhe me një konkurrencë të ashpër në tregun bankar. Kosova nuk mund t'u shmanget këtyre zhvillimeve ndonëse sistemi modern bankar ka një traditë të shkurtër. Megjithëse, kjo nuk ishte pengesë që të aplikohen arritjet më të reja, pasi që bankat gëzojnë besueshmeri të madhe të qytetarëve, të cilët këtë e tregojnë përmes "huazimit" të parasë në formë të depozitave, si dhe kryerjes së pagesave përmes bankave...Në këta trend nuk ndikoi as kriza amerikane, as ajo evropiane, por as disa deklaratat pesimiste se po lëkundet edhe sistemi bankar në Kosovë.

Bankat dëshmuar stabilitet, qëndrueshmëri, por edhe të gatshme për të zhvilluar format më bashkëkohore të shërbimeve bankare...Pa dyshim se merita kryesore për futjen e e-bankingut në funksion u takon bankave. Mirëpo, nuk janë vetëm ato që e mundësuan. Në këtë drejtim Kosova ka një përparësi –interneti ka shtrirje gjithnjë e më të madhe dhe shkalla e penetrimit të tij kalon shume vende të rajonit...Zhvillimi i e-bankingut është me interes të shumëfishtë –bankat kanë kosto më të lirë operative, ndonëse fillimisht iu duhet të bëjnë bukur shumë investime. Ndërkaq përfitimet më të mëdha i kanë klientët –kanë shërbim të shpejtë dhe kudo që kanë nevojë, kostoja është shumë më e lirë se në sportel, ndërsa bankat i ofrojnë siguri. (Koha Ditore, 14 korrik 2015).

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN GUSHT 2015

KOSOVA PËR HERË TË PARË EMETON OBLIGACIONE 5-VJEÇARE



Duke qenë e përkushtuar në zhvillimin e tregut financiar dhe krijimin e mundësive të reja për investim, Ministria e Financave ka shpallur ankandin e radhës të letrave me vlerë, në formë të Obligacioneve 5 vjeçare, i cili do të mbahet me 28 gusht 2015, njoftoi Ministria e Financave, duke cekur se ankandi për oferta mbyllet në ora 11:00. "Kohëzgjatjet në të cilat deri më tani është bërë emetimi kanë qenë 3 muaj, 6 muaj, 12 muaj, 2 dhe 3 vjeçare. Prandaj, ky ankand shënon edhe emetimin e parë të Obligacioneve me kohëzgjatje 5 vjeçare në historinë e tregut të letrave me vlerë në Republikën e Kosovës. Shtimi i kohëzgjatjeve të reja dëshmon për një rritje të shëndoshë të tregut të letrave me vlerë. (Kosova Sot, Zëri, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 25 gusht 2015).

BANKAT DIGJITALE



Klientët dhe bankat përfitojnë në mënyra të ndryshme nga digjitalizimi i bankave. Disa nga këto beneficione për klientë është edhe shmangia e pritjes së panevojshme në rend për të kryer ndonjë punë në bankë, shmangia e përshtatjes së orarit personal me atë të orëve kur banka është e hapur, nuk ka më nevojë që për të shikuar bilancin dhe transaksionet gjithnjë të shkojnë direkt në bankë e të tjera të ngjashme. Klientët dhe bankat në mbarë botën, por me një ritëm të kënaqshëm edhe në Kosovë, janë duke u adaptuar shumë shpejt ndaj shërbimeve digjitale, ngase që të dyja palët kanë kuptuar se digjitalizimi përmirëson dhe shpejton shumë procese bankare. Në Evropën Lindore, veçanërisht në Poloni dhe Republikën Çeke, disa banka vazhdimisht punojnë në drejtim të digjitalizimit dhe janë duke bërë përparim të madh. Konsumatorët janë duke i pranuar mirë këto ndryshime duke i futur në përdorim mundësitë e reja të tilla si bankim online. Së fundi, këtë e vërejmë edhe në ndonjërin nga bankat kryesore që operon në Kosovë. (Express, 18 gusht 2015).

BANKAT E KOSOVËS DALIN ME KREDITË MË TË ULËTA DERI ME TANI



Norma mesatare e interesit për kredi në Kosovë ka shënuar nivelin më të ulët në 15 vitet e fundit.

Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balijs, ka bërë të ditur që norma

mesatare e interesit për kredi tanimë është 7.6% e raportuar në fund të muajit Qershor 2015. Ai thotë se viti 2015 ka qenë një vit i paprecedent në rënien e normave të interesit për kredi në 15 vitet e fundit në Kosovë, duke ju mundësuar kështu qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës një qasje shumë më të lehtë në kredi. Tanimë Kosova është nën mesataren e rajonit dhe shpresojmë që kjo do t'i kontribuoj pozitivisht ekonomisë së vendit.

Në bazë të të dhënave të publikuara nga Banka Botërore, normat e interesit për kredi në vendet e ballkanit perëndimor në fund të vitit 2014 kanë qenë: Shqipëria me 8.7%, Bosnia dhe Hercegovina me 8.7%, Maqedonia me 7.5%, Mali i Zi me 9.4% dhe Serbia me 14.8%. (Zëri, Telegrafi, RTK Live, Botapress, Klan Kosova, Top Channel, Ekonomiks Ekonomia Online, 6 gusht 2015).

ATK-JA RIMBURSON QYTETARËT



Administrata Tatimore e Kosovës, ka njoftuar se nga data 6 Gusht ka filluar me rimbursimin e mjeteve për qytetarët, të cilët kanë aplikuar dhe dorëzuar plikot me kuponë fiskal.

ATK ka shqyrtuar aplikacionet dhe plikot me kuponë fiskal dhe deri më tani ka rimbursuar mjetet për 2,997 qytetarë, ashtu siç është përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015.

Në vazhdimësi ATK do të shqyrtojë të gjitha aplikacionet, në mënyrë që të rimbursoj mjetet për të gjithë qytetarët të cilët kanë aplikuar dhe dorëzuar plikot me kuponë fiskal. (Zëri, Kosova Sot, 14 gusht 2015).

NORMA E ULËT E KREDIVE RRIT INVESTIMET

Norma mesatare e interesit për kredi në Kosovë, e cila është zbritur në 7.6 për qind, nga njohësit e ekonomisë konsiderohet si mundësi e mirë për rritjen e investimeve. Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Nagip Skënderi, ka thënë për “Epokën e re” se një ndër parakushtet kryesore për zhvillimin ekonomik janë investimet e reja. Skënderi ka bërë me dije se sa më të ulëta të jenë normat e interesit në kredi, aq më shumë do të ketë investitorë. “Sa më shumë të ulet norma e interesit dhe sa më tepër të këtë periudhë pushimi, shembull për një periudhë trevjeçare për të mos u kthyer aktiviteti dhe norma e interesit, atëherë arrihet të mbahet krahu i veprimeve të zhvillimeve ekonomike të subjektit ekonomik me të cilin merret”, është shprehur ai. Kurse nënkryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Burim Piraj, ka thënë se lajmi për uljen e normave të interesit është lajm shumë i mirë në njërin anë e, në anën tjetër, një tregues jo i mirë. Sipas tij, lajmi i mirë është pasi të gjitha subjektet që janë të interesuara për investime do të jenë në gjendje të gjejnë kapital që do t’ua lehtësonte investimet e tyre dhe do t’u ofronte mundësi më të mëdha për të krijuar profit. “Mendoj se, përkundër kësaj volitshmërie, vështirë se do të ketë investime domethënëse deri në fund të

këtij viti, sepse kemi një shtangim total të politikave ekonomike të cilat do t’i paraprinin një zhvillimi aq shumë të pritur ekonomik”, është shprehur Piraj, duke shtuar se në Kosovë të gjitha bankat që operojnë janë banka komerciale dhe normat e tyre bazohen në ofertë. “Mendoj se në rastin e vendit tonë oferta dhe kërkesa mund të jenë faktorët kryesorë të rënies së ratave të interesit, sepse kemi një treg të vogël i cili është i ngopur për momentin me prani të shumë bankave të ndryshme, nga ana tjetër kemi kërkesën e një ekonomie që, sipas mendimit tim, për herë të parë në Kosovën e pas luftës do të përjetojë rënie. Mendoj se këta dy faktorë të tregut kanë qenë pikërisht ata që kanë ndikuar në rënien e ratave të interesit dhe në asnjë mënyrë vullneti i mirë i sistemit bankar që është i instaluar në vendin tonë”, ka deklaruar Piraj. Në bazë të dhënave të publikuara nga Banka Botërore, normat e interesit për kredi në vendet e Ballkanit përfundimor në fund të vitit 2014 kanë qenë: Kosova 9.2 për qind, Shqipëria 8.7 për qind, Bosnja dhe Hercegovina 8.7 për qind, Maqedonia 7.5 për qind, Mali i Zi 9.4 për qind dhe Serbia 14.8 për qind. (Epoka e Re, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 11 gusht 2015).



MIRATOHET PROJEKTLIGJI PËR THEMELIMIN E FONDIT PËR GARANCI KREDITORE



E drejtuar nga kryeministri Isa Mustafa, Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar mbledhjen e rregullt, të 43-tën me radhë, në të cilën, ndër të tjera, ka miratuar Projektligjin për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Ky Fond po themelohet me një përkrahje të madhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe në aplikimin e përvojave më të mira të përkrahjes së bizneseve dhe të garantimit të kredive për biznese, por edhe një pjesëmarrje domethënëse të USAID-it, përkatësisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë fond, sepse gati qind për qind e mjeteve të cilat do të jenë si mjete initiale të fondit do të jenë mjete që jepen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. (Zëri, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, Telegrafi, 6 gusht 2015).

FONDI KREDITOR, MUNDËSI PËR VENDE TË REJA TË PUNËS



Ekspertë të çështjeve ekonomike, vlerësojnë se Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, do të mundësojë krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë. Për më shumë, ky fond do të përmirësojë qasjen në financa të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kabineti qeveritarë i Kosovës të mërkurën në mbledhjen e qeverisë ka miratuar projektligjin për themelimin e Fondit Kosovarë për Garanci Kreditore. Fondi, sipas kabinetit qeveritarë do të themelohet me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID), me 20 milionë dollarë të ndara si kapital fillestar. Eksperti i çështjeve ekonomike, Naim Gashi, themelimin e këtij Fondi e vlerëson si shumë të nevojshëm për zhvillimin e bizneseve në Kosovë. (Zëri, Telegrafi, 7 gusht 2015).

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN SHTATOR 2015

KËTO JANË PRODUKTET QË NGA SOT DO TË KUSHTOJNË MË LIRË



Qeveria e Kosovës, në përputhje me programin e saj, ka ulur TVSH-në për një sërë lëndësh të para dhe produktesh esenciale, me qëllim uljen e barrës financiare për shtresat në nevojë. Këto ndryshime vijnë si zbatim i pakos së re fiskale (Ligjin për Tatimin e Vlerës së Shtuar, Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale si dhe Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave). Prandaj, duke filluar nga sot, 1 shtator 2015, të gjitha produktet esenciale do të kenë një masë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar në 8%, nga 16% sa ishte më parë. Drithi, mielli dhe produktet e këtyre, çka përfshin bukën dhe prodhimet e ngjashme me të, do të jenë me TVSH 8%. Me të njëjtën masë do të tatohen edhe vaji për gatim, qumështi, vezët dhe kripa. Edhe shërbimet publike si furnizimi me ujë (por jo të ambalazhuar), energjia elektrike dhe ngrohja qendrore do të kenë TVSH vetëm në masën 8%. Sipas pakos së re fiskale, Ligji për Tatimin e Vlerës së Shtuar do të përcakton dy norma të TVSH-së si norma standarde e TVSH-së 18 për qind dhe norma e reduktuar e TVSH-së, 8 për qind. Kjo do të thotë se për produkte të tjera, për të cilat nuk ka ulje apo largim të TVSH-së, ky tatim do të rritet në masën 18%. (Telegrafi, 1 shtator 2015).

APROVOHET DRAFT-LIGJI PËR THEMELIMIN E FONDIT QË GARANTON KREDITË

Në selinë e Qeverisë së Kosovës, u mbajt takimi i tretë i Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës (KKZHE), për të diskutuar për hapat e mëtutjeshëm për avancimin e reformave ekonomike në vend. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, njëherësh edhe koordinatore e KKZHE-së, Hykmete Bajrami, theksoi se ne jemi duke u përpjekur në vazhdimësi që Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik ta fuqizojmë dhe ta shndërrojmë në një forum me rëndësi për zhvillimin e afarizmit dhe për institucionet e Kosovës. Në periudhën në mes të dy mbledhjeve të Këshillit, Qeveria poashtu ka miratuar

FONDI PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE, KA VLERË 25 MILIONË EUROVE

Fondi për sigurimin e depozitave, i themeluar para katër vjetësh, ka arritur vlerën e 25 milionë eurove dhe mbulon depozitat në shumën rreth 470 milionë euro. Limiti i sigurimit është deri në 3 mijë euro, kurse nga një janari i vitit të ardhshëm limiti do të rritet deri në 4 mijë euro. Kështu thotë në një intervistë për Radio Kosovën, drejtoresha menaxhuese e këtij fondi, Violeta Arifi-Krasniqi. Ndonëse shumica e përgjithshme e parave të depozituara në sistemin bankar të Kosovës ka arritur në 2 miliardë e 500 milionë euro, vetëm rreth 1 e pesta e kësaj shume është e siguruar nga Fondi për sigurimin e depozitave. “Numri i depozituesve të siguruar është rreth 721 mijë, prej tyre persona fizikë janë shumica e tyre, apo 94.7 për qind”, thotë ajo. (RTK Live, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 15 shtator 2015).



draft-ligjin për themelimin e Fondit për Garantimin e Kredive dhe ky draft-ligj do të procesohet për miratim në Kuvendin e Kosovës gjatë këtij muaji. Më 1 shtator kanë hyrë në fuqi ligjet e pakos së re fiskale, të cilat pritet që të kenë një ndikim të rëndësishëm tek biznesi privat në Kosovë. (Zëri, 9 shtator 2015).



TAKIM NJOFTUES MES DREJTORIT TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS DHE PËRFAQËSUESIT TË RI REZIDENCIAL TË FMN-SË NË KOSOVË



Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balijsa priti sot në një takim njoftues Përfaqësuesin e ri Rezident të FMN-së në Kosovë z. Ruud Vermeulen. Gjatë takimit drejtori Balijsa e njoftoi më hollësisht z. Vermeulen për gjendjen dhe performance e industrisë bankare në Kosovë si dhe bashkëpunimin me FMN-në. Në lidhje me këtë takim drejtori Balijsa tha 'Indikatorët kryesorë të sektorit bankar në Kosovë janë pozitiv por kërkohet një mobilizim i të gjitha palëve me interes në mënyrë që sektori bankar të rrit kreditimin sa më shumë për ekonominë e vendit. Ndërkaq z. Vermeulen theksoi bashkëpunimin e mirë që ka pasur FMN me SHBK-në edhe në të kaluarën dhe shprehi një interesim më të madh të FMN-së për sektorin financiar në Kosovë.' Duke e falënderuar z. Verneulen për gatishmërinë për bashkëpunim, drejtori Balijsa i dëshiroi fillim të mbarë në detyrën e tij të re dhe uroi për thellimin e bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, KosovaLive 360, 23 shtator 2015).

HAMZA: PANAIRI, PASQYRË E ZHVILLIMIT TË SISTEMIT FINANCIAR

Si çdo vit tjetër, edhe këtë vit u hap Panairi Financiar 2015, i cili po mbahet brenda Pallatit të Rinisë. Ky panair është mundësi e mirë që klientët apo bizneset të njihen me ofertat financiare, të cilat i ofrojnë bankat komerciale që operojnë në Kosovë. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Bedri Hamza tha se panairi financiar këtë vit po shërben si pasqyrë e mirë e zhvillimit në sistemimin financiar. Sipas tij, shtimi i numrit të institucioneve financiare, ka bërë që panairi financiar çdo vit të sjellë risi. Sipas tij roli i sistemit financiar në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit, ka shënuar përmirësim të mëtejshëm në periudhën e fundit, kryesisht zhvillimit në kuadër të aktivitetit të sektorit bankar.

Kurse, kryetari i bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Ilir Aliu tha se panairi është mundësi e mirë për dialog mes konsumatorëve dhe sektorit financiar. "Ky panair financiar është një mundësi që konsumatorët dhe sektori financiar të dialogojnë bashkë, t'i shohim inovacionet e zhvillimeve të sektorit bankar dhe të shohim ofertat e tyre, cilat janë në përgjithësi. Panairi është një mundësi që konsumatorët të njihen jo vetëm me sektorin bankar, por edhe me sektorin mikrofinanciar edhe me sektorin e kompanive të sigurimit", tha Aliu. (Telegrafi, Bota Sot, Bota Press, RTV 21, Indeksonline, Express, Zëri, 24 orë, RTK, Kosova Sot, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 29 tetor 2015).



“FINANCIMI I PROGRESIT NË KOSOVË” FLET PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK

Në kuadër të Panairit Financiar 2015, u mbajt konferenca “Financimi i Progresit në Kosovë” në Sëiss Diamond Hotel. Hapja e konferencës u bë me fjalimin hyrës nga zv. guvernatori z.Fehmi Mehmeti i cili dha një përmbledhje mbi gjendjen aktuale të industrisë bankare në Kosovë duke e theksuar dhe vlerësuar performancën pozitive të sektorit bankar gjatë viteve të fundit.

Gjithashtu, hapja e konferencës u bë me prezantimin mbi performancën e industrisë bankare nga kryetari i bordit të Shoqatës së Bankave njëherësh drejtor gjeneral në ProCredit Bank z. Ilir Aliu. Pas fjalimeve hyrëse u zhvillua diskutimi me panelistët e ftuar. Pjesë e panelit ishin: zv.guvernatori z. Fehmi Mehmeti, Jan Peter-Olters nga Banka Botërore, Michael Gold nga Crimson Finance Fund si dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, Memli Krasniqi nga Ministria e Bujqësisë, Robert Wright Nënkyetar i bordit si dhe kryeshef ekzekutiv në Raiffeisen Bank, Safet Gërxhaliu nga Oda Ekonomike e Kosoves si dhe përfaqësues nga sektori i sigurimeve. Konferenca u moderua nga drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija. Nga i gjithë diskutimi në këtë konferencë, u përmenden dhe u trajtuan tema të ndryshme me rëndësi për sektorin financiar, por edhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ndër të tjera u diskutua për rëndësinë e agrobiznesit në zhvillimin ekonomik, sfidat dhe barrierat për qasje në financa për këtë sektor, si dhe çka duhet të ndërmerret nga të gjitha institucionet relevante për të arritur efekte sinergjike dhe për të arritur rezultate pozitive. Pjesë e diskutimit ishte edhe Fondi Kosovar për Garantim të Kredive. U diskutua se si financohet dhe cilat janë objektivat kryesore të këtij fondi dhe cilat janë efektet e mundshme mbi rritjen ekonomike dhe papunësinë. Panairi Financiar i Kosovës përmbyllet sot më 30 shtator në ora 18:00. (Koha.net, Blic, KosovaPress, Express, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 30 shtator 2015).



PËRMBYLLET ME SUKSES PANAIRI FINANCIAR I KOSOVES -2015

Panairi Financiar i Kosovës i cili u mbajt më datën 29 dhe 30 shtator 2015 në Pallatin e Rinisë u përmbyll me sukses. Panairi filloi me hapjen solemne e cila u bë në hollin e Pallatit të Rinisë, me ç’rast guvernatori i Bankës Qëndrore z. Bedri Hamza theksoi rëndësinë e Panairit Financiar si dhe nënvizoi se roli i sistemit financiar në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit ka shënuar përmirësim të mëtejme në periudhën e fundit dhe atë kryesisht në saje të zhvillimeve në kuadër të aktivitetit të sektorit bankar. Hapja solemne e Panairit u bë edhe nga kryetari i bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Ilir Aliu i cili në fjalën e tij hapëse tha se panairi është mundësi e mirë për dialog mes konsumatorëve dhe sektorit financiar, që të shohin inovacionet e zhvillimit në sektorin bankar. Ai po ashtu foli edhe për risitë që ka sjellë këtë vit panairi.

Përveç organizimit të ekspozimit të kompanive, në ditën e dytë të Panairit Financiar u mbajt edhe konferenca vjetore me temën “Financimi i Progresit në Kosovë”. Kjo konferencë mbledhi në tavolinën e diskutimit akterët relevant për të trajtuar tema të ndryshme me rëndësi për sektorin financiar por edhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ndër të tjera u diskutua për r

ëndësinë e agrobiznesit në zhvillimin ekonomik, sfidat dhe barrierat për qasje në financa për këtë sektor, si dhe çka duhet të ndërmerret nga të gjitha institucionet relevante për të arritur efekte sinergjike dhe për të arritur rezultate positive. Pjesë e diskutimit ishte edhe Fondi Kosovar për Garantim të Kredive. U diskutua se si financohet dhe cilat janë objektivat

kryesore të këtij fondi dhe cilat janë efektet e mundshme mbi rritjen ekonomike dhe papunësinë. Panairi Financiar gjatë këtyre dy ditëve tërhoqi një numër të madh të vizitorëve të cilët paten mundësinë të njoftohen për së afërmi me ofertat e bankave, institucioneve mikrofinanciare, kompanive të auditimit, shkollave dhe instituteve të kontabilitetit, institucioneve edukativo-arsimore, si dhe programeve të ndryshme.

Në lidhje me Panairin Financiar 2015, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Balijsa theksoi se ky panair ka qenë ndër më të suksesshmit që kemi organizuar deri më tani. Vizitorët kanë pasur qasje të lehtë në Pallatin e Rinisë dhe kanë pasur mundësinë që të vizitojnë institucionet financiare që kanë ekspozuar shërbimet e tyre. Duhet të falënderojmë edhe pjesëmarrësit e konferencës vjetore financiare, e cila ka rezultuar me një diskutim mjaft konstruktiv rreth rritjes së financimit për agrobiznesin. Gjithashtu me këtë rast është festuar 10 vjetori i Qendres për Trajnime Bankare pranë Shoqatës së Bankave të Kosovës ku janë falënderuar bashkëpunëtorët tanë me mirënjohje, shtoi në fund drejtori Balijsa. Të gjitha konkluzionet nga konferenca vjetore e organizuar në kuadër të Panairit Financiar 2015 do të publikohen në numrin e shtatorit 2015 të Periodikut Bankar i cili do të jetë në dispozicion në ëbfaqen e Shoqatës së Bankave të Kosovës. (Shoqata e Bankave të Kosovës, 30 shtator 2015).



LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN TETOR 2015

KOSOVA ME KREDI TË KËQIJA MË TË ULËTA NË RAJON



Burimi: images.google.com

Aktualisht vlera e tyre është rreth 140 milionë euro apo rreth 7.1 për qind në portofolin e përgjithshëm të kredive. Kështu thotë për radio Kosovën drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Balijs. Ndonëse kreditimi në Kosovë ka shënuar rritje gjatë këtij viti krahasuar me vitin e kaluar, kreditë joperformuese, që njihen si kredi të këqija që nuk kthehen me kohë nga kredimarrësit, kanë shënuar rënie. Drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balijs theksoi për Radio Kosovën se aktualisht niveli i kredive joperformuese në Kosovë është më i ulët në rajon. Rënia e nivelit të kredive joperformuese, sipas tij, është si rezultat i angazhimit të të dy palëve që janë të përfshira në këtë proces. Ndryshe, deri në gusht të këtij viti, niveli i përgjithshëm i kredive ka kaluar 2 miliardë euro, që është niveli më i lartë në periudhën e pasluftës, ndërsa normat e interesit në mesatare kanë rënë në rreth 7.9 për qind. Afaristi Ramiz Kelmendi thotë se për shkak të kamatave të larta që kanë qenë deri tani, për disa afaristë mund të paraqet problem kthimi i kredive të vjetra. (Telegrafi, Radio Kosova -13 tetor 2015, Zëri -14 tetor 2015).

0,8 % NORMA MESATARE E INTERESIT NË DEPOZITA, NË KREDI 7,6 %

Normat e interesit në kredi vazhduan me trendin rënës të ndjekur gjatë viteve të fundit, përderisa normat në depozita shënuan rritje të lehtë në krahasim me vitin paraprak, raporton zëri.info. Në qershor 2015, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 7.6 përqind nga 10.6 përqind sa ishte në qershor 2014. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) rënia mund të jetë ndikuar nga presioni i konkurrencës bankare dhe zvogëlimit të kostos së financimit të aktivitetit bankar krahasuar me vitet e kaluara. Në depozita, norma mesatare e interesit u rrit në 0.8 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në qershor 2014. Normat e ulëta të interesit në depozita janë kryesisht rrjedhojë e prezencës së mjaftueshme të likuiditetit në sektorin bankar. (Zëri, 20 tetor 2015).

KJO ËSHTË KARTËMONEDHA E RE PREJ 20 EURO

Kur e njoftoi për herë të parë në muajin shkurt të këtij viti, Mario Draghi iu referua si një ndër kartëmonedha më të përparuara teknologjikisht për sa i përket mundësisë për tu falsifikuar. E në fakt kartëmonedha e re prej 20 euro nuk i zhgënjeu aspak pritshmëritë. Në varësi të dritës që mbi relief, kartëmonedha e re shfaq imazhe të ndryshme. Gjithsesi, në të dyja anët, një prej imazheve që shfaqet është ai i Europës, figurë e mitologjisë greke. Duke lëvizur përsëri kartëmonedhën nën efektin e dritës shfaqet në relief edhe shifra prej 20 eurosh në ngjyrë argjendi. Edhe vetë numri ndryshon ngjyrën në varësi të dritës, nga jeshilja smerald në blu të errët. Edhe në shiritin e sigurisë, atë qendrorin vihen re të njëjtat efekte në varësi të dritës, ku shfaqet përsëri vlera e kartëmonedhës. Në kartëmonedhën e re, Euro tashmë figuron si simbol dhe jo si fjalë, pecjell Telegrafi shkrimin e medieeve botërore. Kartëmonedha e re që ka për qëllim kryesor të limitojë sa më shumë mundësinë e falsifikimit do të hyjë në qarkullim duke filluar që prej datës 25 nëntor të këtij viti. Prerja prej 20 euro është ajo që shfrytëzohet më shumë nga falsifikatorët. Tashmë, këta të fundit, duket se do ta kenë të pamundur që të krijojnë kopje identike të kartëmonedhës prej 20 euro. (Telegrafi, 22 tetor 2015).



Burimi: images.google.com

Burimi: images.google.com

DEBATOHEM PËR THEMELIMIN E FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE



Projektligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, ishte temë e debatit, në dëgjimin publik organizuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Duke folur për qëllimin e këtij takimi, kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se dëgjimi publik është organizuar me qëllim të nxjerrjes së një ligji sa më të mirë që rregullon fondin për garanci kreditore. Projektligjin, ndërkaq, e paraqiti përfaqësuesja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Remzije Hajdari. Ajo tha se projektligji ka kaluar në një proces të gjatë të komunikimit publik, me qëllim që hartimi i tij të jetë sa më adekuat dhe të krijojë mundësi sa më të mëdha për bizneset. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 29 tetor 2015).

KËSHILLI I BE-SË MIRATON MSA-NË ME KOSOVËN

Këshilli i Bashkimit Evropian ka miratuar të enjten Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Miratimi i MSA-së në Këshillin e BE-së, sipas Qeverisë në Prishtinë, shënon përfundimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe hap rrugë për nënshkrimin e MSA-së më 27 tetor në Strasburg. (Zëri, Telegrafi, 23 tetor 2015).



BB: KOSOVA E 66-TA PËR LEHTËSINË E TË BËRIT BIZNES

Banka Botërore publikoi raportin vjetor për lehtësinë e të bërit biznes, që vlerëson faktorët që lehtësojnë ose pengojnë biznesin në 189 vende të botës. Vlerësimi përfshin periudhën nga viti 2014 deri në qershor të vitit 2015. Në raportin e fundit të Bankës Botërore për "Të bërit biznes", Kosova radhitet e 66-të, ndërsa Shqipëria është e 97-ta. Theksohet se Kosova ka shënuar përparim krahasuar me vitin paraprak.

Prej vendeve të tjera të rajonit, Maqedonia është e 12-ta, Kroacia e 40-ta, Mali i Zi radhitet në vendin e 46, Serbia është e 59-ta, ndërsa Bosnjë Hercegovina e 79. (Koha Ditore, Kosova Sot, 29 tetor 2015).



PLATFORMË ELEKTRONIKE PËR ANKESA

Departamenti i Tregtisë në kuadër të MTI-së ka lancuar sot platformën on-line për raportimin e barrierave për bizneset. Kjo platformë do të bëjë të mundur që institucionet relevante qeveritare të reagojnë shpejt në marrjen e masave të nevojshme për evitimin e barrierave dhe problemeve në transaksionet ndërkombëtare. Zyrtari i lartë në Departamentin e Tregtisë, Zef Dedaj theksoi se platforma "Raporto barrierat e biznesit" ka për qëllim komunikimin më të shpejtë ndërmjet bizneseve dhe institucioneve relevante për adresimin e barrierave gjatë realizimit të transaksioneve ndërkombëtare. Sipas tij, përfituesit kryesorë të kësaj platforme do të jenë të gjitha bizneset në Kosovë. (Zëri, Telegrafi, 14 tetor 2015).



Burimi: images.google.com

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN NËNTOR 2015

BANKA TË SIGURTA NË KOSOVË DHE SHQIPËRI



Shoqata e Bankave të Kosovës po merr pjesë në Forumin Kombëtar për Siguri Bankare në Tiranë. Hapja solemne është bërë nga drejtuesit e Shoqatave të bankave, respektivisht nga Kosova z. Petrit Balijs dhe nga Shqipëria znj. Endrita Xhaferi.

Z. Balijs me këtë rast tha se siguria e klientëve të bankave është një prej objektivave kryesor në zhvillimin e sektorit bankar në Kosovë. Ai potencoi rëndësinë që ka ofrimi i shërbimeve të shpejta, të lehta dhe mbi të gjitha të sigurt për klientët e bankave. Në konferencë janë të ftuar edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore të sigurisë. (Shoqata e Bankave të Kosovës, Bota Sot, RTKLive, Lajmi.net, Ekonomia Online, 30 nëntor 2015)

LIGJERATË PËR EDUKIMIN FINANCIAR NGA SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS NË KUADËR TË JAVES GLOBALE TË NDËRMARRËSISË

Në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë më 21 nëntor 2015 u organizua Kuvendi i 8-të zgjedhor i Këshillit të Nxënësve të Kosovës të organizuar nga Këshilli Rinor Kosovor (OJQ). Në këtë event si folës prezantues mori pjesë Valon Shehu – trajner i certifikuar për Edukim Financiar përmes projektit për Edukim Financiar të Klientëve të Bankave të ndërmarrë nga Shoqata e Bankave të Kosovës dhe

SEKTORI FINANCIAR I KOSOVES PËRFAQËSOHET NË BERLIN

Në Berlin është mbajtur takimi vjetor i Fondit Europian për Evropën Juglindore (EFSE) ku morën pjesë lider të sektorëve financiar për Evropën juglindore. Panelist i ftuar për të përfaqësuar Kosovën ishte Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balijs. Në panel morën pjesë edhe Guvernatori i Bankës Qëndrore të Kroacisë z. Boris Vujcic, ish-Guvernatori i Bankës Qëndrore të Serbisë z. Radovan Jelaciq, dhe përfaqësues tjerë nga Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar të cilët diskutuan për shumë zhvillime në arenën botërore financiare. Në delegacionin nga Kosova morën pjesë edhe Guvernatori dhe zv. Guvernatori i Bankës Qëndrore të Kosovës, përfaqësues të institucioneve bankare dhe mikrofinanciare si dhe përfaqësues të zyrës së EFSE në Kosovë. (Shoqata e Bankave të Kosovës, Zëri, RTKLive, Botapress, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, Telegrafi, 23 nëntor 2015)



IFC. Z. Shehu dha një prezentim rreth kursimeve para 100 pjesëmarrësve kryesisht nxënës të shkollave të mesme.



PO MBAHET JAVA GLOBALE E NDËRMARRËSISË



Nga 16-22 nëntor, në më shumë se 160 shtete paralelisht, po shënohet Java Globale e Ndërmarrësisë. Global Entrepreneurship Week (Java Globale e Ndërmarrësisë) që ka filluar të hënën, ka mbledhur së bashku partnerët e mbështetës të saj, që çdo vit janë në rritje, nga 12 në vitin 2013 në 28 partnerë këtë vit. Innovation Centre Kosovo (ICK), si nikoqir i kësaj jave në Kosovë, së bashku me partnerët e saj, janë duke ofruar ngjarje të shumta që për qëllim kanë promovimin e ndërmarrësisë dhe inovacionit. Vetëm në 2015, 10 milion njerëz pritet që drejtpërdrejt të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme në tërë botën. (Kosova Sot, 19 nëntor 2015)

RATIFIKOHET MSA ME 86 VOTA

Në vazhdim, pa praninë e opozitës, u bë votimi për miratimin e MSA-së, raporton Koha.net.

Në sallë ishin të pranishëm 87 deputetë. Deputetët miratuan amendamentin për shtimin e fjalës Republikë para emrit të shtetit të Kosovës, 85 ishin për. Nga numërimi i votave të doli se për MSA-në votuan 86 deputetë. Opozita, deputetët e Vetëvendosjes, AAK-së dhe të Nismas më herët e kishin braktisur sallën e Kuvendit. (Koha Ditore, 3 nëntor 2015)

PUBLIKOHET BRUTO PRODUKTI VENDOR

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) mban Konferencën e organizuar me rastin e publikimit të “Bruto Produktit Vendor” (BPV) për vitin 2014, me qasjen e shpenzimeve dhe të prodhimit, me çmime aktuale dhe konstante. Fjalën hyrëse do ta mbajë Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, Isa Krasniqi, ndërkohë që do të jenë të pranishëm edhe mysafirët ndërkombëtarë: Drejtori i Përgjithshëm i Statistikave të Suedisë, Stefan Lundgren, dhe përfaqësuesi i Eurostatit, Marius Andersen. Kjo është vizita e parë që një Drejtor i Përgjithshëm i një vendi të BE-së viziton ASK-në. Lundgren do të flasë për bashkëpunimin e SCB-së dhe projektet e përbashkëta të Statistikave

GDP

të Suedisë dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Ndërsa, Andersen do të flasë lidhur me përkrahjen e Eurostat-it për GDP-në në Kosovë dhe vendet e Rajonit. Në kohën e planifikuar për seminar, në prani të mediave, me stafin e ASK-së do të flasë Z. Lundgren, ku do të ketë diskutime dhe pyetje e përgjigje. (Kosova Sot, 10 nëntor 2015)



DËSHTIM DIPLOMATIK NË UNESCO



Fushata gati njëvjeçare e Qeverisë së Kosovës për ta anëtarësuar vendin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, UNESCO, ka dështuar, të hënën, në Paris, ku në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj organizate të OKB-së Kosovës i munguan vetëm tri vota për ta arritur synimin, shkruan sot Koha Ditore. Ishin 92 shtete që votuan në favor të anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, 50 ishin kundër, ndërsa 29 shtete abstenuan. Shumica e nevojshme prej dy të tretave – 95 vota - nuk u arrit për tri vota. Kur është kumtuar rezultati nga kryesuesi i Asamblesë, në sallë kanë shpërthyer duartrokitjet nga mbështetësit e Serbisë. Edhe serbët e Kosovës me flamuj e sirena kanë festuar mospranimin e Kosovës në UNESCO.

Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, të përfshirë në lobim, të cilët kohë të gjatë para votimit rrihnin gjoks se i kanë siguruar votat përballë fushatës së “egër” të Serbisë, kanë refuzuar të marrin përgjegjësinë për dështimin. Janë ngushëlluar me faktin se Kosova ishte shumë afër pranimin, dhe se do të provojnë sërish anëtarësimin në UNESCO më 2017, në Asamblenë e ardhshme të Përgjithshme, e cila, sipas rregullit, mblidhet një herë në dy vjet. (Koha Ditore, 10 nëntor 2015)

PROJEKTLIGJI QË PENGON SHPËLARJEN E PARAVE ME 2016

Qeveria e Kosovës edhe këtë vit nuk ka arritur që të kalojë shumë projektligje të rëndësishme për në Kuvend. Njëri nga ta ishte edhe plotësim-ndryshimi i ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Edhe pse ky projektligj ishte paraparë që në maj të këtij viti të procedohej në Parlament, megjithatë një gjë e tillë nuk pritet të ndodhë as këtë vit. Muharrem Shahini, drejtor në zyrën për komunikim me publikun nga ministria e financave, nëpërmjet postës elektronike i tha Tribuna Channel se ky ligj do të bartet për vitin 2016. (Telegrafi, 16 nëntor 2015)



LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN MUAJIN DHJETOR 2015

QEVERIA E BANKA BOTËRORE GARANTUESE PËR KOSOVËN E RE

Banka Botërore (BB) dhe Qeveria e Kosovës, do të jenë garantuese të aspekteve financiare e mjedisore të projektit për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”, u tha në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, ku Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci raportoi për këtë projekt. Në Komision nuk morën pjesë anëtarët e opozitës, përderisa kishte një debat në mes të deputetëve të LDK-së e PDK-së pas akuzave për korrupsion.

Në përgjithësi të gjithë të pranishmit u pajtuan me marrëveshjen e arritur në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe kompanisë Contour Global për ndërtimin e termocentralit. Kurse kryetari i Komisioni Muhamet Mustafa, u shpreh i kënaqur me përfshirjen e Bankës Botërore në këtë projekt. (Telegrafi 2 dhjetor 2015).



ARRESTOHEN 6 PERSONA, TËRHIQIN PARA ME KARTA TË KLONUARA

Prokuroria e Tiranës ka lëshuar një urdhër ndalimi për 6 të rinj, të cilët akuzohen për mashtrim kompjuterik. Grupi i të rinjve dyshohet se kanë klonuar karta debiti, me anë të të cilave kanë tërhequr para në bankomate në tri qytete të ndryshme: Lushnjë, Kavajë dhe Durrës. Prokuroria e Tiranës ka nisur hetimin në bazë të informacionit të mbërritur nga selia qendrore e bankës së nivelit të dytë në Tiranë, e cila kishte konstatuar ndërhyrje të paligjshme në sistemin e saj nëpërmjet një karte amerikane. Nga verifikimet e saj, banka ka krijuar dyshime se karta amerikane ishte e klonuar dhe nëpërmjet saj po tërhiqeshin shuma të konsiderueshme. Nga hetimi rezultoi se personat në fjalë kanë tentuar të kryejnë tërheqje edhe nga disa karta të tjera, por këto tentativa kanë rezultuar të pasuksesshme. E vetmja kartë që u ka funksionuar ka qenë ajo me të dhëna amerikane (të falsifikuara), të cilën, krahas bankomatëve, e kanë përdorur edhe në disa pika karburanti në zonën e Lushnjës dhe Kavajës. (Express, Zëri 2 dhjetor 2015).



JA SI DUKEN KARTËMONEDHAT E REJA TË ZVICRËS

Nga prilli 2016 ngadalë do të fillojmë t'i harrojmë bankënotat aktuale të frangut zviceran. Për herë të parë do të dalin në qarkullim kartëmonedha 50 CHF dhe pastaj në intervale prej një vit e gjysmë do të vihen në qarkullim dhe kartëmonedha të tjera deri në zëvendësimin e plotë të kartëmonedhave të vjetra, me një karakter të ri që do të përfundojë në vitin 2019. Ishte paraparë të vihen në qarkullim që nga viti 2010, por për shkak të problemeve teknike, ky proces është shtyrë disa herë. (Telegrafi, 3 dhjetor 2015).



BANKA PËR BIZNES ME PRODUKTE KREDITORE PËR TË RRIUR EFIÇENCËN E ENERGISJË

Me mbështetjen e IFC-së, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, Banka për Biznes (BPB) ka zhvilluar produkte të reja të kredisë për të financuar projektet e efijencës së energjisë për shtëpi dhe biznese më të vogla në Kosovë.

IFC-ja ka filluar punën e saj këshilluese me BPB-në në shtator të vitit 2014 për ta ndihmuar bankën që të zhvillojë ekspertizë në kreditimin e bazuar në efijencë të energjisë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, BPB-ja ka zhvilluar dy produkte të kreditimit – kreditë për efijencë të energjisë (EE) për ndërmarrje private dhe kreditë EE për huamarrësit individual, të cilat u prezantuan para klientëve të bankës, përfaqësuesve të industrisë dhe publikut në ngjarjen e organizuar në Prishtinë duke shënuar fillimin e kreditimit. “Bashkëpunimi me IFC-në ka ndihmuar në përmirësimin e ekspertizës së BPB-së dhe kapaciteteve të brendshme për zhvillimin e biznesit bankar për kreditimin e efijencës së energjisë”, tha Richard Beasley, Kryeshef ekzekutiv i BPB-së. “Financimi për projektet e efijencës së energjisë është kompleks, por ka potencial të konsiderueshëm të investimit në një modernizim efijent të energjisë të ekonomive familjare private të Kosovës dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ne jemi të kënaqur që mbështesim realizimin e këtij potenciali.” (Telegrafi, 9 dhjetor 2015).



KOSOVA KA RRETH 32 MIJË BIZNESE AKTIVE



Brenda shtetit të Kosovës ekzistojnë rreth 32 mijë biznese aktive, që merren me veprimtari ekonomike, ndërsa numri më i madh i ndërmarrjeve i takon sektorit të tregtisë me 16142 ndërmarrje, ose 50.6 për qind e të gjitha bizneseve. Këto shifra i ka publikuar Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në raportin e fundit. Sipas ASK-së, në vitin e kaluar, numri më i madh i ndërmarrjeve u takon tregtisë, pasuar nga industria përpunuese me 4052 ndërmarrje ose 12.7 për qind. Shërbimet biznesore dhe shërbimeve të tjera kanë 4023 kompani ose 12.6 për qind, pasuar nga; akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim; ndërtimtarisë; transportit, etj. Ndërsa, sa i përket punësimit për sektorët ekonomikë, që ishin pjesë e hulumtimit, del se numri total i të punësuarve arrin shifrën prej 145 736, prej te cilëve: sektori i tregtisë përbën rreth 54 295 të punësuar ose 37.3 për qind; industria përpunuese 22 257 ose 15.3 për qind; shërbimet biznesore 15 954 ose 10.9 për qind; ndërtimtaria me 13 192, etj. Treguesi i pagës mesatare mujore, sipas këtij raporti në vitin 2014, sillej rreth 352 Euro, në aktivitetet e përfshira në anketë, e që është një tregues i përafërt me realitetin. (Kosova Sot, 10 dhjetor 2015).

KOSOVA PËRFITON 78 MILIONË EURO ASISTENCË NGA BE-JA

Komisioni i Bashkimit Europian, e ka miratuar një pako prej 1 miliardë euro, si asistencë për t'i mbështetur reformat dhe bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi dhe 78,000,000 janë të destinuara për Kosovën, për Demokraci, Qeverisje, sundim të ligjit, të drejtat e njeriut, energji, bujqësi dhe zhvillim rural.

Kjo asistencë është e dedikuar për vendet para pranimin për t'i mbështetur reformat në sektorë të ndryshëm për vendet që dëshirojnë t'i bashkohen BE-së.

Johanes Hahn, Komisioneri për Politikë Europiane të Fqinjësisë dhe Negociatave për Zgjerim, ka thënë se kjo pako e miratuar nga ky institucion i BE-së shpreh angazhimin e fuqishëm për perspektivën e Unionit Europian për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë. Sipas tij, ky është një investim afatgjatë në stabilitetin ekonomik të këtyre vendeve.

Përveç Kosovës, nga kjo asistent prej 1 miliard eurosh, ka përfituar edhe Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia, Serbia dhe Turqia. (Zëri, 14 dhjetor 2015).



HOTI: KOSOVA E GATSHME PËR TË MARRË KREDI ZHVILLIMORE



Ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar se të hënën, Kuvendi i Kosovës pritet të miratojë në lexim të dytë ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.

Me këtë, sipas tij, bëhet e mundur ndryshimi i rregullës fiskale dhe i mundësohet Qeverisë të hyjë në hua tek institucionet financiare ndërkombëtare për të financuar projekte të mëdha kapitale, siç janë projektet e sistemeve të ujitjes së tokave bujqësore, hekurudhat, rrjeti energjetik dhe projekte të tjera strategjike. (Zëri, 14 dhjetor 2015).

BANKAT “KONTRIBUAN” NË ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT











Zhvillimi ekonomik nuk mund të ndodh pa pasur një zhvillim të sektorit privat dhe bankat janë ato të cilat mund të ndihmojnë dhe po ndihmojnë këtë sektor. Legjislacioni i viteve të fundit dhe sistemi i përmbauesve privat nga ata që përfaqësojnë

sistemin bankar u vlerësua si një ndihmesë e madhe në kthimin më të shpejtë të kredive gjë e cila paraqet edhe një rën ndë sfidat e këtij sektori. Kështu u tha në konferencën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me temën “ Ndikimi i Sektorit Dinamik Bankar në Zhvillimin e Sektorit privat”. Drejtori i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka deklaroi para të pranishmëve se nëse ka pasur diçka pozitive gjatë këtyre viteve në ekonomin e brishtë të Kosovës, ka qenë sektori bankar i cili është treguar të jetë i fuqishëm dhe qëndrueshëm në vendin tonë. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Bedri Hamza tha se pa një sektor të zhvilluar dhe të fuqishëm bankar nuk mund të ketë as zhvillim të sektorit privat e rrjedhimisht as zhvillim ekonomik të vendit. Menaxheri i Bankës Botërore në Kosovë, Jan Peter Olters në një fjalë rasti theksoi se sa i rëndësishëm është treguar sektori bankar në zhvillimin e vendit. Eriola Bibolli nga banka Pro Credit Bank shprehu ndihmesën që është dhënë në dy vitet e fundit nga legjislacioni i aprovuar në Kuvend përmes Ligjit për Detyrime dhe funksionimit të përmbauesve privat, të cilët sipas saj, kanë ndikuar dukshëm në kthimin e kredive dhe përshpejtimin e lëndëve nëpër gjykata, atëherë kur ka pasur zvarritje të kthimit të kredive. Për të pasur një besueshmëri më të madhe në mes bankave dhe sektorit privat për Yll Sejdiun nga banka NLB Bank, pasqyrat financiare të bizneseve duhet të bëhen më transparente. Kosova në sistemin e saj bankar aktualisht ka 10 banka komerciale, 18 institucione mikrofinanciare, 15 kompani të sigurimit dhe dy fonde pensionale. (Telegrafi, 16 dhjetor 2015).

GJERMANIA I JEP KOSOVËS GRANT NË VLERË PREJ 17 MILIONË EURO

Qeveria e Republikës së Kosovës në vazhden e bashkëpunimit financiar të realizuar ndër vite me Qeverinë Federale të Republikës së Gjermanisë si partner i rëndësishëm bilateral për asistencë financiare dhe teknike, ka nënshkruar Marrëveshjen për Bashkëpunim Financiar 2015 “Projekti i subvencioneve”, e cila marrëveshje u nënshkrua sot nga ministri i Financave Avdullah Hoti dhe ambasadorja e Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë znj. Angelika Viets. Marrëveshja për Bashkëpunim Financiar për vitin 2015 për dallim nga viti i kaluar ku kishte edhe kredi, përfshinë vetëm pjesën grant në vlerë prej 17 milionë euro për financimin e disa projekteve të rëndësishme, siç janë: „Mbështetja e sektorit të energjisë, faza e VIII, „Shkarkimi i ujërave të zeza në jug-perëndim, faza e pestë“, “Programi për menaxhimin e mbeturinave”. (Kosova Sot, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 16 dhjetor 2015).

MBI NJË MILIARD EURO JASHTË, KOSOVA ZHYTET NË BORXHE

Bazuar në të dhënat statistikore zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, deri në shtator të vitit 2015 borxhi publik i vendit ka arritur në 719.5 milionë euro, nga 550.9 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2014. Nga borxhi i përgjithshëm, 352 milionë euro janë borxhe të brendshme, kurse borxhi i jashtëm ka arritur në 367.2 milionë euro. Shprehur në përqindje, borxhi publik ka arritur 12.5 për qind të Bruto Produktit Vendor (BPV). Ministri aktual i Financave, Avdullah Hoti, ka thënë se kjo vlerë Kosovën e vë në pozitë mjaft të volitshme sa i përket borxhit publik, prandaj ka hapësirë të mjaftueshme për të marrë kredi vetëm për qëllime zhvillimore. (Kosova Sot, 22 dhjetor 2015).




BERZH-I FINANCON KREDINË 1 MILION EURO PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është duke promovuar efiçencën e energjisë në sektorin e banimit në Kosovë duke financuar me një kredi shtesë prej 1 milion euro tek Kreditimi Rural i Kosovës (KRRK), një nga institucionet kryesore mikrofinanciare në vend. Ky financim i ri është siguruar nën Kornizën për Projekte të Energjisë së Qëndrueshme në Kosovë (KoSEP) si përgjigje ndaj kërkesës në rritje për financim të efiçencës së energjisë në vend. Sipas një njoftimi të BERZH, disponueshmëria e financimit afatmesëm dhe afatgjatë për sektorin privat që ka të bëjë me efiçencë të energjisë dhe investime të energjisë së qëndrueshme është i kufizuar në tregun e tanishëm në Kosovë. Përmes KoSEP, kornizë prej 12 milionë eurosh për kreditim të efiçencës së energjisë dhe investimeve të energjisë së qëndrueshme të bizneseve të vogla dhe sektorit të banimit, BERZH-i po e adreson këtë boshllëk tregu. Kjo kornizë gjithashtu përfiton edhe nga donacionet shtesë të cilat sigurohen nga New Norway Cooperation Fund (Fondi i Ri për Bashkëpunim i Norvegjisë) dhe Fondi i Veçantë i Aksionarëve të BERZH-it. (Kosova Sot, Zëri, 23 dhjetor 2015).

PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“Periodiku Bankar” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.
www.bankassoc-kos.com.





Qendra për Trajnime Bankare

TRAJNIMET E PLANIFIKUARA PËR
JANAR - QERSHOR 2016

Certifikimi EFCB

Menaxhimi Porfolios - Risku Kreditor

Risku Operacional

Bazat e Pajtueshmerise

Siguria Financiare - Sanksionet Nderkombetare dhe

OFAC

Auditimi I IT

IFRS

Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171

kbtraining@bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Design: Mithat Sejdiu